

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Çështje të sigurisë - 11

ÇËSHTJE TË SIGURISË

Security Issues

Revistë e përtremuajshme mbi sigurinë

Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim

Bordi botues:

Kryetar

Sotiraq Hroni – Drejtor i Institutit për Demokraci dhe
Ndërmjetësim

Anëtarë

Dr. Arshi Çela

Dr. Arjan Starova

Arjan Dyrmishi

Ambasador Pëllumb Qazimi (Gjen. R)

Konsulentë

Geron Kamberi – M.A. në Studime Europiane

Artan Karini – M.A. në Administrim Publik

Redaktor përgjegjës

Mariola Qesaraku – M.A. në Studime Europiane

Bashkëkohore

Ndihmoi në përgatitje

Ermela Hoxha

Ky numër reviste botohet me mbështetjen financiare
të **Divizionit të Diplomacisë Publike të NATO-s** në Bruksel dhe
Fondacionit Friedrich Ebert, Tiranë

PËRMBAJTJA

Sotiraq Hroni Probleme dhe sfida të sindikalizmit në Shqipëri	7
Kol. Nexhbedin Shehu Fjala hyrëse	11
Gjen. Brig. Zyber Dushku Fjala përshëndetëse në emër të zv/SHSHP të FA-së	12
Ermir Dobiani, Avokat i Popullit Këndvështrimi i avokatit të popullit mbi të drejtën e ushtarakëve për t’u organizuar në struktura profesionale	14
Kol. Bernhard Gertz, Zv. President i EUROMIL Shoqata gjermane e forcave të armatosura dhe lidhjet e saj me EUROMIL	18
Kol. Salvatore Vergari Përfaqësia e ushtarakëve në Itali	24
Major Diman Dimanov Shoqata e oficerëve bullgarë “RAKOVSKI”	27
Dr. Arshi Çela (kol. ret) Të drejtat e ushtarakëve në legjislacionin shqiptar të mbrojtjes	33

Kol. Gjokë Lleshi

Përse është e nevojshme një strukturë, e cila mbështet ushtarakët: Perspektivë nga një oficer shqiptar, pjesëmarrës në operacione paqeruajtëse 39

Editson Zarka, N/Kolonel

Pse është e nevojshme një strukturë, e cila mbështet forcat ushtarake 45

Selly McNamara

NATO: Një analizë pas samitit 55

Jan Petersen

Koncepti i ri strategjik i NATO-s: një vizion parlamentar 66

Charles A. Kupchan

Koha e vendimit: Zgjedhjet e vështira të NATO-s 70

Besnik Baka

Shqipëria: Kërcënime dhe perceptime të sigurisë 74

Ledian Rusta

Dekonstruktimi i terrorizmit si defekt i situatës komunikative 90

Arian Dyrmishi

Interceptimi i komunikimeve në Shqipëri: Kontrolli dhe mbikëqyrja 97

Ivana Tomovska

Reforma e sektorit të sigurisë në Maqedoni: Një përqsasje (jo) holistike? 108

Brief Summary 128

SOTIRAQ HRONI

PROBLEME DHE SFIDA
TË SINDIKALIZMIT NË SHQIPËRI*

Konferenca e sotshme “Mbi të Drejtat e Ushtarakëve për t’u organizuar në Shoqata Profesionale”, përbën një hap të dytë në nismën e IDN-së për të sensibilizuar aktorët institucionalë, por edhe profesionistët në Forcat e Armatosura me përvojën më të mirë europiane mbi rolin dhe rëndësinë e organizatave profesionale të ushtarakëve. Si fazë e parë e kësaj nisme mund të konsiderohet botimi në revistën e përtremuajshme “Çështje të Sigurisë” të disa përvojave të organizatave profesionale nga vende të ndryshme europiane. Ky sensibilizim solli iniciativën e Akademisë së Mbrojtës për t’u koordinuar me IDN për të realizuar një qasje më të plotë sensibilizuese me pjesëmarrjen e gjerë të ushtarakëve. Dëshiroj me këtë rast të falënderoj Avokatin e Popullit dhe Euromil për bashkëpunimin në realizimin e kësaj konference që mbetet e para në llojin e vet.

Në fakt, edhe nisma e përvoja e IDN-së për nxitjen dhe mbështetjen e procesit të realizimit të sindikatës në Policinë e Shtetit kaloi në të njëjtat faza, derisa ajo u sanksionua në Ligjin aktual të Policisë së Shtetit miratuar në qershor 2007. Para një muaji, Sindikata arriti një sukses të parë të madh kur drejtuesi i saj nënshkroi së bashku me Drejtorin e Përgjithshëm të Policisë së Shtetit kontratën kolektive të punës, një arritje kjo që premtonte konsolidimin e Sindikatës së Policisë së Shtetit.

Por, situata në këtë konferencë është edhe më premtuese se gjërat do të ecin në drejtimin e duhur për rregullimin ligjor të shoqatës profesionale të ushtarakëve të FA të RSH-së, për

* Përmbledhje e fjalës së z. S. Hroni në këtë konferencë.

arsye se nisma për këtë konferencë nuk është e IDN-së, por e vetë Akademisë së Mbrojtjes, ashtu sikundër zv/Shefi i Shtabit të Përgjithshëm ndodhet i pranishëm për të përshëndetur këtë hap.

Ne jemi këtu së bashku me Avokatin e Popullit zotin Dobjani dhe Zv/Presidentin e Euromilit, Kol (ret) Bernhard Gertz, organizatës ombrellë të organizatave simotra të ushtrive të vendeve europiane ku militojnë rreth 34 shoqata dhe sindikata ushtarakësh në Europë për të ndarë problematikën, por edhe nxitur përfitim in e një modeli sa më funksionues.

Fakt është se përpjekjet për ngritjen e organizatës profesionale të ushtarakëve shqiptarë bëhet në fund të dekadës së dytë të një shoqërie demokratike. Duke dëshiruar të jem i sinqertë me ju dhe me veten, si qytetar i këtij vendi, apo nga çdo këndvështrim përfaqësimi, (mendoj se për çdo përfaqësues të secilit institucion të vendit duke filluar nga Presidenti i Republikës), ndihem jo mirë që në ushtrinë shqiptare kjo çështje diskutohet sot, pasi vendi është bërë anëtar e NATO-s, ndërkohë që struktura homologe në Bullgari është ngritur dhe funksionon qysh nga viti 1991.

Por, pse është e rëndësishme një organizatë profesionale (që funksionon si sindikatë, por me kufizimet e pranuar ndërkombëtarisht) në ushtri?

Së pari, sepse siguria ka një dimension social dhe shoqata mbron të drejtat e njeriut, liritë themelore dhe interesat social-profesionale të të gjithë personelit ushtarak.

Së dyti, ushtarakët nuk mund të kuptojnë qartësisht liritë dhe të drejtat e njeriut në misionet e tyre në vend apo jashtë vendit, pa qenë në gjendje të sigurojnë dhe mbrojnë të drejtat dhe liritë e tyre.

Së treti dhe shumë e rëndësishme, funksioni i kësaj organizate profesionistësh për t'u bërë faktor i rëndësishëm edhe në politikëbërje, reforma, në mënyrë të veçantë ato që ndikojnë në jetën sociale dhe profesionale të ushtarakëve. Më tej mund të thuhet se kjo organizatë mund të shndërrohet edhe në mbrojtëse e institucionit të Forcave të Armatosura, duke funksionuar si një zë i unifikuar profesionist.

Më lejoni të them, apo më mirë të shpreh opinionin tim se përmes një shoqate tërësisht profesionale dhe gjithëpërfshirëse do ekzistojë një institucion, i cili do të ndikojë ndjeshëm në minimizimin apo eliminimin i subjektivizmit në drejtimin ushtarak, apo edhe në çështje që lidhen me abuzimin në raportet civilo-ushtarake. Pra, me fjalë të tjera, mbështetur edhe në përvojën e vendeve të tjera, kjo organizatë do të mbrojë çdo ushtarak, përfshirë Shefin e Shtabit të Përgjithshëm në çdo problematikë që mund të lindë në raportet me drejtimin politik-civil apo edhe ekzekutivin në tërësi. Jo vetëm për çështje që kanë të bëjnë me buxhetin dhe të drejtat e ushtarakëve, por edhe me urdhra që bien ndesh me legjislacionin, apo nuk marrin parasysh të drejtat e ushtarakëve në detyrë brenda apo jashtë vendit.

Por, natyrshëm para kësaj sipërmarrje qëndrojnë shumë sfida për të arritur objektivat në mënyrë të qëndrueshme dhe efektive. E në këtë këndvështrim, sfida më e madhe është mungesa e një modeli shqiptar në sindikalizëm. Përvoja jo fort pozitive në lëvizjen sindikaliste në përgjithësi në vendin tonë, kam parasysh lëvizjen e sindikatave civile që lindën që më 1991-shin, nuk ofrojnë një model për t'u marrë shembull. Çështje të tilla si demokracia e brendshme dhe korrupsioni kanë bërë tkurrjen dhe mosfunksionimin në përmasat e dëshiruara të sindikalizmit. Pra, as policët e as ushtarakët nuk kanë një model social që t'i inkurajojë në rëndësinë e modelit sindikalist. Rrjedhimisht, kjo shoqërohet me mungesën e besimit të anëtarësisë të sindikata. Kur kjo dukuri shoqërohet me frikën për të ruajtur vendin e punës për shkak të ndikimit voluntarist, e në disa raste, korruptiv të politikës dhe drejtimit në çështje të menaxhimit të personelit, atëherë çështja e besimit të sindikatave apo shoqata profesionale bëhet edhe më e vështirë.

Por, duke vlerësuar se ushtria shqiptare mbetet një nga institucionet më të reformuara në vend, janë të gjitha gjasat që shoqata profesionale e ushtrisë shqiptare të jetë një model në funksionimin duke vendosur peshën dhe autoritetin e saj në Forcat tona Armatosura. Tashmë, modelet dhe përvojat nuk

mungojnë. Vullneti politik dhe profesional vlerësohet si i mirëqenë për aq kohë sa vendi është anëtare me të drejta të plota të NATO-s.

Për më tepër, si do të shpjegojë edhe zv/Presidenti i EUROMIL-it në Bruksel, vullneti i simotrave europiane është i plotë për të mbështetur ushtarakët shqiptarë në këtë sipërmarrje të tyre. Besoj se aktiviteti i sotshëm do të jetë një hap i rëndësishëm në institucionalizimin e kësaj praktike në Forcat e Armatosura të vendit.

Kol. NEXHBEDIN SHEHU**Komandant i Akademisë së Mbrojtjes “Spiro Moisiu”****FJALA HYRËSE**

Kolonel Nexhbedin Shehu, Komandant i Akademisë së Mbrojtjes “Spiro Moisiu” në Tiranë pasi falënderoi përzemërsisht pjesëmarrësit dhe në veçanti Zv. Presidentin e EUROMIL z. Bernard Gertz, Avokatin e Popullit z. Dobjani, z. Gjeneral Malaj, Shef i Shtabit të Përgjithshëm të Forcave të Armatosura. Ai gjithashtu falënderoi kontributin e një prej bashkëpunëtorëve të vjetër të Akademisë së Mbrojtjes z. Sotiraq Hroni, Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim, për kontributin e tij në organizimin e kësaj konference si dhe Drejtorin e Fondacionit Friedrish Ebert, duke konsideruar si probleme të shoqërisë civile edhe çështjet e mbrojtjes dhe të sigurisë.

Më pas ai u ndal në rëndësinë e zhvillimit të konferencës për mbrojtjen e të drejtave të ushtarakëve që është e rëndësishme jo vetëm për gjendjen dhe rolin social e juridik të qytetarëve me uniformë, por edhe për faktin se kjo veprimtari është ndoshta e para e këtij lloji pasi për herë të parë, Flamuri i Shqipërisë valëvitet në Selinë Qendrore të NATO-s e në komandat supreme të saj.

Në vijim të plotësimit të misionit që është arsimimi me nivele bashkëkohore e shumë profesionale të korpusit të oficerëve, ne vazhdimisht i japim rëndësi nivelit teorik të diskutimit e debatit.

Në kuadër të programit të Departamentit të Shkencave Sociale u zgjodh pikërisht të flisnim për të drejtat e ushtarakëve duke e konsideruar këtë temë të pashkëputur nga detyrat e përgjegjësitë sublimë që Atdheu kërkon nga ushtarakët. Kjo gjë do të na ndihmojë edhe më shumë për integrimin tonë të plotë në strukturat Euro-Atlantike.

Gjen. Brig. ZYBER DUSHKU

FJALA PËRSHËNDETËSE NË EMËR TË ZV/SHSHP TË FA-së

Gjen. Brig. Zyber Dushku shprehu kënaqësinë e vecantë për të marrë fjalën në këtë konferencë, e cila ka për zgjedhur të trajtojë një çështje interesante, por njëkohësisht edhe të rëndësishme për të gjithë ushtarakët, por edhe për përfaqësuesit e institucioneve të tjera të shtetit e të shoqërisë civile.

Duke përfituar nga ky rast, ai fillimisht përshëndeti të gjithë pjesëmarrësit, në mënyrë të vecantë Avokatin e Popullit, drejtuesit e Institutit për Demokraci e Ndërmjetësim, Zëvendës-presidentin e Euromil-it, përfaqësuesit e Fondacionit të njohur gjerman “Friedrich Erbert” si dhe Drejtuesit e Akademisë së Mbrojtjes, të cilët kanë ndërmarrë këtë iniciativë me synimin për të diskutuar mbi të drejtën që kanë ushtarakët për t’u organizuar në shoqata profesionale në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të tyre.

Ky aktivitet zhvillohet vetëm pak ditë pas anëtarësimit të vendit tonë në NATO. Të qenit anëtar në këtë Aleancë të madhe, krahas të tjerash na ballafaqon me disa përgjegjësi e sfida të reja që duhen trajtuar me kujdesin dhe seriozitetin e duhur.

Pjesëmarrjen kaq të gjerë dhe të larmishme në këtë aktivitet e konsideroj si një tregues të interesit për t’ju dhënë përgjigje pikërisht atyre pyetjeve që lidhen me këtë çështje. Në të njëjtën kohë, kjo pjesëmarrje flet për vlerësimin dhe mbështetjen e asaj që është arritur deri më sot, si dhe për synimet e ambiciet që kërkohen të arrihen në të ardhmen. Duke qenë se te ne, përvoja në këtë fushë nuk është shumë e pasur, do të mirëprisnim çdo përvojë pozitive nga vende të tjera anëtare të Aleancës.

Misioni i Forcave të Armatosura për përmbushjen e detyrimeve të tyre kushtetuese është sa fisnik, aq edhe i

vështirë. Për vetë veçoritë dhe vështirësitë e detyrës, ne ushtarakët, me ndërgjegje kemi pranuar të privohemi nga disa të drejta në krahasim me disa grupe të tjera sociale.

Një privim i tillë vetëpranohet në emër të një qëllimi të lartë që ka të bëjë me garantimin e lirisë dhe të sovranitetit të vendit. Ky përbën edhe thelbin e betimit ushtarak të pjesëtarëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Ligji, disiplina, respektimi i hierarkisë së komandimit dhe drejtimit, zbatimi i rregulloreve dhe urdhërësive janë disa nga shtyllat ku mbështetet sukcesi i Forcave të Armatosura si në kohë paqe, ashtu edhe në kohë lufte. Nga ana tjetër, respektimi i dinjitetit individual, i të drejtave të ushtarakëve si qytetarë me uniformë, nuk bien në kundërshtim me legjislacionin në fuqi.

E drejta e ushtarakëve për të mbrojtur atë që u garanton ligji është e justifikuar dhe kërkon mbështetjen jo vetëm nga strukturat ushtarake, por edhe nga shoqëria civile. Por, nga ana tjetër, për të përmbushur me sukses misionin e tyre kushtetues, Forcat e Armatosura kanë nevojë për njerëz të motivuar e të ndërgjegjshëm që kuptojnë drejt përgjegjësitë dhe privacionet që shoqërojnë jetën ushtarake.

Duke përfunduar, me besimin se në konferencë do të trajtohen me hollësi disa nga këto çështje që na preokupojnë të gjithëve, uron punë të mbarë dhe suksese në zhvillimin e punimeve të kësaj konference.

ERMIR DOBIANI, Avokat i Popullit**KËNDVËSHTRIMI I AVOKATIT TË POPULLIT
MBI TË DREJTËN E USHTARAKËVE
PËR T’U ORGANIZUAR NË STRUKTURA
PROFESIONALE**

Është kënaqësi të marr sot pjesë në këtë aktivitet të organizuar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim, kushtuar një teme shumë interesante, sikurse është “E drejta e ushtarakëve për t’u organizuar në shoqata profesionale për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e tyre”.

Qysh në fillim më duhet të them se të drejtat e ushtarakëve kanë qenë në fokusin e vëmendjes së Avokatit të Popullit. Kështu, krahas ndjekjes së ankesave të përditshme, qysh në fillim të veprimtarisë tonë, në vitin 2001, Avokati i Popullit bashkë organizoi me Ministrinë e Mbrojtjes një tryezë të rrumbullakët për të drejtat e ushtarakëve në detyrë. Më pas, duke promovuar rolin dhe misionin e tij, Avokati i Popullit prodhoi dhe shpërndau edhe një fletëpalosje, përmes së cilës evidentonte të drejtat e ushtarakëve dhe mënyrën e mbrojtjes së tyre nga institucioni i Avokatit të Popullit. Këtu kujtojmë se dy vitet e fundit kemi shpeshuar ditët e hapura ku ndihmësit e Avokatit të Popullit shkojnë në të gjitha qendrat stërvitore dhe repartet ushtarake ku ka grumbullime jo të vogla të ushtarëve dhe oficerëve për t’i takuar ata. Vetëm gjatë vitit 2008 janë takuar rreth 1200 ushtarë apo oficerë.

Pa përmendur këtu komunikimet e përditshme dhe angazhimin tonë, i cili ka qenë i pakushtëzuar nga emri i titullarëve përkatës apo partive politike në pushtet, mund të them se objekti i ankesave të prezantuara nga ushtarakët apo ish-ushtarakët pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, ashtu si çdo vit, edhe gjatë vitit 2008, nuk ka qenë i ndryshëm. Dhe konkretisht, gama e ankesave ka përmbajtur:

1. Ankesa për mobilizim në shërbimin ushtarak në kundërshtim me ligjin.
2. Ankesa për pensionin suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.
3. Ankesa për mosdhënie të gradës sipas ligjit.
4. Ankesa lidhur me mosstrehimin e ushtarakëve.
5. Ankesa për mënyrën e trajtimit me ushqim.
6. Ankesa për moszbatimin e normave të veshmbathjes.
7. Ankesa për shërbimin shëndetësor.
8. Ankesa për kohën e punës dhe të pushimit.
9. Ankesa për mos kompensimin e qirasë së banesave.
10. Ankesa për transportin nga vendi i punës për personelin ushtarak.
11. Ankesa për pensionet e ulëta të ushtarakëve të dalë në rezervë para vitit 1992.
12. Ankesa për moszbatim të ligjit për daljen e ushtarakëve në rezervë etj.

Nga 144 ankesa të formalizuara me shkrim gjatë vitit 2008, rreth 30% e tyre kanë rezultuar të drejta dhe janë zgjidhur në favor të ushtarakëve apo ish-ushtarakëve.

Është kënaqësi të përsërisim konstatimin tonë se Ministria e Mbrojtjes është një nga dikasteret e Administratës sonë Publike ku me përjashtim të pak rasteve, në përgjithësi kemi gjetur partnerë të gatshëm për të bashkëpunuar në mënyrë institucionale, me qëllimin e mirë dhe të vetëm për zgjidhjen e drejtë të problemeve dhe shqetësimeve të ushtarakëve. Aktualisht, ushtarakët kanë në dispozicion shumë mjete ligjore që mund të mbrojnë të drejtat dhe liritë e tyre, nëse ato nëpërkëmben nga eprorët e tyre, përfshirë edhe Avokatin e Popullit.

Por, le të ndalemi pak te tema e kësaj Konference, sikurse është “E drejta e ushtarakëve për t’u organizuar në shoqata profesionale për të mbrojtur të drejtat dhe liritë e tyre”. Si mund ta dini, liria për t’u shoqëruar është një e drejtë bazë që njihet qartë në Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut dhe në traktate të tjera, sikurse është Marrëveshja ndërkombëtare për të Drejtat Civile e Politike; ajo për të Drejtat Ekonomike, Sociale dhe Kulturore apo edhe ajo që dukshëm

ka zënë një vend të veçantë në Legjislacionin shqiptar, si një e tërë, pra Konventa Europiane për të Drejtat dhe Liritë Themelore të Njeriut. Në nenin përkatës të kësaj Konvente (11) thuhet: “Çdo person gëzon të drejtën e lirisë, të tubimit paqësor dhe të organizimit, duke përfshirë të drejtën për të themeluar, bashkë me të tjerë sindikata dhe për të marrë pjesë në to për mbrojtjen e interesave të tij”. Deri këtu jemi në rregull. Pyetja shtrohet: Po ushtarakët si do të cilësohen? Po ushtarakët si do të trajtohen në kuptim të gëzimit të këtyre të drejtave?

Neni 11/2 i Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut duket se është disi restriktiv, pasi aty thuhet se “ky nen nuk ndalon kufizime të arsyeshme në ushtrimin e këtyre të drejtave nga pjesëtarët e forcave të armatosura, të policisë apo të administratës së shtetit”. Pra, ky nen lejon disa kufizime të ligjshme, të cilat natyrisht jo se janë të dhëna një herë e përgjithmonë, por Sidoqoftë, jam i bindur se do të përbëjnë edhe për disa kohë një temë debati, së pari midis vetë ushtarakëve, dhe më pas, edhe midis ushtarakëve dhe qeverisë apo ligjvënësit. Gjithashtu sipas pikës 1 të nenit 46 të Kushtetutës sonë: “Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm”.

Në bazë të Konventës duket se janë përcaktuar edhe kufizimet në Ligjin nr. 9210 datë 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut të Forcave të Armatosura në Republikën e Shqipërisë”. Sipas germës së fundit të nenit 16 të ligjit të sipërpërmendur Ushtaraku aktiv gëzon “të drejtën e organizimit në shoqata, të cilat nuk kanë karakter politik ose sindikalist”. Në këtë kuadër, nëse gjykohet se duhen krijuar këto organizata për mbrojtjen e të drejtave të punës së ushtarakëve, shtrohet problemi i ndryshimeve që duhen bërë në ligj, që do të thotë të merren iniciativa ligjore për të hequr këto kufizime.

Sipas mendimit të deritanishëm të Avokatit të Popullit, këto ndryshime do të vijnë vetvetiu me ndryshimet që janë bërë dhe po bëhen në ushtri lidhur me trajtimin financiar të ushtarakëve. Kështu, pas plotësimit të detyrimeve për të afruar pagën e ushtarakut shqiptar me atë të vendeve të NATO-s,

mendoj se mund të bëhen edhe propozimet përkatëse për ndryshimet në ligj për të krijuar shoqata në mbrojtje të drejtave të ushtarakëve. Avokati i Popullit druan se aktualisht, nëse ushtarakët do të ndërmerrnin iniciativa për të krijuar shoqata me karakter sindikalist, ata do të vepronin në kundërshtim me ligjin, çka do të thotë se që në çastin që do të kërkonin miratimin e statutit të tyre në gjykatë, nga ana e kësaj të fundit, një kërkesë e tillë nuk do mund të miratohej pasi ka ndalim ligjor.

Është e vërtetë se legjislacioni ynë po për afrohet me Legjislacionin europian, edhe në fushën e funksionimit të ushtrisë. Natyrisht që kemi nevojë edhe për pika reference. Por të mos harrojmë një realitet shqiptar, i cili pavarësisht se përthyeret konkretisht në Forcat e Armatosura, ndryshon dukshëm nga ai që mund të na ofrojë realiteti me pika referimi Suedezët apo Holandezët. Kur flasim për këtë realitet, fjalën e kemi pikërisht për atë mentalitet, që do ta ndryshojë atë. Së pari, le të mendojmë pak se ç'mund të ndodhë midis një Kryetari të organizatës profesionale në ushtri dhe një Komandanti në bazë? Megjithatë, si Avokat i Popullit unë angazhohem të mbështes çdo nismë të ushtarakëve, që do të çonte në mirëfunksionimin e tyre, së pari, si masë humane, e cila duhet respektuar dhe mirëtrajtuar, për më tepër në kushtet kur tema e ditës është profesionalizmi.

Përfundimisht, Avokati i Popullit asnjëherë nuk ka pretenduar se thotë fjalën e fundit për të gjitha çështjet. Edhe për problemin në fjalë, unë dhe ekspertët e mi ngelemi të hapur për të mirëpritur të gjitha propozimet e mundshme, në mënyrë që, në një të ardhme jo shumë të largët, të bëhet edhe krijimi i këtyre organizatave si nevojë e kohës dhe bazuar në praktikat më të mira të Ushtrive të vendeve anëtare të NATO-s.

Si Avokat i Popullit besoj se bashkëpunimi i mirë i deritanishëm me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm, do të jetë konstante e punës tonë, edhe për realizimin e një të drejte të tillë, rreth së cilës po diskutojmë sot, mjaft që të garantohet profesionalizmi dhe motivimi i duhur brenda një ushtrie të NATO-s, sikurse meriton të quhet tashmë edhe ushtria jonë.

KOL. BERNHARD GERTZ, Zv. President i EUROMIL**SHOQATA GJERMANE E FORCAVE
TË ARMATOSURA DHE LIDHJET E SAJ
ME EUROMIL**

Shoqata Gjermane e Forcave të Armatosura (Deutsche Bundeswehr Verband) u themelua më 14 korrik 1956. Aktualisht Shoqata ka më shumë se 210000 anëtarë. Ajo kujdeset për nevojat e ushtarëve të të gjithë status-grupeve dhe gradave, d.m.th. rekrutët, ushtarët profesionistë, ushtarët aktivë që shërbejnë për një qëllim të caktuar dhe ushtarët në pension. Shoqata e Forcave të Armatosura është financiarisht e pavarur dhe nuk është e orientuar politikisht nga ndonjë parti. Të gjitha shërbimet e kryera nga Shoqata janë të financuara vetëm nga abonimet e anëtarësisë.

Shoqata e Forcave të Armatosura është e organizuar në nivele të ndryshme: njësitë ushtarake, garnizonet, qarqet dhe katër organizata rajonale. Bordi federal formon “majën” e shoqatës. Ajo është një organizatë demokratike. Kjo nuk shtrihet vetëm në strukturën e saj, por edhe në opinionbërje dhe zgjedhje. Delegatët e çdo niveli punojnë në bazë honorarësh dhe zgjidhen me votë të lirë, p.sh. vetëm vota dhe argumentet e personit merren për bazë jo grada e tij/saj. Bordi federal zgjidhet nga të gjithë anëtarët në një asamble të përgjithshme, e cila ndodh çdo katër vjet.

Bazat ligjore të shoqatës janë themeluar në kushtetutën gjermane, e cila garanton të drejtën e shoqatës si një e drejtë themelore dhe në Nenin e Ushtarit, është rregullorja kryesore e ligjit për shërbimin ushtarak. Sipas Nenit të Ushtarit, një ushtar ushtron të drejta civile si çdo qytetar tjetër. Kjo përfshin të drejtën e pakufizuar të ushtarëve për të ngritur shoqata

profesionale për të mbrojtur kushtet e punës së tyre dhe interesat ekonomikë dhe të bëhen anëtarë në organizata të tilla.

Kur u formuan Forcat e Armatosura Gjermane në 1956-n, ekzistonte një konsensus i përbashkët se Forcat e Armatosura në Gjermani duhet të ishin të integruara në sistemin parësor demokratik dhe duhet të vendoseshin nën kontrollin parlamentar. Për më tepër, pozicioni ligjor për të gjithë ushtarakët duhej të arranxhohej në mënyrë gjithëpërfshirëse. U zhvillua koncepti i “Innere Führung”, i cili është i vlefshëm dhe sot. Ky koncept përfshin rregulla për integrimin e forcave të Armatosura në shoqëri si dhe rregullore rreth strukturës së brendshme të forcave të Armatosura. Pika esenciale e konceptit është njohja e ushtarëve si “qytetarë në uniformë”, i cili është principi drejtues për Forcat e Armatosura Gjermane.

E drejta për shoqata të lira për ushtarët do të thotë implementim i sistemit të vlerave të implementuar në kushtetutë si dhe në jetën profesionale të ushtarëve pa deduksione të konsiderueshme. Liria e shoqatave synon në pjesëmarrjen aktive të ushtarëve në përcaktimin e kushteve të tyre të punës. Deutsche Bundeswehr Verband kujdeset të arrihet ky synim.

Një paragraf i Nenit të Ushtarit (paragrafi 35 a) siguron një garanci se shoqata jonë që përfaqëson interesat e ushtarëve duhet të përfshihet në përgatitjen e rregullores së përgjithshme të ligjit të ushtarakëve lidhur me ushtarët e lëshuar nga qeveria. Kjo përfshin të gjithë ligjet, rregulloret ligjore dhe administrative për sa i përket lidhjeve ligjore midis punëdhënësit ose superiorit dhe ushtarit. Në Gjermani, kushtet e ushtarakëve, si ato të nëpunësit civil, nuk janë të përcaktuara nga një marrëveshje kolektive për shkak të faktit se shoqata nuk merr pjesë në negociata kolektive.

Zakonisht shoqata përfshihet nga dërgesat e ndonjë projekti ose ligji, urdhri apo rregullore dhe i kërkohet të bëjë një formulim të shkruar. Kjo shoqërohet nga një ofertë për pjesëmarrje në bisedime nga ministria kompetente. Sidoqoftë, në shumicën e rasteve, kjo paraprihet nga bisedime ose negociata midis shoqatës dhe përfaqësuesve të ministrisë në ngarkim. Shpesh një diskutim i hapur kundërshtues ndjek

paraqitjen e formulimit të shoqatës. Në kohën që fatura është pasuar nëpërmjet qeverisë dhe dërguar në parlament, Shoqata e Forcave të Armatosura vazhdon lobimin në fraksionet dhe komisionet e posaçme të parlamentit.

Në 1971, i ashtuquajti “bashkëpunimi për dekret” i Ministrisë së Mbrojtjes u dekretua. Ky dekret i kërkon komandantëve dhe shefave të “bashkëpunojnë me besim” me Shoqatën e Forcave të Armatosura dhe i jep shoqatës mundësinë për të shkëmbyer informacion në kazerma dhe të mbajë takimet e anëtarëve.

Më 1996, u firmos “Marrëveshja për Përmirësimin e Pjesëmarrjes të Organizatave Qendrore të Unioneve Tregtare në procedurat e rregullores” midis Shoqatës dhe Ministrisë së Mbrojtjes që do të thotë një shtrirje të mëtejshme të praktikës së pjesëmarrjes.

- Sipas marrëveshjes, bisedimet e nivelit të lartë do të mbahen midis ekzekutivit të ministrisë dhe shoqatës rreth problemeve të përgjithshme dhe themelore të politikave të ligjit për shërbimin, zakonisht të paktën dy herë në vit.

- Bisedimet në nivel teknik do të mbahen më shpesh. Ato përdoren veçanërisht për të diskutuar problemet e përgjithshme të ligjit për shërbimin, për të paraqitur projekte specifike të ligjit për shërbimin dhe të diskutohen iniciativat nga organizatat.

- Departamentet e ministrisë që po formulojnë rregulloren, i dërgojnë shoqatës planet në të njëjtën kohë që i dërgohen ministrive të tjera. Periudha e caktuar për organizatat që duhet të japin një formulim duhet të jetë e përshtatshme për shtrirjen dhe domethënien e projektit të rregullores. Si rregull është tre muaj.

- Në rastin e çështjeve të rëndësishme të lartë bisedimet me pjesëmarrje drejtohen nga ministrat ose zv.ministrat. Projektet e tjera të rregullores mund të diskutohen në nivel të drejtorit të departamentit.

- Sugjerimet e bëra nga organizatat, të cilat nuk janë konsideruar nga ministria u komunikohen dhe shpjegohen organeve ligjore në një shtesë për arsyet e ligjit.

Shoqata e Forcave të Armatosura nuk e kufizon veten në reagim, ajo nuk pret për parlamentin ose qeverinë për të pyetur për formulimin, por më tepër ajo përpunon iniciativa në fusha të ndryshme. Iniciativat më tej diskutohen në grupe studimi, konferenca dhe simpoziume, të cilat e detyrojnë administratën të shqyrtojnë problemet përkatëse. Përfaqësuesit drejtues të shoqatës vazhdimisht mbajnë takime me ministra, Zv.ministra, Shefin e Shtabit të Forcave të Armatosura Gjermane, inspektorët e degëve të Forcave të Armatosura dhe politikanë të të gjitha fraksioneve të parlamentit gjerman.

Kontaktet e vazhdueshme me përfaqësuesit e partive politike luajnë një rol të rëndësishëm. Problemet e ndryshme politike janë të përcaktuara në mënyrë decizive nga të ashtuquajturit zëdhënës të partive. Atëherë, folësit e politikave të mbrojtjes, të cilët kanë influencë të madhe brenda partive të tyre janë kontaktet e para për shoqatën tonë. Sidoqoftë, problemet që u përkasin Forcave të Armatosura janë gjithashtu faktorë ndihmues në fusha të tjera politike: Politikanët e komitetit për marrëdhëniet me jashtë të parlamentit gjerman kanë përgjegjësi për çështjet në lidhje me misionet ndërkombëtare. Politikanët e çështjeve të brendshme duhet të përfshihen kur trajtohen ndryshimet në ligjin për shërbimet civile dhe Komiteti i Buxhetit bën deklarata të rëndësishme në çështjet e lejimit të parave. Pra, një pjesë e madhe e punës së përfaqësuesve të shoqatës është të bindë të gjitha partitë për domosdoshmërinë e të drejtave të përmirësuara për ushtarakët.

Nëse ka ndonjë polemikë rreth pyetjeve qendrore politike, shoqata përdor kontaktet e saj me median. Lidhjet me publikun janë një çështje e rëndësishme për shoqatën tonë dhe ato reflektohen në shtyp, radio dhe televizione. Fakti se Deutsche Bundeswehr Verband organizon jo vetëm grupe të caktuara të personelit të shërbimit, por mbledh të gjithë stafin e shërbimit, pavarësisht nga statusi apo grada, i jep shoqatës forcë politike.

Si pasojë në shumë pyetje ne duhet të biem në kompromise të brendshme tanimë, dhe nga ana tjetër pa diskutim, shpesh parandalon që grupe të ndryshme interesi në shoqatë t'i kundërvihen njëri-tjetrit.

Si përfundim mund të themi se edhe pse shoqata nuk ka të drejta reale vendimmarrjeje rreth rregullores së ligjit për shërbimin, është shumë e vështirë të vendosen rregulla esenciale për ushtarët pa marrë miratimin e shoqatës. Për shkak të kontakteve të mira në "nivelin teknik" shumë shpesh mund të arrihet marrëveshja në një fazë të parë përpara se të lëshohet drafti final zyrtar. Numri i drafteve të rregullores nga MM ose Qeveria, i cili aprovohet nga shoqata, është në mënyrë të konsiderueshme më i lartë se ato raste ku idetë e shoqatës dhe qeverisë janë të ndryshme. Me Deutche BundeswehrVerband ushtarët kanë mundësinë të formulojnë dëshirat dhe idetë e tyre në një fazë të parë. Që prej ekzistencës së saj 50-vjeçare, Deutche BundeswehrVerband është bërë një partner i respektuar për Qeverinë dhe Parlamentin për përfitimet e ushtarakëve.

Nuk është bërë akoma rregull në të gjithë vendet europiane që ushtarët të gëzojnë të drejtën e një shoqate. Në disa shtete të unionit aktivitetet e ushtarëve janë të ndaluara. Për të shtrirë të drejtën e ushtarëve në të gjitha shtetet, Deutche BundeswehrVerband bashkë me shoqata të tjera ushtarake nga pesë vende europiane, themeluan Organizatën Europiane të Shoqatave Ushtarake (EUROMIL) në 1972. Sot EUROMIL është një organizatë ombrellë e 32 shoqatave ushtarake dhe unioneve tregtare nga 24 vende, të cilat përfaqësojnë rreth 500000 ushtarakë. Në të njëjtën kohë shumë organizata të tjera nga vendet e Europës Lindore, si Bullgaria, Republika Çeke, Hungaria, Polonia, Republika Sllovaqe dhe Sllovenia, janë gjithashtu anëtarë mjaft aktivë të EUROMIL.

EUROMIL promovon interesat sociale dhe profesionale të ushtarakëve europianë, ruan shkëmbimin e eksperiencave profesionale dhe brenda kuadrit të OSBE-së kontribuon për ngritjen e konfidencës në një nivel europian. EUROMIL është e vetmja organizatë që përfaqëson interesat e personelit ushtarak në nivel ndërkombëtar.

Për shkak të ndryshimeve të sfidave në fushën e sigurisë, bashkëpunimi multinacional është bërë një realitet i përditshëm për personelin ushtarak evropian. Tani merren akoma më shumë vendime, të cilat u përkasin kushteve të punës së ushtarëve në nivel ndërkombëtar. Për shkak të këtij kualifikimi një përfaqësim i fuqishëm në nivel evropian është më i domosdoshëm se kurrë. EUROMIL ka status pjesëmarrjeje në Këshillin e Europës dhe status observues në Asamblenë Parlamentare të NATO-s. Ajo përkrah kontaktet me Organizatat për Siguri dhe Bashkëpunim në Europë dhe përfaqëson interesat e anëtarëve për institucionet e BE-së.

Shoqatat me anëtarësi të EUROMIL janë të bindura së një ushtar që duhet të mbrojë dhe përkrahë të drejtat e bashkëqytetarëve të tij dhe rendin kushtetues të vendit të tij, duhet t'i jepet e drejta të gëzojë dhe marrë të njëjtat të drejta dhe liri demokratike. Eksperienca ka treguar se ato vende, të cilat kanë garantuar të drejta të plota themelore për ushtarët e tyre, nuk kanë përjetuar ndonjë humbje rendimenti ushtarak apo disiplinor. Në të kundërt, hyrja në dialog të vazhdueshëm me shoqatat e ushtarakëve për kushtet e tyre sociale apo të punës ndihmon për të lidhur më afër ushtarakët me organizatat ushtarake dhe ngre moralin dhe besnikërinë ndërmjet trupave.

KOL. SALVATORE VERGARI

PËRFAQËSIA E USHTARAKËVE NË ITALI

Institucioni i Përfaqësisë së Ushtarakëve është themeluar në Itali në 1978, me ligjin 382/78 “Rregullorja e Disiplinës, Normat e parimeve”, disiplinuar në vitet e ardhshme me aktet ligjore: “Rregullorja e Zbatimit mbi Përfaqësinë e Ushtarakëve” (Dekret i Presidentit të Republikës 691/79) dhe Rregullorja e Brendshme e Përfaqësisë së Ushtarakëve (Dekret Ministerial 9 tetor 85). Përfaqësia e Ushtarakëve është një Institucion i BRENDSHËM në Strukturën Ushtarake. Nga kjo kuptohet ndryshimi thelbësor me Sindikatën. Në thelb, i gjithë personeli ushtarak ka të drejtën dhe detyrimin që të marrë pjesë në zgjedhjen e përfaqësuesve të vet.

Organet kolegjiale janë të gjitha **të zgjedhshme**.

Përfaqësia e Ushtarakëve kryen funksionin e aktivitetit ndihmës përballë autoritetit hierarkik, duke nxjerrë masa ligjore (vendime), të cilat kanë vetëm karakter propozues – këshillues. Qëllimi i këtij Institucioni është dhënia e kontributit për të mbajtur në nivel të lartë gjendjen morale dhe materiale të personelit. Përfaqësia e Ushtarakëve nuk është një SINDIKATË. Organet e Përfaqësisë së Ushtarakëve janë 3 dhe ndahen sipas niveleve të ndryshme të komandimit:

- COCER (Komiteti Qendror i Përfaqësimit): organ qendror, me karakter kombëtar dhe gjitharmësh, i ndarë në seksione sipas secilës Forcë të Armatosur ose Trupë e Armatosur (Forcat Tokësore, Forcat Detare, Forcat Ajrore, Karabinierët dhe Policia Financiare – Guardia di Finanza);

- COIR (Komiteti i Ndërmjetëm i Përfaqësimit): organ i ndërmjetëm në Komandat e Larta;

- COBAR (Komiteti Bazë i Përfaqësimit): organi bazë në njësitë e nivelit minimal i përputhshëm me strukturën e secilës Forcë të Armatosur ose Trupe të Armatosur.

Në brendësi të tyre, Komitetet ndahen në funksion të personelit që është i përfaqësuar:

Kategoria “A”: Oficerë

Kategoria “B”: Nënoficerë

Kategoria “C”: Ushtarë profesionistë.

Ekzistojnë, por nuk janë të aktivizuara edhe kategoritë “D” dhe “E” në lidhje me personelin e shërbimit ushtarak të detyrueshëm, për vetë faktin që nuk është më në fuqi shërbimi i detyrueshëm ushtarak. Lëndët që mund trajtohen dhe diskutohen:

- sektori ekonomik
- sektori juridik
- sektori i sigurimeve shoqërore
- sektori i moralit, mirëqenies dhe mbrojtjes sociale.

Kompetencat e Përfaqësisë kanë të bëjnë me paraqitjen e mendimeve të kërkuara, të propozimeve dhe të kërkesave në të gjitha fushat që përbëjnë thelbin e normave me karakter ligjor ose rregullues në lidhje me kushtet, trajtimin, mbrojtjen me natyrë juridike, ekonomike, sigurimesh shoqërore, shëndetësore, kulturore dhe morale të ushtarakëve.

Organet e përfaqësuar kanë përveç të tjerash funksionin e paraqitjes së instancave me karakter kolektiv, të cilat lidhen me sektorët e mëposhtëm me interes: ruajtjen e vendit të punës gjatë shërbimit ushtarak, kualifikimin profesional, përfshirjen në proceset e punës të atyre personave që lënë shërbimin ushtarak, shpërblimet për dëmtimet e pësuarra dhe për sëmundjet e marra gjatë periudhës së shërbimit dhe për motive shërbimi, aktivitete me karakter asistenceje, kulturore, rikrijuese dhe të promovimit social, edhe në ndihmë të familjarëve; organizimi i sallave të çlodhjes dhe mensave, kushtet higjieniko-shëndetësore, fjetinat. Ndërkohë NUK mund të trajtohen lëndët/argumentet që karakterizojnë organizimin ushtarak:

- struktura;
- stërvitja – operacionet;
- sektori logjistiko – operacional;
- marrëdhëniet hierarkike;
- caktimi dhe punësimi i personelit.

Aktiviteti i Përfaqësisë së Ushtarakëve është i karakterizuar nga:

- unanimiteti i vendimeve që merren;
- të gjitha shpenzimet janë në ngarkim të Bilancit të Mbrotjtjes (p.sh. shpenzime për shërbim, funksionimi etj);
- vendimet/propozimet zyrtarizohen me anë të shkresave/dokumenteve;
- shpërndarja e informacioneve me qëllim bërjen me dije të të gjithë personelit ushtarak.

Nga sa u paraqit më lart, del e qartë një ndryshim thelbësor midis Institucionit të Përfaqësimit të Ushtarakëve dhe Sindikatës.

PËRFAQËSIA e USHTARAKËVE	SINDIKATA
<ul style="list-style-type: none"> • NUK ka “personalitet juridik”, d.m.th. nuk ka të drejta dhe detyrime • Anëtarësimi i detyrueshë • Përfaqësim i interesave të kolektivitetit ushtarak • Organet të zgjedhura nga personeli ushtarak • Falas 	<ul style="list-style-type: none"> • Ka “personalitet juridik” • Anëtarësim vullnetar • Përfaqëson interesat e një kategorie • Organe të “imponuara” nga sindakata • Me pagesë

Zhvillimet e mundshme të ardhshme mund të jenë:

- Azhornimi i Kuadrit Ligjor me qëllim përshtatjen me skenarin e ndryshuar social dhe institucional. Sidoqoftë, me vështirësi kjo mund të çojë në një zgjerim të lëndëve, të cilat Përfaqësia Ushtarakë mund t’i diskutojë (operacionet, stërvitja, caktimi dhe punësimi i personelit);

- Liria e anëtarësimit;
- Sindakata

Major DIMAN DIMANOV

SHOQATA E OFICERËVE BULLGARË “RAKOVSKI”

Majori Dimanov i Forcave të Armatosura Bullgare – Ndhimësushtarak i Përfaqësuesit të Lartë të NATO-s në Reformën e Sektorit të Sigurisë në Tiranë.

Në radhë të parë Majori Dimanov falënderoi zotin Hroni, për mundësinë për të marrë pjesë në këtë takim kaq të rëndësishëm, i cili është fokusuar në çështje kaq të ndjeshme si janë të drejtat e ushtarakëve.

Në fillim gjithashtu ai veçoi se do të flas duke përfaqësuar Kryetarin e Ligës së Oficerëve Bullgarë “Rakovski”, i cili më dha materialet e nevojshme për këtë prezantim dhe jam i lumtur ta jap përpara jush.

Axhenda ime konsiston në 4 pika kryesore:

1. Themelimi i organizatës
2. Aktivitete
3. Partneriteti “Rakovski”
4. Perspektiva

Unioni i oficerëve bullgarë të Ligës “Rakovski” u themelua në vitin 1991 në një kohë kur regjimi komunist 50-vjeçar u kthye në histori dhe kur ndryshimet demokratike u bënë realitet. Krijimi i organizatës u bë i mundur si rrjedhojë e heqjes së kufizimeve për të themeluar shoqëri jokomuniste në Bullgari. Arsyeja për të themeluar “Ligën” ishte si pasojë e nevojës për të pasur unione, të cilat mbrojnë interesat sociale dhe profesionale të ushtarakëve. Gjatë fillimit të viteve ’90 shoqëria bullgare

përjetoi procese dinamike, të cilat kërkonin që ushtarakët të bëheshin pjesë e këtyre proceseve madje ta mbështesnin atë.

II. Aktivitetet

Në kohën e themelimit të “Ligës”, anëtarët e saj ishin oficerë të Ministrisë së Mbrojtjes e Ministrisë së Brendshme si dhe pjesëtarët e familjeve të tyre. Duhet të theksoj se në këtë kohë pjesëtarët e Forcave të Armatosura Bullgare ishin 130000 njerëz. Si rrjedhojë në vitin e parë që Liga nisi aktivitetin e saj, organizata kishte më shumë se 10000 anëtarë. Struktura e Ligës “Rakovski” ishte:

- Kongresi
- Këshilli i Konfederatave
- Federata a ushtarakëve të Ministrisë së Mbrojtjes dhe asaj së Brendshme
- Klube të lokalizuara në garnizone dhe reparte ushtarake

Themeluesit e Ligës kanë ndërmarrë këto detyra:

- Unifikimi i ushtarakëve me qëllim për të kuptuar qëllimet kombëtare
- Mbrojtja e interesave sociale dhe profesionale e anëtarëve të Ligës
- Përmirësimi i imazhit të profesionit të ushtarakëve dhe interesit social të anëtarëve të Ligës

Që nga ajo kohë e deri në ditët e sotme këto qëllime kryesore nuk kanë ndryshuar esencialisht.

Gjatë gjithë ekzistencës së saj, Liga “Rakovski” ka punuar edhe në nivel ndërkombëtar. Që prej vitit 1992 kjo organizatë është anëtare me të drejta të plota e organizatës europiane të shoqatave ushtarake “EUROMIL”.

Si pasojë e kushteve politike specifike, në vitet e para të demokracisë në Bullgari objektivat kryesore të shoqatës ishin:

- Depolitizimi i Forcave të Armatosura të Bullgarisë
- Krijimi i një ligji të ri për ushtrinë dhe policinë (pasi në vitin 1991 kishte një ligj të përbashkët për ushtrinë dhe policinë)
- Ushtarakët bullgarë të gëzonin të drejta të barabarta si qytetarët e tjerë bullgarë

Që nga viti 1991 deri në vitin 1995 bordi drejtues i Ligës “Rakovski” pati organizuar mjaft takime e diskutime me partitë politike për të kuptuar më mirë objektivat e vendosur. Në vitin 1995 parlamenti bullgar miratoi 2 ligje të rëndësishme: “Ligji për Ushtrinë” dhe “Ligji për Ministrinë e Brendshme”. Pas miratimit të këtyre ligjeve, oficerët e policisë ishin në gjendje të formonin sindikatën e tyre. Që nga ai moment “Legia Rakovski” ka funksionuar si një organizatë vetëm për ushtarakët, anëtarë të forcave të armatosura. Ligji i ri për Ministrinë e Brendshme i lejoi policisë për të themeluar dhe përfituar nga një sindikatë moderne, e cila gëzon të drejta të ndryshme. Por fatkeqësisht e drejta për t’u organizuar në shoqata e anëtarëve të forcave të armatosura ende ishte e ndaluar.

Në vitin 2001 kushtet politike të ndryshuara kërkuan edhe ndryshimin e objektivave dhe synimeve me qëllim zgjidhjen e problemeve më imediate. Si rrjedhojë anëtarët e Legia-s përvetësuan objektiva të reja:

- Lobimi në nivelet më të larta politike
- Miratimi i ndryshimeve në ligjin për ushtarakët për sa i përket të drejtave të shoqatave
- Rinovimi i strukturave organizative në të gjitha garnizonet
- Bërja e shoqatës partner kryesor i Ministrisë së Mbrojtjes në çështjet sociale dhe profesionale
- Mbështetja e anëtarësimit të Bullgarisë në NATO

Do të doja të përmendja këtu se “Liga” mori dhe vazhdon të marrë një mbështetje nga EUROMIL-i në ndërtimin dhe funksionimin e strukturave eficiente për mbrojtjen e interesave profesionale dhe sociale të ushtarakëve. Një ndër arritjet më të mëdha ishte në vitin 2002 kur parlamenti bullgar miratoi

ndryshimet në ligjin për ushtrinë në përputhje me sugjerimet e shoqatës në pjesën për të drejtën e organizimit në shoqata.

Në vitin 2004 Kongresi i Ligës “Rakovski”, ndryshoi statusin, por edhe strukturën duke i dhënë mundësi rreshterëve dhe privatëve për t’u bërë anëtarë të organizatës.

Që prej këtij viti struktura përmban:

- Kongresin
- Këshillin Kombëtar
- Gjashtë qendra rajonale – Sofja, Plovdiv, Yambol, Varna, Veliko, Tarnovo dhe Pleven
- Klubet në garnizone dhe reparte

Në periudhën 2004-2005 Legia punoi në dy drejtime kryesore:

- Mbështetja e anëtarësimit me të drejta të plota në BE
- Projektimi dhe angazhimi si një partner i Ministrisë së Mbrojtjes në projekte të ndryshme sociale:
 - o Zhvillimi profesional i ushtarakëve
 - o Përmirësimi i sistemit të shërbimeve sociale, sistemit të kujdesit të shëndetit për ushtarakët dhe familjarët e tyre.
 - o Zgjidhja “problemit të strehimit”
 - o Dizajnimi i një programi për kualifikimin profesional pas tërheqjes dhe mundësia e punësimit.

Nga 2007 deri më sot detyrat kryesore kanë qenë:

- Pjesëmarrja në grupe të ndryshme pune së bashku me Ministrinë për t’i siguruar statusin profesional dhe social ushtarakëve
 - Iniciativa të përbashkëta me organizata të tjera patriotike mbi restaurimin e memorialeve ushtarake
 - Pjesëmarrja në komitetin që po përgatit Ligjin e Ri të Ushtrisë.
 - Takimi me anëtarë të tjerë të shoqatës në garnizone me qëllim për t’u familjarizuar me problemet që ata kanë
 - Pjesëmarrja në festimet zyrtare kombëtare ose shtetërore.

III. Shoqata e Oficerëve Bullgarë “Rakovski” – partneritetet me departamentet e shtetit, partitë politike dhe organizatat joqeveritare.

Liga punon me të gjitha partitë politike dhe OJF-të në mënyrë që të kuptojë qëllimet e tyre. Në vitin 2001 u nënshkrua një marrëveshje me Sindikatën Kombëtare të Policisë me Unionin Profesional të zjarrfikësve. Të tri organizatat kërkuan një zgjidhje të përbashkët të problemeve kryesore me të cilat ato përballen.

Që nga viti 1999 Forcat e Armatosura Bullgare janë në proces reduktimi. Në vitin 2002 kjo reformë gati la të papunë 1000 ushtarakë të rinj. Si pasojë e mbështetjes së presidentit të Republikës së Bullgarisë, z. Georgi Parvanov, Liga “Rakovski” ia arriti me sukses për të shmangur këtë skenar dhe më shumë se 800 leitnantë dhe leitnantë të parë, shpëtuan pozicionin e tyre në forcat e armatosura.

Partnershipi i shoqatës me Ministrinë e Mbrojtjes tashmë është e bazuar në një “Marrëveshje Themelore”. Kjo marrëveshje rekomandon të drejtat dhe detyrimet e secilës palë në këtë partneritet. Aktualisht Legia është i vetmi partner i Ministrisë së Mbrojtjes në Bullgari, mbi mbrojtjen e interesave profesionale dhe sociale të ushtarakëve në shërbim aktiv. Marrëdhëniet midis Legia-s dhe Ministrisë bazohen në principin e barazisë.

Liga “Rakovski”, gjithashtu punon së bashku me të tjera departamente shtetërore, sindikata dhe unione kombëtare si dhe OJF.

IV. Perspektiva.

Pas anëtarësimit të Bullgarisë në Bashkimin Europian, Liga “Rakovski” ka pasur një rol kryesor në implementimin e modelit europian në shoqërinë bullgare dhe t’i sigurojë një vend të denjë në këtë model, anëtarëve të forcave të armatosura.

Për të ardhmen kjo shoqatë ka këto qëllime kryesore:

- Themelimi i konceptit “Qytetarë me Uniformë” në Bullgari
- Implementimi i të gjitha standardeve europiane për ushtrinë bullgare në shërbim aktiv
- Dizajnimi i projekteve të reja për mbrojtjen sociale të ushtarakëve dhe familjeve të tyre.

Megjithatë ai theksoi se nuk dëshironte të lërë përshtypjen se çdo gjë në bashkëpunimin mes Ligës dhe Ministrisë së Mbrojtjes shkon e patrazuar. Ndonjëherë shoqata përballet me vështirësi të ndryshme në bashkëpunimin me Ministrinë e Mbrojtjes, por problemet janë gjithmonë të një natyre të zgjidhshme nëpërmjet një dialogu konstruktiv dhe intensiv. Kjo edhe sepse Liga nuk punon kundër interesave të Ministrisë, por për Ministrinë në mënyrë që t’i sigurojë kushte më të mira ushtarakëve. Si rezultat organizatat tuaja të ardhshme nuk duhet të dorëzohen kur hasin probleme e vështirësi në komunikim me Ministrinë e Mbrojtjes dhe Shtabin e Përgjithshëm, por të kërkojnë mënyra për dialog me ta.

Në përfundim theksoi se aktivitetet e organizatave profesionale për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të ushtarakëve në përputhje me Ligjin për Ushtrinë janë shumë të rëndësishme jo vetëm për ushtarakët, por edhe për autoritetet ushtarake në mënyrë që objektivat kombëtarë që i janë caktuar Ministrisë së Mbrojtjes, të realizohen me sukses.

Dr. ARSHI ÇELA (Kol. ret)

TË DREJTAT E USHTARAKËVE NË LEGJISLACIONIN SHQIPTAR TË MBROJTJES

Kur flasim për liritë dhe të drejtat e qytetarëve, qofshin ato edhe me uniformë, në thelb flasim për demokracinë. Në këtë kuptim, evolucioni dialektik i zhvillimeve të shoqërisë dhe të strukturave publike të shtetit, është një shkallë e zgjerimit dhe pjekjes së demokracisë. Kështu ka ndodhur edhe me shoqërinë shqiptare dhe Forcat tona të Armatosura të pas viteve nëntëdhjetë. Nëse njëzet vjet më parë sundonte slogani “në ushtri nuk ka demokraci” tashmë jetojmë realitetin e ndryshuar ku Forcat e Armatosura janë një instrument demokratik dhe në shërbim të demokracisë.

Sidoqoftë ideja e demokracisë në ushtri, dikujt mund t'i duket paradoksale, nisur nga çfarë njihet e pranohet gjerësisht se FA i shërbejnë rendit kushtetues dhe demokracisë dhe kësisoj duhet të “vuajnë” disa kufizime të lirive të të drejtave të tyre. Profesionin e ushtarakut është nga të rrallët.

Profesionin e ushtarakut është nga të rrallët kur qytetari vullnetarisht zgjedh të rekrutohet e të shërbejë nën armë duke firmosur heqjen dorë nga disa liri e të drejta. Natyra e këtyre kufizimeve, jo vetëm në FA të vendit tonë kanë të bëjnë me disiplinën, bindjen, hierarkinë dhe shërbimin në kushte të atilla, që në disa raste mund të kërkojnë edhe vetëmohimin për hir të misionit.

Në të drejtën kushtetuese, pothuaj të të gjitha vendeve e në të gjitha kohërat gjenden argumente të bazuara ligjërisht dhe që justifikojnë karakterin objektiv të kufizimeve të disa lirive e të drejtave të ushtarakëve. Kushtetuta e Shqipërisë ndjek të njëjtat qëllime. Në nenin 17 të saj thuhet se “Kufizimet e të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë kushtetutë, mund

të vendosen vetëm me ligj, për një interes publik, ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Bazuar sa më sipër, i gjithë legjislacioni që rregullon funksionin dhe veprimtarinë e FA përmban kufizime të ndryshme të të drejtave të lirive, të cilat përbëjnë një privacion që rrjedh nga natyra e profesionit. Si të tilla FA si institucione kushtetues janë larg së qeni plotësisht demokratike, vetëm dhe vetëm për t'i shërbyer një demokracie të popullit.

Me qëllim që të shpallim qartë masën e lirive dhe të drejtave që ushtarakët gëzojnë si të gjithë qytetarët e tjerë dhe për të vënë një raport sa më të drejtë midis kufizimeve dhe moskufizimeve le t'i referohemi edhe një herë nenit 17 të Kushtetutës. Në të thuhet “Kufizimet nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën europiane të të drejtave të njeriut”.

Kufizimet e vendosura me ligj në rastin tonë, në përgjithësi janë brenda standardeve të së drejtës së vendit dhe të drejtës ndërkombëtare. Pa qenë nevoja të bëj referim sipas normave të dispozitave ligjore, po theksoj se kufizimet në ligjin shqiptar konsistojnë si më poshtë: Kushtetuta e Shqipërisë sanksionon në nenin 12 se FA ruajnë asnjësi në çështjet politike dhe i nënshtrohen kontrollit civil demokratik. Duke konsideruar çështjen e asnjësisë si një çështje themelore të pushtetit, në nenin 167, Kushtetuta sanksionon se “Ushtarakët e shërbimit aktiv nuk mund të zgjidhen ose të emërohen në detyra të tjera shtetërore dhe as të marrin pjesë në Parti Politike ose në veprimtaritë politike të tyre. Përkufizime të tilla të ngjashme për sa i përket asnjësisë politike të FA gjenden në shumicën e kushtetutave të vendeve demokratike dhe në legjislacionin mbi të drejtat e ushtarakëve. Kjo është e natyrshme dhe ky *ndalim* bazohet edhe në nenin 11/2 të Konventës Europiane për të drejtat e njeriut. Me gjithë rekomandimet e fundit të organizmave që merren me të drejtat e ushtarakëve, në kuadrin e OSBE-së apo EUROMIL-it, çështja e të qëndruarit të ushtarakëve jashtë partive politike dhe jashtë funksioneve të tjera publike të zgjedhur ose të emëruar, për demokracitë e reja do të vazhdojë të mbetet si është duke pasur parasysh edhe mjedisin social-politik kombëtar.

Në logjikën e këtyre kufizimeve të drejtpërdrejta të Kushtetutës ligji “Për statusin e ushtarakut vendos edhe disa kufizime të tjera ose ndalime për shkak të detyrës si cilësohen në ligj. Këto janë ndalime për t’u anëtarësuar në organizata ose shoqata me karakter politik ose sindikalist, ndalimi i ushtrimit të riteve fetare me uniformë, ndalimi i grevave, ndalimi për të shkuar jashtë shtetit pa marrë leje edhe nëse je me pushime. Disa kufizime të tjera në liritë dhe të drejtat e ushtarakut gjenden në Kodin Penal Ushtarak e në Ligjin e Disiplinës ku si dihet disa shkelje që për një qytetar të thjeshtë do të përbënin shkelje etike, për qytetarët me uniformë ato përbëjnë kundravajtje penale ose thyerje të rënda disiplinore të dënueshme me ligj.

Duket në pamje të parë sikur profesioni i ushtarakut është krejt i ndëshkueshëm dhe plot kufizime. Realisht nëse përjashtojmë ndalimet e kufizimet, korpusi i lirive e të drejtave qytetare për ushtarakët është shumë i gjerë dhe po zgjerohet. Duke mos synuar të bëj një analizë të gjendjes së respektimit të lirive e të drejtave të ushtarakëve në vendin tonë, por vetëm të prezantoj kuadrin ligjor më duhet të theksoj tre komente për dy shqetësime që sipas meje duhen kapërcyer.

Së pari, ushtarakët tanë, tashmë pjesë e strukturave ushtarake të aleancës janë të ndërgjegjshëm për sakrificat dhe vështirësitë që duhet të kapërcejnë për shkak të sfidave që shfaq siguria kombëtare e ndërkombëtare. Në këtë kuptim, në perceptimin tim, ata i pranojnë kufizimet ligjore dhe për momentin nuk kërkojnë zgjerim të lirive politike, të besimit, të shprehjes, të kohës së punës e të pushimit etj. Në formimin politiko-juridik të ushtarakëve tanë është e qartë se pa ligje të forta e rregulla të qarta nuk mund të kemi struktura të disiplinuar, *ofenciale*, kompakte dhe të bindura plotësisht ndaj hierarkisë së zinxhirit të komandimit.

Së dyti, në kuadrin e fenomenit të ashtuquajtur “dilema e komandimit në përmbushje të misionit” komandat dhe shtabet priren aty-këtu për të ngarkuar vartësit me detyra, duke kapërcyer në disa raste kufizimet sipas ligjit. Është rasti këtu të tërheq vëmendjen për një mungesë të disa akteve nënligjore ose rregulloreve që duhet të japin kuptim objektiv dispozitave

ligjore. Po përmend këtu problemin e të ashtuquajturit depolitizim. Është e qartë se ushtaraku s'mund të jetë anëtar partie, se s'mund të kandidojë për një forcë politike, se s'mund të bëjë fushatë si pjesë e shtabeve elektorale etj. Nga ana tjetër nuk është e qartë se si ushtaraku realizon të drejtën e shenjtë të zgjedhjes me votë të lirë, kur ai nuk di nëse është i lirë të marrë pjesë në takimet e forcave politike me elektoratin e lagjes së tij, nëse ai mund të kërkojë të njihet me programet qeverisëse që partitë shpalosin gjatë fushatës. Deri tani ecet sipas parimit “rri larg për të qenë brenda”. Në rregullat tona të jetës së brendshme, rregullime e normime të këtyre të drejtave mungojnë dhe rastet që mund të paraqiten anashkalohen. Ne e kemi ende të paorganizuar edukimin me kulturën elektorale qoftë edhe me ushtarët e shërbimit të detyrueshëm. Ne ende nuk jemi të qartë nëse në *gazerma* duhen organizuar shpjegime rreth Kodit elektor, standardeve të zgjedhjeve, infrastrukturës zgjedhore etj. Ky problem qëndron edhe me të drejtën e Komandave për të thirrur vartësit në punë e në shërbim jashtë orarit, në ditët e pushimit e të festave pa pagesë. Kjo çështje është rregulluar me ligj ku thuhet se si përjashtimi, për natyrë të misionit e të karakterit operacional efektivat mund të punojnë në ditët festive. E parregulluar me akte nënligjore kjo dispozitë është disi e bardhë dhe lë shteg për teprime. Në këtë kuadër procesi i modernizimit të legjislacionit dhe ripunimi i rregullores së jetës së brendshme duhet të parashtrajnë saktësisht rastet kur ushtarakët mund të punojnë tej kohës normale të punës për natyrë të misionit e të operacioneve, dhe kur kanë të drejtë t'i thonë jo abuzimeve.

Së treti, legjislacioni ushtarak ka bërë hapa përpara në mbrojtje të së drejtës së ankimit. Në ligjin për statusin e ushtarakut e drejta e ankimit iu njihet ushtarakëve jo vetëm si një e drejtë individuale, por edhe kolektive. Jo vetëm kaq, por vetë ligji shprehet se ushtarakët në grup mund të bëjnë propozime, të së drejtës së ankimit. Në ligjin për statusin e ushtarakut e drejta e ankimit iu njihet ushtarakëve jo vetëm si një e drejtë individuale, por edhe kolektive. Jo vetëm kaq, por vetë ligji shprehet se ushtarakët në grup mund të bëjnë propozime, kërkesa, ankesa për veprimet që u preken të drejtat

e tyre. Madje ligji lejon që këto kërkesa e ankesa mund të bëhen me shkrim e t'ua drejtojnë autoriteteve të larta. Askush, sipas ligjit s'mund të ndëshkohet për shkak se ka bërë një ankim ose kërkesë. Problemi është se ky nen që shpall një të drejtë themelore, mbetet evaziv nëse nuk zgjidhet e drejta e organizimit të grupit, për të mbrojtur një të drejtë kolektive. Me fjalë të tjera ligji shqiptar i ndalon apo i lejon ushtarakët të vetorganizohen në unione ose përfaqësi të zgjedhura prej tyre për të materializuar të drejtën e ankimit kolektiv? Nëse në një moment një grup ushtarakësh, sipas të drejtës që iu jep ligji, do të trokisnin në zyrën e komandantit dhe do të kërkonin një ambient ku të mblidhen, mjetet e zyrës për të formuluar dhe shkruar ankesën, lehtësira për ta dërguar ankesën në instancat shtetërore dhe do të identifikonin njërin prej tyre si lider të grupit për negociata e për të marrë përgjigje, atëherë çfarë qëndrimi do të mbante komandanti? Në ndonjë rast unë e kam shtruar këtë pyetje para studentëve të mi dhe kam lexuar si përgjigje hutim dhe pasiguri, më e shumta ndonjë mërmërimë: Pse jo pedagog. Mirëpo gjërat duhen zgjidhur në rrugë ligjore dhe me rregulla.

Le t'i referohemi së pari Kushtetutës

Neni 46. Kushdo ka të drejtë të organizohet kolektivisht për çfarëdo qëllimi të ligjshëm. Vetëm organizatat ose shoqatat që ndjekin qëllime antikushtetuese janë të ndaluara me ligj. Cilat janë ndalimet me ligj në të drejtën e ushtarakëve për t'u organizuar kolektivisht? Në nenin 16 të ligjit për statusin e ushtarakut thuhet se ushtarakëve u lejohej të organizohen në shoqata, të cilat nuk kanë karakter politik ose sindikalist. Nëse këtë ndalim e interpretojmë në lidhje me nenin 19, i cili ndalon partitë dhe shoqatat politike si dhe të drejtën e grevës, kjo do të thotë se një shoqatë që nuk regjistrohet dhe nuk funksionon si sindikatë, domethënë që nuk bën demonstrime, braktisje të punës, ndërprerje të punës, grevë e të tjera do të mund të konsiderohej krejt e ligjshme.

Panorama që na u dha këtu nëpërmjet ekspertizës së prezantuar nga përvojat europiane, të Gjermanisë, të Italisë, të Bullgarisë etj. janë inkurajuese për të menduar edhe ne t'i

japim kuptim të plotë të drejtës ligjore të mbrojtjes kolektive të të drejtave dhe lirive themelore. Si bëhet e qartë, legjislacioni ynë në lidhje me të drejtat e ushtarakëve, në krahasim me legjislacionin e vendeve të tjera të NATO-s, e sidomos me Konventën Europiane të të drejtave të njeriut janë pothuaj harmonike. Rregullimet dhe përputhjet janë të mundshme duke iu drejtuar përsëri Kushtetutës tonë.

Sipas nenit 17 të Kushtetutës kufizimet me ligj të të drejtave nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të drejtave dhe në asnjë rast, theksoj, në asnjë rast, nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të drejtat e njeriut. Kjo Konventë që qëndron në tërë përmbajtjen e Kushtetutës tonë është ratifikuar nga Parlamenti Shqiptar që në vitin 1994 dhe tashmë edhe Gjykata e Strasburgut është familjare për ne. Sipas nenit 122 të Kushtetutës tonë “Një marrëveshje ndërkombëtare e ratifikuar me ligj ka epërsi mbi ligjet e vendit që nuk pajtohen me të”. Baza ligjore ekziston, eksperiencia e aleatëve është e larmishme, koha ka ardhur, vullneti nuk mungon. Me sa duket është çështje iniciative.

Duke konkluduar mund të themi se kuadri ligjor i të drejtave dhe lirive themelore të ushtarakëve shqiptar, nuk është i ndryshëm nga i vendeve të tjera. Ndoshta aktet nënligjore janë ato që do të kërkonin një rishikim dhe rregullim më të mirë për të mundësuar procedurat e sakta e të harmonizuara për të qenë edhe ne një hap me standardet e ushtrive të vendeve të NATO-s ku tashmë jemi anëtare.

Kol. Dr. Arshi Cela
Pedagog Akademia Ushtarake

KOL. GJOKË LLESHI

PËRSE ËSHTË E NEVOJSHME NJË STRUKTURË, E CILA MBËSHTET USHTARAKËT: PERSPEKTIVË NGA NJË OFICER SHQIPTAR, PJESËMARRËS NË OPERACIONE PAQERUAJTËSE

Departamenti i Shkencave Sociale është një nga katër departamentet e Akademisë së Mbrojtjes, i cili ka si mision të japë mësim rreth shkencave sociale si sociologjia, drejtësia, psikologjia e etikave etj. Programi i këtyre subjekteve është shumë i rëndësishëm për studentët e kategorive: komandant, major dhe kolonel lokotenent aq mirë sa kategoritë për kolonel. Misioni i Departamentit të Shkencave Sociale është që të edukojë studentët me temat bazë të shkencave sociale. Synimi i programit është të përgatisë gjeneratën e re të oficerëve të ndërmarrin në duart e tyre lidhshpirtin e Akademisë së Forcave Ushtarake (AFU). Për këtë arsye ne jemi duke bërë të pamundurën tonë për t'i edukuar ata sipas standardeve të NATO-s, si anëtarë më të ri të Aleancës.

Ngjarjet e sotshme tregojnë angazhimin tonë të plotë në këtë drejtim. Kurset janë të lidhura dhe vazhdojnë për një periudhë kohore nga 3 muaj për komandantët deri në një vit për të tjerët. Ashtu si është përmendur dhe nga parafolësit misioni i akademisë së mbrojtjes është që të trajnojnë dhe të edukojnë oficerët e Akademisë së Forcave Ushtarake (AFU). Bashkëpunimi midis Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim dhe Akademisë Shqiptare të Mbrojtjes me mbështetjen e Friederich Elbert Stiftung na dha në këtë mundësi për të qenë së bashku dhe të ndajmë idetë me përfaqësuesit e tyre të nderuar. Për këtë arsye dua të falënderoj

përfaqësuesit e EUROMIL për pranimin e ftesës për të qenë prezent në një aktivitet të tillë.

Një falënderim i veçantë shkon për z. Sotiraq Hroni, në kapacitetin e tij si Drejtor Ekzekutiv i Institutit për Demokraci dhe Ndërmjetësim (IDM), i cili na dha ne shansin për të qenë së bashku dhe për të ndarë idetë në princip të Qytetarëve me Uniform, aq mirë sa i dërguari i Avokatit të Popullit të Shqipërisë, i cili është prezent në konferencën tonë të përbashkët në mënyrë që të bindin vetveten e tyre të mbështesin komunitetin ushtarak, të mbrojnë të drejtat e tyre dhe liritë. Kjo nuk do të thotë se një ushtarak ka të njëjtat të drejta dhe detyrime si qytetarët e tjerë. Një ushtarak, i cili shërben për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive në mënyrë të barabartë të të gjithë qytetarëve si dhe rregullin kushtetues të vendit të tij, ka të drejtën t'u gëzohet dhe të njohë të njëjtat të drejta dhe liri demokratike.

Është vlerësuar pjesëmarrja e Shefit të Stafit Gjeneral të Akademisë së Forcave Ushtarake (AFU), Gjeneral Malaj, në këtë konferencë në të njëjtën kohë me forumin kryesor mbarë europian për bashkëpunim për shkëmbim eksperiencash midis shoqatës ushtarake profesionale si rrjedhojë e interesit të përbashkët.

Duhet t'u them se e ndiej veten të liruar për t'u adresuar një lloj audience si e jona. Ashtu si keni qenë të mirinformuar nga kolegët e mi, programi i sotshëm është shumë i ngjeshur, sidoqoftë do dëshiroja të merrja pak kohë për të shprehur disa ide rreth temës pse është e nevojshme një strukturë, e cila duhet të mbështesë ushtarakët. Gjatë ndërhyrjes sime u përpoqa të formuloj pak qasjet psikologjike dhe aspektet e këtij organizimi potencial.

Forcat mbrojtëse në Shqipëri dhe Europë vuajnë ndryshimet strukturale duke karakterizuar një rritje teknologjike të materies së mbrojtjes, dublifikim të personelit, rritjen e kontratave të punës temporale dhe rritjen e pjesëmarrjes në operacione të vështira jashtë zone. Shtete të veçanta kërkojnë të rrisin limitimet ekzistuese në të drejtat civile dhe sociale të ushtarakëve, i cili nuk rezulton në mënyrë të pashmangshme nga detyrat ushtarake.

Eksperienca e shumë dekadave ka treguar se këto vende, të cilat kanë akorduar asocim të plotë të të drejtave për ushtarakët e tyre nuk ka eksperimentuar ndonjë humbje të eficiencës ushtarake ose të disiplinës. Përkundrazi, bërja pjesë në një dialog permanent me asocimet e ushtarakëve në kushtet e tyre sociale dhe të punës ka ndihmuar në bashkimin e ushtarakëve më afër organizatës ushtarake dhe de facto rrit moralin dhe besnikërinë midis trupave. Asocimet demokratike ushtarake nuk ndërhyjnë në çështjet e brendshme ose të politikës së jashtme, as në strategjinë e mbrojtjes e as në vendimet operacionale. Edhe pse në dy rastet e fundit ata mund të rrisin, legjitimojnë çështjet auziliare që influencojnë personelin.

Ashtu si dhe ju dini Ushtria, e cila ka qenë aktivisht e zënë në operimet ushtarake të Kombeve të Bashkuara (KB) dhe NATO që nga fillimi i viteve '90, duke përfshirë pjesëmarrjen e bashkuar në misionin e Gjirit Persik, u përballën me shumë vështirësi. Ky operacion luftarak i veçantë më vonë u ndryshua për misionet paqeruajtëse në territorin e ish-Jugosllavisë/Afganistan, kjo është arsyeja pse ushtri të ndryshme kanë eksperiencë të mjaftueshme në këto aksione ushtarake kur ata u bashkuan me KFOR/ISAF. Përveç kërkimeve të drejtuara gjatë viteve të fundit, të cilat ishin fokusuar në kushtet psiko-sociale të ushtarëve në misionet SFOR (Bosnja dhe Hercegovina), studimi i KFOR/ISAF nxori në dritë mjaft të dhëna të reja, të cilat janë relevante jo vetëm për këtë aksion, por gjithashtu në misionet e tjera të jashtme të ushtarakëve.

Ushtarët mësojnë të jenë të besueshëm ndaj aftësive të tyre për të qenë fleksibël në çdo situatë të mundshme. Aspekti emocional i personaliteteve të tyre i lejon ushtarët të adaptohen në disa ndryshime të shpejta skenarësh. Ata gjithashtu duhet të përballen për më shumë me problemet e tyre personale dhe ndërpersonale. Është e rëndësishme të biesh dakord me një shumëllojshmëri temash që influencojnë performancën e përgjithshme të ushtarëve. Komforti dhe diskomforti i ushtarëve, në veçanti kushtet mendore, struktura e marrëdhënieve si dhe cilësia e komunikimit duhet të shikohet. Përfitimi personal i misionit për një ushtar, kushtet materiale dhe sociale si dhe një shumëllojshmëri e arsyeve të lidhura

me misionin janë të gjithë faktorët që influencojnë mentalitetin e ushtarëve, por dhe të punës.

Shkaqet potenciale të stresit duhet të gjenden për mbajtjen e një impakti potencial të ulët. Nuk është e rëndësishme cilët faktorë specifikë influencojnë një ushtar nga një më i lartë ose në një shtrirje inferiore për shembull ndarja nga shtëpia e tij, humbja e përkohshme ose permanente e privatësisë (individualizmit), konfliktet familjare, vështirësitë e detyrave, diskomforti, aktivitetet monotone, izolimi. ADAPTIMI në jetën e tyre të re përcaktojnë NIVELIN e KËNAQËSIVE të tyre, dhe si është shprehur në kushtin mendor aktual.

Kërkimi psiko-social midis anëtarëve të misioneve të huaja bashkon zonat për nevojë të Stafit Gjeneral dhe të komandamentit të ushtrisë të shteteve të veçanta për të marrë dhe vlerësuar informacionet konkrete nga zona e misionit dhe të krahasojë këto rezultate me ato të kërkimeve të mëparshme. Disa tipa problemesh ndodhin rregullisht në të gjitha misionet. Nuk është një pyetje për eliminimin e problemeve lokale, por e shkaqeve kryesore, përsëritja e të cilave shkakton probleme themelore etj. Për shembull influenca e selektimit të disa fenomeneve negative u rishfaq më vonë, gjatë misionit, duke influencuar marrëdhëniet midis komandanteve dhe stafit duke influencuar në problemet logjistike etj. Treguesit e qartë të zhgënjimit midis anëtarëve të bashkimit mund të drejtojnë propozimin për klasifikim socio-teknik të barabartë, i cili minimizon ose eliminon risqet dhe shkaqet. Qëllimet e stabilizimit të strukturave, të cilat mbështesin zonën ushtarake për nevojat që ka Stafi Gjeneral dhe Komandamenti i Forcave Paqësore të ushtrisë për të qenë në mënyrë të vazhdueshme i informuar për analizën e situatës për interesat e çdo dite.

Kjo do të mund të ndihmojë në zgjidhjen e monotonisë dhe lodhjes së ushtarëve i shkaktuar nga pozicioni dhe preokupimet e tyre. Në qoftë se ata identifikojnë rritjen e monotonisë ata mund të këshillojnë, për shembull, mbështetje speciale që do t'i ndihmonte të eliminonin aktivitetet monotone, sursa dominante e stereotipit dhe automatizimit, e cila nënkupton rritjen e lodhjes më së miri. Disa në mënyrë të paqartë shqetësohen për të ardhmen e profesionit të zonave

ushtarake nga kjo sjellje. Pas kthimit nga misioni një numër i konsiderueshëm i ushtrisë mendon rreth largimit nga ushtria dhe kthimin në jetën civile. Mbase duket e çuditshme, më shumë se gjysma e ushtrisë pret një përmirësim të cilësisë të jetës së tyre personale dhe familjare. Kjo mund të asociohet me përmirësimin e stilit të tyre të jetës, bazuar në shpëtimin e lekëve. Mund të sinjalizoj prezencën e ushtrisë për të zgjidhur problemet e tyre personale duke u larguar nga shtëpia nëpër misione. Kjo zakonisht nuk funksionon. Problemet shfaqen pasi ushtarakët kthehen. Pjesa më e madhe 2/3 e tyre do t'u kërkojnë shokëve ose të afërme ndihmë.

Një diagnostik duhet të drejtohet në bashkim duke përfshirë dhe komandën. Rezultatet e kësaj diagnostike identifikojnë një gjendje mendore midis ushtrisë dhe një niveli aktiviteti, iniciative, dëshire për veprim kombinuar me këmbëngulje, një ndjenjë kënaqësie, fuqi dhe energji. Vetëkontrolli i mirë dhe vetërregullimi me një nivel të ulët të tensionit dhe mungesë të ankthit duhet marrë parasysh.

Përveç disa rregullimeve socio-teknike që mund të propozohen nga Stafi Gjeneral bazuar në rezultatet e disa prej këtyre janë të lidhur me bashkimin dhe gjithashtu me mirëqenien e pjesëmarrësve të misioneve të huaja. Rezultatet implikojnë presion, justifikim dhe përdorim të praktikave të njëjta si dhe zgjidhjeve në Ushtri. Në këtë ndërhyrje ne përpiqemi të tregojmë se përveç ndalesave të papritura, vështirësive dhe problemeve marrëdhëniet, jetën në brendësi, si dhe adaptimin me kushtet e vështira në zonën e sigurisë logjistike dhe teknike ushtarët shqiptarë janë “djemtë e mirë në vendet e duhura”.

E ardhura mesatare e një ushtrie shqiptare në mision është afërsisht pesë nga dhjetë herë më e lartë se të ardhurat e tij në vendin e tij. Ushtarët tanë shpesh zgjidhin situatat e tyre ekonomike të rënduara ose që familjet e tyre marrin pjesë në misionet e huaja. Krahasuar me ushtarët që shërbejnë në vendin e tyre është për t'u vlerësuar tendenca patriotike si dhe faktorët e asociuar me rritjen profesionale. Kjo sfidë, lloj situatë ndikon te një zgjerim shumë i madh ose inferior të strukturës së personalitetit, dinamikës së perceptimit, sjelljes së gjithsecilit

të përfshirë në mision të disa niveleve aq mirë sa influencojnë sistemin e vlerave në pjesën më të madhe të personalitetit. Në mënyrë që të modernizojmë forcat e armatosura shqiptare ne mendojmë që duhet të ndryshojmë mentalitetin nëpërmjet edukimi adekuat dhe intensiv të personelit ushtarak. Ne duhet t'u sigurojmë oficerëve, sergjentëve dhe vullnetarëve me përkufizimin e nivelit të përgjegjësive dhe përgjigjeve individuale jo vetëm në ushtrimin e lidërshiptit, por gjithashtu në të drejtën ushtarake dhe aspektet e të drejtës ligjore humane.

Për krijimin e një atmosfere jo të varur si pasojë e reduktimit si shembull i abuzimit brenda forcave të armatosura aq mirë sa të kontribuosh në parandalimin e mungesës së rrezikut, një përjasje pritet të bëjë të mundur vendosjen e një strukture karakteristike, e cila do të mbrojë dhe mbështesë personelin ushtarak nga urdhrat jo të ligjshme ose të vepruarit ilegal të administratës. Në mënyrë që të sigurohen të drejtat njerëzore të personelit ushtarak janë respektuar kazermat si dhe jashtë tyre është esenciale që ligji, rregullat dhe mbrojtja e të drejtave njerëzore të jetë në fuqi, dhe në mënyrë efektive modifikimet e tyre të jenë të vlefshme për t'u përballur me ndonjë dhunim që mund të shfaqet.

Prezenca e trupave të përafërta është e nevojshme për të siguruar të drejtat çdo ditë të jetës së ushtrisë. Një asocim ushtarak respekton në mënyrë të plotë kreun e komandës dhe nuk bën falje brenda komandamentit të forcave ushtarake. Kjo përjasje është fokusuar në mbajtjen e një strukture, e cila e bën ushtrinë përgjegjëse të plotë për veprimet e saj edhe pse ata janë duke vepruar sipas urdhrave të dhëna nga superiorët. Kjo siguron faktin që personeli ekzekuton urdhrat joligjore ose duke vepruar ilegalisht me iniciativën e tyre gëzojnë përgjegjshmëri individuale për ofensivat ose krimet e bëra.

*Kolonel Gjokë Lleshi,
shëf i Departamentit të Shkencave Sociale*

EDITSON ZARKA, N/Kolonel

PSE ËSHTË E NEVOJSHME NJË STRUKTURË, E CILA MBËSHTET FORCAT USHTARAKE

Proceset e **integritimit Euro-Atlantik** ku është përfshirë shoqëria shqiptare, si dhe kërkesat gjithnjë në rritje të mbrojtjes dhe **respektimit të lirive themelore dhe të drejtat e njeriut**, janë dy shinat në të cilën ecin edhe Forcat tona të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Futja e vendit tonë në **NATO** në vetvete përmban shumë sfida dhe shanse për të ardhmen. Këto janë të lidhura me transformimin e mëtejshëm të Forcave tona të Armatosura, rritjen e kërkesave për sigurinë njerëzore, mbështetjen më të madhe për ushtarakët që dërgohen në misione jashtë vendit, si dhe familjeve të tyre.

Nevoja për t'u organizuar në një shoqatë profesionale është një kërkesë e diktuar nga koha që jetojmë. Ajo do të rrisë spektrin e përfaqësimit dhe të mbrojtjes së të drejtave të ushtarakëve, krahas organeve të tjera që operojnë në këtë fushë.

Sa herë që shfaqet një ide e re, një projekt apo koncept i ri mendja të shkon te pyetja se sa efektiv do të jetë ai. A do ta realizojë ai misionin për të cilin krijohet? Krijimi i shoqatës së ushtarakëve ka të bëjë me shtimin e një elementi të ri të rëndësishëm, të një forumi ku mund të shprehemi më lirshëm për aspektet e jetës sonë të përditshme, vendi ku mund të zgjerohet sfera e mbrojtjes më mirë të interesave të ushtarakëve. Ky element shpeshherë do të vendoset midis shtetit nga njëra anë dhe individit nga ana tjetër. Në këto kushte ai nuk duhet as të instrumentalizohet nga politika apo komanda dhe as të hyjë në ato pjesë të jetës së ushtarakëve, për të cilat ka struktura dhe organizma që i trajtojnë dhe u japin zgjidhje në bazë të ligjeve dhe rregulloreve që janë në

fuqi. Që të mos biem në pozitat e shprehura më sipër pa dyshim që do të kërkojmë ndihmën dhe asistencën e aleatëve tanë, e cila nuk na ka munguar as gjatë fazës së anëtarësimit në NATO dhe as tani, si është edhe takimi i sotëm.

Ushtarakët në tërësi paraqiten si një grupim interesi i veçantë shoqëror, i cili ndryshon nga grupet e tjera të interesit. Prezantimi më i mirë i interesave të këtij grupi gjatë hartimit të akteve ligjore/nënligjore, si dhe gjatë procedurave që prekin interesat ekonomike, shoqërore, sociale të tyre do të rriste spektrin e përfaqësimit dhe të drejtat legjitime të ushtarakëve etj. Me krijimin e bazës ligjore për ushtarakët janë hedhur hapa shumë të rëndësishëm përpara gjë që çoi edhe në anëtarësimin tonë në NATO. Çështja shtrohet më tej nëse ka vend për një përfaqësim më të plotë të ushtarakëve gjatë përpilimit dhe zbatimit të këtyre akteve? Sa dhe si dëgjohet zëri i tyre gjatë zbërthimit të këtyre ligjeve në akte nënligjore, apo norma të tjera procedurale? Sa sigurohen të drejtat që i japin ligjet ushtarakëve? A ka vend për më shumë vëmendje në të ardhmen?

Me të drejtë shtrohet pyetja se cila është fusha e veprimit të shoqatës së ushtarakëve, cila është sfera e veprimit të veprimtarisë së saj, kush mund të marrë pjesë në të? Duke parë edhe përvojën e vendeve të tjera, mund të themi se ajo do të përfshijë:

- Ushtarakët e të gjitha kategorive nga oficerët më madhorë e deri tek ushtarët më të thjeshtë, përfshirë edhe familjet e tyre.

- Mbrojtjen shoqërore dhe të drejtat që i jep ligji, për një zbatim sa më të plotë të tyre nëpërmjet hartimit të politikave të posaçme për këtë qëllim.

- Përfitimim nga skemat e sigurimit shoqëror dhe shëndetësor.

- Lehtësimin real nga taksat dhe tatimet, duke i kthyer ato në rezultate reale dhe të prekshme.

- Mbështetjen e gjithanshme për ushtarakët që do të marrin pjesë në operacionet dhe misionet jashtë vendit.

- Rritjen e mëtejshme të dinjitetit të ushtarakut etj.

Përfaqësimi duhet të mbulojë edhe fusha të tilla si asistencën në periudhën e ndërprerjes së karrierës, këshillime për benifitet ushtarake, ndihmë për arsimimin e fëmijëve të ushtarakut, si dhe aktivitetet e profesionalizmit ushtarak. Komandantët luajnë një rol kyç në të gjitha aspektet **ushtarake, shoqërore dhe morale** të njësisë së tyre.

Aspektet ushtarake

Ushtaraku është një qenie njerëzore, e cila me futjen në forcat e Armatosura ka dhënë një pjesë të lirisë së tij, në emër të detyrës, rregullores dhe misionit që ka njësia apo reparti ku ai është rreshtuar për kryerjen e këtij shërbimi. Komandantët e të gjitha rangjeve kanë si qëllim kryesor përmbushjen e misionit, detyrave dhe ligjit. Kjo është një gjë normale, sidomos në kushtet e stresit dhe ngarkesës që kanë kur ata janë në realizimin e misioneve dhe detyrave të vështira si brenda ashtu edhe jashtë vendit. Nga ana tjetër komandantëve iu kërkohet të jenë afër vartësve të tyre, të dinë hallet dhe problemet e tyre, t’ju lehtësojnë dhimbjet dhe ngarkesat që ata përjetojnë në raste dhe situata të tilla. Krahas përvojës pozitive të komadave të niveleve të ndryshme, të cilat kanë bërë dhe bëjnë shumë për përmbushjen e të drejtave të vartësve të tyre, shpeshherë, me ose pa dashje ka edhe nënvlerësime dhe ndonjëherë neglizhenca në aspektet që lidhen me këto të drejta dhe liri të vartësve të tyre.

Të konsideruar si *“qytetarë nën uniform”*, personeli i forcave të armatosura gëzon të njëjtat të drejta dhe liri si të gjithë personat e tjerë, megjithëse ata janë subjekt i disa kufizimeve të imponuara nga shërbimi ushtarak. Shtetet sovraane kanë privilegjin të përcaktojnë se cilat kufizime të të drejtave të personelit ushtarak janë të nevojshme të bëhen, për sa kohë këto kufizime janë në përputhje me standardet e të drejtave të njeriut, të autorizuara nga ligji dhe të justifikuara nga objektiva legjitime. Në shoqëritë demokratike të gjithë janë të barabartë përpara ligjit. I tillë konsiderohet edhe ushtaraku si i barabartë midis të barabartëve.

Në mënyrë që të sigurohemi për respektimin e të drejtave njerëzore brenda garnizoneve ushtarake, pikësëpari është e rëndësishme ekzistenca e ligjeve dhe rregulloreve me anë të së cilave sigurohet mbrojtja e të drejtave njerëzore dhe dhënia e zgjidhjeve efektive në rastet kur këto të drejta shkelen. Dihet që çdo ushtarak, individualisht, mund të bëjë padi në gjykatë për të siguruar respektimin e të drejtave të tyre njerëzore, qofshin këto vepra penale, civile apo shkelje administrative. Padia në gjykata përbën mjetin e fundit për zgjidhjen e të drejtave të tyre. Gjithashtu në rastet kur kemi thyerje të rregullit dhe disiplinës, komandantët kanë përgjegjësinë kryesore për t'u marrë me to dhe për të ushtruar sanksione që i jepen nga ligjet dhe rregulloret ushtarake.

Megjithatë vetëm ekzistenca e një kuadri ligjor të përshtatshëm nuk është e mjaftueshme për të siguruar respektimin e këtyre të drejtave në jetën ushtarake të përditshme. Lufta kundër shkeljeve të së drejtës nuk kufizohet vetëm me masa dënimi ose me dëmshpërblim. Një rëndësi të dorës së parë për forcimin e rendit juridik kanë edhe masat paraprake për ndalimin e shkeljes së ligjit, forcimit të ndërgjegjes juridike të shtetasve dhe të ushtarakëve. Zbulimi i vazhdueshëm i shkeljeve të së drejtës dhe zbatimi i masave shtrënguese kundrejt shkelësve të së drejtës jo vetëm i detyron këta që t'i nënshtrohen ligjit, por njëkohësisht rrënjos në të gjithë efektivin bindjen se asnjë shkelje e ligjit nuk mbetet e padënuar. Dhe ky është një faktor shumë i madh për forcimin dhe sigurimin e rendit juridik edhe në veprimtarinë tonë të përditshme.

Komandantëve u kërkohet respektimi i të drejtave të njeriut të personelit që ata drejtojnë. Ata kontribuojnë në krijimin e një atmosfere mirëbesimi midis ushtarakëve, ndonjëherë edhe duke deleguar përgjegjësi te vartësit e tyre. Këtij qëllimi do t'i arrihet më mirë me anë të trajnimit të këtyre efektivave për ligjet ushtarake, të drejtat e njeriut dhe ligjin humanitar ndërkombëtar. Këto trajnime janë futur edhe në programet e Forcave tona të Armatosura, megjithatë komandantët duhet të binden që efektivat e tyre kanë marrë njohuri të plota për këto subjekte, si dhe i dinë format e prezantimit të shqetësimeve të tyre kur kemi thyerje të tyre.

Aspekte të natyrës ekonomike dhe shoqërore

Tani dua të ndalem pak tek ato fenomene, të cilat shqetësojnë disi masën e madhe të ushtarakëve tanë, të cilët mund të diskutohen, trajtohen dhe të gjejnë një mbështetje më të plotë nga shoqata e ushtarakëve. Kjo ka të bëjë me aspektet e natyrës ekonomike dhe shoqërore, duke përfshirë strehimin, trajtimin shëndetësor, sigurimin shoqëror, argëtimin etj.

Strehimi i ushtarakëve ka qenë dhe mbetet një problem i pazgjidhur plotësisht për shoqërinë shqiptare në përgjithësi dhe për komunitetin ushtarak në përgjithësi. Deri tani, duke pasur në konsideratë motivimin dhe mbajtjen e personelit në Forcat e Armatosura, është punuar për krijimin e një fondi të veçantë për strehimin. Ky fond aktualisht është në vlera simbolike dhe nuk zgjidh të gjitha nevojat në rritje të personelit të FA. Nga ana tjetër për një kategori personeli të FA është vënë në funksionim dhënia e disa banesave të ish-reparteve ushtarake, por në shumë raste nuk është zgjidhur deri në fund problemi i kthimit në pronësi të tyre, megjithëse me status ekziston e drejta e parablerjes etj. Duke pasur parasysh këto raste konkludojmë se kemi të bëjmë me një problematikë që kërkon më tepër vëmendje për t'u zgjidhur në të ardhmen. Ndërhyrja në përgatitjen e akteve nënligjore, politikat e strehimit, si dhe shfrytëzimi i të gjithë resurseve dhe kuadrit ligjor ekzistues për këtë problem mund të jetë një nga sferat e veprimtarisë së shoqatës së ushtarakëve në të ardhmen, për të asistuar komandat dhe strukturat përkatëse për një zgjidhje afatgjatë për personelin e FA dhe familjeve të tyre.

Kryerja e studimeve për të parë mundësinë e krijimit të kushteve të strehimit të ushtarakëve nëpërmjet ndërtimit të godinave për strehim në garnizonet e mëdha, apo mundësive të tjera që mund të krijohen mbetet një detyrë për të ardhmen. Gjithashtu praktika e dhënies së kredive të buta për të gjithë personelin ushtarak për ta shlyer atë në një periudhë 10-15-vjeçare derisa ai të bëhet pronar i banesës së tij do të ndikojë ndjeshëm në zgjidhjen e këtij problemi jetik.

Trajtimi shëndetësor është një aspekt që ndikon direkt në shëndetin e ushtarakëve dhe të familjeve të tyre, të cilat

lidhen pazgjidhshmërisht me forcën dhe fuqinë e njësisë ku ata shërbejnë. Me anë të statusit, ushtarakut i ofrohet shërbimi shëndetësor falas si dhe lehtësira në përballimin e taksave dhe tatimeve, apo skemave të rimbursimeve të ilaçeve e medikamenteve të ndryshme. Gjatë këtyre viteve është bërë një punë shumë e mirë për konsolidimin e sistemit shëndetësor, përmirësimin e infrastrukturës së spitaleve e klinikave mjekësore, përkujdesjes shëndetësore etj. Gjithashtu një vend të rëndësishëm ka zënë edhe trajtimi shëndetësor i ushtarakëve, ish-ushtarakëve apo familjeve të tyre jashtë vendit në spitale tepër të specializuara, duke përfituar nga programet e bashkëpunimit me vendet e tjera si Turqi, Greqi, Itali etj. Por ne jemi ata që përballemi me realitetin ditor të këtij shërbimi. A jemi ne të shërbyer dhe të mbrojtur sa dhe si duhet nga ky shërbim? A ka më shumë vend për t'i prezantuar dhe mbrojtur këto të drejta që na i jep statusi dhe ligji? Ku jemi ne në raport me vendet aleate, shërbimin e të cilit e kemi parë dhe e shohim duke qenë në krah të tyre në misione, operacione apo gjatë periudhave të studimit dhe kualifikimit? A duhet të përfitohet më shumë nga kontributi i sigurimit shëndetësor të ushtarakëve? Përgjigjja është po dhe për këtë duhet punuar sa më shumë.

Reforma ushtarake është një proces i vazhdueshëm që ndikon në fuqizimin dhe modernizimin e Forcave tona të Armatosura. Vjelja e mendimeve të ushtarakëve më me përvojë, harmonizimi sa dhe si duhet i përvojës me prurjet e reja është një nga elementët që ndikon në kryerjen e reformave sa më të suksesshme dhe afatgjata në fushën ushtarake. Krahas kësaj reforma është shoqëruar dhe shoqërohet me reduktim të personelit të FA, daljet në pension të parakohshëm dhe përballja me sfidat e ekonomisë së tregut. Nga ana tjetër janë bërë përpjekje për përgatitjen e programeve për ritrajnimin dhe riintegrimin e ish-ushtarakëve në jetën civile, duke pasur mundësi të thithjes së financimeve të huaja edhe në këtë drejtim. A është bërë kjo sa duhet duke e krahasuar këtë me vendet e tjera të rajonit që kalojnë procese të ngjashme? Sa dhe si janë arritur rezultatet në këtë drejtim gjithmonë ka vend për të diskutuar. Këto diskutime vijnë nga takimet spontane

të ushtarakëve, duke mos pasur mundësi që të diskutohen në një grupim apo shoqatë për të cilën po flasim sot, dhe që ndoshta do të rekomandonte zgjidhje më të konsoliduara për vendimmarrësit tanë. Nga përvoja e vendeve aleate ne shohim që procesi i shkëputjes graduale nga FA dhe puna për integrimin e tyre në jetën civile fillon që në kohën që ata janë pjesë aktive e këtyre forcave. Në rastin më të mirë “integrimi” fillon që me pasjen e një diplome të dytë civile, e cila ka filluar tashmë në Universitetin tonë Ushtarak “Skënderbej” apo me dhënien e mundësive për kualifikime në shkolla dhe universitete civile brenda dhe jashtë vendit, apo me dhënien e gradave akademike shkencore, të cilat do të mund të përdoreshin me sukses në tregun e punës pas shkëputjes së tyre nga radhët e FA. Gjithashtu një programim i mirë fillon në periudhën e fundit të karrierës ushtarake, duke pasur seanca konsultimi, marrëdhënie me dikasterin e punës dhe çështjeve sociale, testimin e tregut etj., për të identifikuar rrugët e përshtatshme sipas profesionit dhe ekspertizës së gjithësecilit për vazhdimin e jetës duke minimizuar problemet sociale. Sa dhe si bëhet kjo te ne dhe a ka vend për përmirësim kjo mund të jetë një nga çështjet që mund të diskutohet për të ofruar zgjidhje sa më optimale dhe rezultative.

Vitin që vjen Forcat tona të Armatosura synojnë të bëhen plotësisht profesioniste duke i dhënë fund sistemit që bazohet në shërbimin e detyrueshëm ushtarak. Në këto kushte profesioni i ushtarakut do të bëhet gjithnjë e më tepër një fuqi “e rregullt” në tregun e punës, i cili do të zgjidhet nga ajo pjesë e të rinjve që do jenë të interesuar të ndjekin një karrierë ushtarake. Në këto kushte çështja e mbrojtjes të interesave të tyre profesionale bëhet gjithnjë e më tepër e rëndësishme.

Thuhet se **familja** është qeliza bazë e një shoqërie dhe sa më e shëndoshë të jetë ajo aq më e shëndoshë edhe vetë shoqëria. Në kushtet e ushtarakut kjo gjë merr një sens të veçantë për vetë natyrën e punës së tij, sidomos me rritjen e pjesëmarrjes në operacione dhe misione jashtë vendit. Pjesa më e madhe e aleatëve tanë i kushtojnë një vëmendje të veçantë përkujdesjes dhe gatishmërisë familjare, e cila shpeshherë konsiderohet si pjesë integrale e gatishmërisë së

ushtarakut për misionin. Sigurimi i një programi të konsoliduar për familjen e ushtarakëve, kujdesi për fëmijët dhe bashkëshortin, organizimi i një pune më të studiuar dhe më kualitative mbeten disa nga kërkesat për të ardhmen edhe për përfaqësuesit e shoqatave të ushtarakëve.

Mbështetja familjare ka nevojë për programe të koordinuara si dhe një sistem të nevojshëm të shpërndarjes së informacionit për të krijuar një bazë të fortë të parapërgatitjes së tyre për sfidat aktuale dhe ato që mund të vijnë. Kjo mbështetje është e lidhur me organizimin e takimeve, bisedave, kualifikimeve të ndryshme si dhe dhënien e shërbimeve më të domosdoshme. Ndër to mund të rendisim: kujdesin e duhur për fëmijët, akseset dhe lehtësira për konsultime e trajtime lidhur me stresin, gjendjen mendore, kujdesit shëndetësor, asistencë punësimi për bashkëshortët, si dhe programe për të rinjtë e këtyre familjeve. Synimi kryesor duhet të jetë që të mos mbetet asnjë familje ushtarake pa u marrë në konsideratë dhe pa mbështetjen e duhur, pavarësisht nga vendndodhja dhe statusi i tyre social.

Aspektet kulturore dhe morale

Në shoqëritë demokratike përfundimtare njeriu konsiderohet si një **kapital shumë i çmuar** ku përditë e më tepër luftohet për të drejtat dhe liritë themelore të tij, duke e ngritur në nivelin më të lartë mbrojtjen e tyre. Vlera njerëzore konsiderohet si një vlerë e shtuar në realizimin e detyrave dhe misionit të ngarkuar. Sa më shumë përkujdesje të ketë ndaj tij dhe familjes së tij, sa më mirë të plotësohen kërkesat e jetës ekonomike e sociale etj., aq më mirë do të kryhet misioni dhe detyra. Njeriu dhe detyra janë të lidhur ngushtë me njëri-tjetrin dhe aftësia e komandantëve mbetet në harmonizimin sa më mirë të tyre, duke i lidhur me njëri-tjetrin sa më mirë, duke mos mbivlerësuar njërin në kurriz të tjetrit, por duke i parë ato në harmoni me njëri-tjetrin dhe duke shtuar vlerat njëri-tjetrit.

Për më tepër ushtaraku përbën një pjesë të rëndësishme të **moralit të kombit**. Kjo karakteristikë merr përmasa gjithnjë

në rritje sidomos me futjen e vendit tonë në NATO dhe me ballafaqimin e **kulturës sonë** me kulturat e vendeve të tjera, me të cilët do të na duhet të punojmë dhe veprojmë në ditët që vijnë. Pjesëmarrja e ushtarakëve tanë në operacionet dhe misionet jashtë vendit bëjnë që ata të ndodhen në një mjedis tjetër, i krahasuar ndonjëherë si në *“një ishull në mes të oqeanit”*. Duke marrë pjesë në këto operacione dhe misione ushtarakët tanë janë quajtur dhe quhen si *“Ambasadorë të Pages”* pasi përcjellin atje vlerat dhe mesazhet e shoqërisë sonë, vlerat më të mira të saj, të cilat ndikojnë në forcimin e marrëdhënieve midis popujve dhe vendeve dhe që ndikojnë ndjeshëm në rritjen e një klime mirëbesimi dhe besimi reciprok. Në këto kushte ushtaraku ka nevojë për më shumë *“ura lidhëse”* dhe mekanizma përfaqësimi e mbrojtje të shtetit që e dërgon.

Në njëfarë mënyre ushtarakët ndikojnë në prezantimin dhe përmirësimin e imazhit të shoqërisë sonë jashtë vendit. Imazhi është një faktor shumë i rëndësishëm për krijimin e marrëdhënieve të shëndosha midis individëve, shoqërive dhe vendeve të tjera. Sa dhe si është praktika jonë gjatë kësaj periudhe tranzicioni? Sa në vështirësi jemi ndier ne dhe çfarë masash kemi marrë për t’u ndier dinjitozë përballë të tjerëve? Rastet e shumta tregojnë që, për të mos u ndier inferiorë para të tjerëve, të shpenzojmë diçka nga vetja për të qenë të qenë të barabartë dhe dinjitozë. Cilat kanë qenë dhe janë sfidat tona për të ardhmen? A ka vend për t’u përmirësuar? A përbën kjo një fushë për t’u diskutuar midis ushtarakëve dhe për të kërkuar zgjidhje brenda ligjeve në fuqi? Përgjigjja përsëri është po, duke gjetur ato zgjidhje që të tjerët i kanë gjetur para nesh, dhe për të mos “shpikur” rrugë të reja të pashkelura më parë.

Kultura kombëtare dhe ushtarake është një pasuri, e cila ndikon fuqishëm në prezantimin e vlerave tona, të krenarisë sonë ushtarake dhe kombëtare. Vijnë nga një popull me tradita të lashta, me një histori të pasur, si një prej kombeve më të vjetra në rajonin tonë e më gjerë. Kultura unike e popullit tonë, harmonia fetare, gjuha dhe karakteristika dhe veti të tjera kombëtare janë disa elemente që kurrë nuk duhen harruar dhe injoruar. Puna në këtë drejtim nuk duhet të ndihet e shteruar. Kërkohen më shumë programe pune, evidentimi dhe

prezantimi i përvojave më të mira, ballafaqimi me kulturat e tjera, duke prezantuar rastin tonë unik, si një popull që kemi ditur t'i mbijetojmë sfidave të kohëve të ndryshme.

Si konkluzion mund të themi se liria për t'u organizuar në shoqata ushtarake është një e drejtë kushtetuese dhe që ndihmon konsolidimin e vlerave demokratike edhe në radhët e Forcave të Armatosura. Duke respektuar dhe mbrojtur sa më shumë të drejtat dhe liritë themelore të ushtarakëve aq më shumë ndikojmë në rritjen e dinjitetit dhe përmbushjen e misionit kushtetues të Forcave të Armatosura.

*N/Kolonel Editson ZARKA,
Student në Akademinë e Mbrojtjes, Tiranë*

SELLY MCNAMARA

NATO: NJË ANALIZË PAS SAMITIT

Presidenti Obama celebroi ditëlindjen e 60-të të NATO-s fundjavën e kaluar në Strasburg dhe Këln, duke mbledhur kryetarët e qeverive të 27 kombeve të tjera ndërsa aleanca Trans-Oqeanike e sigurisë shënonte përvjetorin jubilar të diamantë. Kroacia dhe Shqipëria iu bashkuan zyrtarisht aleancës, Franca u riintegrua në strukturat e komandës ushtarake të saj, Anders Fogh Rasmussen u emërua si Sekretar i Përgjithshëm dhe liderët e NATO-s ranë dakord për fillimin e punimeve për Konceptin e ri Strategjik. Sidoqoftë, mbeten disa çështje delikate duke përfshirë zgjerimin drejt Lindjes, burimet e mjaftueshme të misionit në Afganistan, marrëdhëniet NATO-Rusi dhe mbrojtja ndaj raketave. Këtu, ekspertët e politikave të jashtme diskutojnë impaktin dhe rezultatet e Samitit të NATO-s.

Kroacia dhe NATO (Marijan Gubic Zv. Shef i Misionit, Ambasada e Kroacisë, Uashington D. C.)

Anëtarësia e Kroacisë në NATO përfaqëson përfundimin e një prej dy objektivave strategjike të vendit që prej pavarësisë së tij. Perspektiva e anëtarësimit në NATO dhe në Bashkimin Europian formojnë një pjesë të plotë të aspiratave Euro-Atlantike të Kroacisë, e cila është themeli kryesor për një Europë, e cila është e plotë, e lirë dhe në paqe. Kjo aspiratë konfirmon gjithashtu dëshirën e Kroacisë për t'u bërë pjesë e një komuniteti sigurie pluralist, i cili lidh në mënyrë strategjike demokracitë, të cilat njohin identitetet e tyre individuale dhe cilësitë e veçanta si komb, por gjithashtu që ndajnë një sistem

unik të përbashkët vlerash, i cili promovon cilësitë dhe përfitimet e një ekonomie tregu përmes institucioneve të forta të mbrojtjes dhe sigurisë. NATO gjithashtu përfaqëson një pikë kthimi historik për Kroacinë ndërsa ajo kthehet në familjen e kombeve europiane. Ajo gjithashtu kyç Kroacinë në një trekëndësh strategjik të Zagrebit, Brukselit dhe Uashington D. C. si struktura unike, e cila zgjeron premtimin për paqe dhe siguri në një kontinent europian më të gjerë dhe përtej.

NATO nuk është thjesht aleanca e mbrojtjes më e mirë në histori, ajo është përbërësi jetësor për sigurinë globale dhe unikaliteti i saj buron nga fleksibiliteti për t'u pajtuar me sfidat komplekse të sigurisë me të cilat përballemi ne si kombe. NATO vazhdon të jetë faktori i vetëm më i rëndësishëm për stabilitetin global. Kroacia e njohu rëndësinë e anëtarësisë në NATO shumë herët dhe ka kualifikime speciale për të zgjeruar benefitet e NATO-s deri në përfundimin e saj në Europën Juglindore. Këtë fundjavë, Kroacia është bërë zyrtarisht një aleatë për vendet më të suksesshme dhe të avancuara në botë dhe ka transformuar vetveten nga një konsumator sigurie në një furnitor të saj.

Anëtarësia e Kroacisë në NATO ishte pika kulmore e një lidhshpi të kujdesshëm në Kroaci, i cili e transformoi Kroacinë në një aleat të sigurt dhe të aftë të komunitetit transatlantik, mençuria e qytetarëve kroatë dhe angazhimi i palëkundur i veteranëve kroatë të çështjes së lirisë dhe të punës këmbëngulëse, dhe dialogut midis Kroacisë dhe njëzet e gjashtë kombeve të NATO-s dhe partnerëve të saj. Anëtarësia e Kroacisë do të kontribuojë në përtëritjen e aleancës, një tipar i veçantë i NATO-s, i cili ka qenë një burim konstant i forcës së saj. Mirënjohje të veçantë i duhet bërë e njohur aleatëve dhe në veçanti Shteteve të Bashkuara dhe administratave pasuese që prej fundit të Luftës së Ftohtë në drejtimin e aleancës drejt suksesit strategjik. Sfidat që shtrihen në të ardhmen do të vazhdojnë të përcaktojnë aleancën dhe sfida ekzistuese është të zgjerohet perspektiva Euro-Atlantike për ato shtete, të cilat kërkojnë t'i kontribuojnë vlerave dhe sigurisë të aleancës dhe të zgjerojnë benefitet e jetës në liri.

Samiti i NATO-s: Jo mbresëlënës, por ka akoma arsye për optimizëm (Dr. Liam Fox MP, Nënsekretar i Shtetit për Mbrojtjen, Britania e Madhe)

Përgjithësisht, ndërsa Samiti i fundit i NATO-s në Strasburg dhe Këln nuk ishte aq mbresëlënës sa shpresohej, kishte shumë arsye për të qenë optimistë. I uroj mirëseardhjen dy anëtarëve më të rinj – Kroacisë dhe Shqipërisë – në Aleancë. Anëtarësia e tyre tregon se çfarë mund të arrijnë reformat dhe puna intensive, por ato duhet gjithashtu të kuptojnë se me anëtarësi vjen përgjegjësia. Anëtarësia e Kroacisë dhe Shqipërisë duhet t'i dërgojë pjesës tjetër të rajonit mesazhin se shtëpia nënë e Ballkanit është brenda familjes europiane dhe pjesë e NATO-s.

Në mënyrë që NATO të punojë plotësisht si një aleancë sigurie në botën e pas Luftës së Ftohtë, anëtarët e NATO-s duhet të kenë vullnetin e mirë për të marrë risqe të barabarta në lidhje me furnizimin me trupa dhe pajisje brenda aleancës dhe vullnetin e mirë për të sponsorizuar financiarisht dhe të mbështesin këto operacione derisa të thuhet “misioni u përfundua”.

Aktualisht ekzistojnë disa anëtarë të caktuar, të cilët po bëjnë një masë disproporcionale të luftimeve, fondacioneve dhe vdekjeve. Kjo është thjesht e pambështetshme në perspektivën afatgjatë. Suksesi i NATO-s varet nga mbështetja e anëtarëve të saj. Anëtarët e NATO-s duhet të kuptojnë se anëtarësia sjell përgjegjësi të caktuara dhe të pacaktuara për të siguruar se forcat e tyre ushtarake kanë aftësinë për të luftuar dhe fituar në fushëbetejën e ditëve të sotme moderne.

Në Samit u diskutua në mënyrë të konsideruar rreth kontributeve të mëtejshme me trupa për ISAF në Afganistan – sidomos për periudhën që do të vijë dhe gjatë zgjedhjeve të ardhshme në gusht. Koha do ta tregojë nëse këto kontribute, të cilat duken kaq mirë në letër, do të bëhen ndonjëherë aftësi reale në terren. Për më tepër, unë shpresoj se aleatët tanë europianë do të jenë të aftë të kontribuojnë më shumë trupa për jugun dhe lindjen e rrezikshme të vendit, por historitë e fundit na kanë mësuar të bëhemi skeptikë. Edhe pas këtij samiti unë mendoj se shumë njerëz akoma e pyesin veten: “Përse është NATO”?

E vërteta e papërshtatshme është se NATO-s i vajti mirë gjatë Luftës së Ftohtë: buxhete më të mëdha për mbrojtjen, ushtri më të mëdha dhe një mision i qartë me një fund të qartë shteti - të ndalojë Ushtrinë e Kuqe në Grykën e Fuldas dhe ta mundë atë në planet e saj të Europës Qendrore. Sot, aleanca e NATO-s duhet të bjerë ndesh me sfidat që do të përballet e me resurset që ka në dispozicion. Në një botë të globalizuar dhe të ndërvarur, NATO duhet të jetë e përgatitur për një spektër të plotë sfidash. Lajmërimi i një Koncepti të ri Strategjik është një hap shumë i rëndësishëm për të ndihmuar NATO-n të themelojë çfarë është misioni i saj në shekullin XXI dhe duhet të mirëpritet me mbështetjen e plotë të gjithë anëtarëve të NATO-s.

Më në fund, vendimi i Presidentit Sarkozy për t'u ribashkuar me Strukturat e Integruara të Komandës së NATO-s duhet të mirëpritet nga të dyja brigjet e Atlantikut. Franca mund të sjellë aftësi reale ushtarake për aleancën, por ky vendim nuk duhet të jetë në kurriz të mbrojtjes së integruar më të thellë të BE-së. Për 60 vitet e fundit NATO ka qenë guri i themelit për mbrojtjen tonë kolektive. Tani nuk është koha për t'i kthyer shpinën një aleance, e cila ka qenë kaq e mirë me ne.

Ku është butoni rus i rivënies? (Peter Huessy, Analiza Gjeostrategjike, President)

Ku është butoni rus i rivënies? Ndërsa janë bërë shumë ndryshime të ardhshme në politikat e Shteteve të Bashkuara pak është thënë rreth çfarë alternativash mund të presim nga Moska. Kongresmeni John McHugh shkruan: “Me gjithë zhurmën që është bërë rreth ndryshimeve dhe dëmtimeve të politikave ... të mëparshme, duket se ka vëmendje të pamjaftueshme për atë që thotë Rusia aktualisht. Kjo rrezikon të bjerë në grackën e dështimit të konsiderimit të Ruisë si është në favor të asaj çfarë ne do të donim të ishte. Si e tillë, nuk është shumë herët të mendojmë se është sjellja ruse ajo që ka nevojë për “riparë”. Kjo përfshin eliminimin e arsenalit masiv të armëve bërthamore të Ruisë. Dhe ndalimin e

eksportit të teknologjisë së armëve në vende si Irani dhe Venezuela, të cilat mund të jenë paracaktuar për Hezbollah dhe FARC në sulmet terroriste kundër Shteteve të Bashkuara, si dhe eliminimin e presionit ushtarak kundrejt anëtarëve të NATO-s.

Vëmendje të veçantë i duhet kushtuar luftës së resurseve kundër Perëndimit dhe shfrytëzimi i gazit natyror nga ana e saj për t'u bërë shantazh komshinjve të saj. Ajo kërkon të kontrollojë rrjedhën e naftës dhe gazit nga Azia Qendrore për të dyja, edhe Lindjen dhe Perëndimin. Moska ka gjithashtu kontrollin që po shtohet dita-ditës të burimeve kritike të mineraleve si paladium dhe gërmimet dhe përpunimet e platinës. Ne kemi atë që Daniel McGroarty dhe dr. Christina Lin, në dy publikime të ndryshme, përshkruajnë si “ekonomia si vazhdimi i luftës me masa të tjera” dhe “shfrytëzimi i sektorit rus të burimeve për të rishpallur edhe një herë statusin perandorak të Rusisë”, respektivisht.

Jackson Diehl i Washington Post paralajmëroi administrimin e “gatishmërisë për të përvetësuar prioritetet e ... [të tjerëve] ... duke minimizuar ose anuar totalisht shqetësimet parësore amerikane”. Nëse tkurrim influencën ndërkombëtare amerikane ose huazojmë nga Charles Krauthammer, që “nivelimi është esenca” e Uashingtonit të ri, mund të shfaqet një ushtri e re dhe e padëshiruar qiraxhinjsh që do të banojnë në strukturën e re strategjike që është në ndërtim e sipër. Steve Blanks nga Kolegji Ushtarak i Luftës paralajmëron se Moska është bërë qendra e një sipërmarrjeje më reflektuese si krim i organizuar sesa një shtet-komb. Sa i besueshëm mund të jetë një shtet i tillë si partner?

Ndërkohë që Uashingtoni ka të drejtë kur thotë se hedhja Koreanoveriore ishte “një tentativë provokuese për të përmirësuar aftësinë e raketave balistike me distancë të madhe të regjimit mashtrues”, në të njëjtën kohë si pjesë e një rishikimi politikash, diplomatët diskutojnë nëse Shtetet e Bashkuara përfundimisht do të duhet të pranojnë këmbënguljen e Iranit në zbatimin e pasurimit me uranium. Bombat iraniene dhe raketat koreanoveriore nuk mund të ndahen, sido që të jetë, dhe ky është vetëm një shembull i

zymtë i dilemës me të cilën përballet Amerika sot. Ndërsa është mjaft e rëndësishme të mbahen sytë e veshët hapur si paralajmëron Jim Hoagland: “Dëgjimi nuk është politikë”.

Forcimi i Komandës në Afganistan (Michael O’ Hanlon, Partner Ekspert, Politikat e Jashtme, Instituti Brookings)

Strategjia e re e administratës Obama për Afganistanin dhe Pakistanin, lançuar më 27 mars para udhëtimit të Presidentit dhe Sekretarit të Shtetit në Europë, është përgjithësisht një strukturë e shëndoshë. Ajo thekson plotësisht qëllimet e dyfishta për mbrojtjen e popullsisë afgane nga njëra anë, dhe nga ana tjetër ngritjen e institucioneve afgane në mënyrë që ata vetë të mundën të mbrojnë dhe të asistojnë gjithnjë e më shumë popullsinë e tyre.

Për të qenë të sigurt, ka dobësira në planin e tyre ekzistues edhe pse ai përfaqëson një hap të madh drejt një strukture akoma më të mirë se ajo që ngriti administrata Bush gjatë punës shtatëvjeçare. Për shembull, ndoshta nuk po mobilizojmë mjaftueshëm trupa. Edhe pse akuzat e fundit të senatorit McCain se plani i ri përfaqëson “gradualizim” ushtarak janë mjaft kundërshtuese, komandantët sipas raporteve të pakonfirmuara duan 10000 trupa amerikane më shumë se ç’ka aprovuar presidenti (duke marrë totalin e trupave nga aktualët prej 38000 në afërsi të 80000, nëse janë të gjitha të aprovuara). Ç’është më e rëndësishme, qëllimet tona për forcat e sigurisë afgane mbeten akoma më modeste, planifikimi aktual rreth 215000 veta personel është afërsisht gjysma e asaj çfarë doktrina e kundërzbulimit do të këshillonte (duke pasur parasysh faktin se një popull prej 30 milionë banorësh duhet të ketë të paktën gjysmë milioni paqeruajtës dhe/ose policë).

Por në këto ditë të para të prillit, dalin dy probleme të tjera me strategjinë sepse ata kanë një lidhje të veçantë me NATO-n. Teorikisht ata do të ishin rregulluar para samitit, por ka akoma kohë për të riparuar të metat në javët në vazhdim. Të dy kanë të bëjnë me masat e komandës. Në Irak, ndërsa

Gjenerali David Petraeus me të drejtë merr lëvdata për suksesin e operacionit, Gjenerali Ray Odierno dhe Ambasadori Ryan Cocker ishin elementë të asaj skuadre me tre burra (sigurisht, Odierno mbetet tashmë si pasardhësi i Petraeusit). Të tre ata përfaqësonin forcat dhe aftësitë jo vetëm të Amerikës, por të gjithë koalicionit ndërkombëtar. Odierno i komandonte trupat çdo ditë, Petraeus mbikëqyrte zhvillimin dhe implementimin e strategjisë me bazë operacionale po aq mirë sa koordinimi i tij i ngushtë me partnerët Iraken, Crocket manovronte politikën dhe ekonominë.

Në Afganistan, aftësitë konkurruese mungojnë gjerësisht. Karl Eikenberry ka gjasa që të jetë nisur në Kabul si ambasador, dhe ai është mjaft i kualifikuar për detyrën, por elementët politikë dhe ekonomikë të punës janë shumë më të shumanshëm dhe si rrjedhojë shumë më komplekse se ato në Irak. Si pasojë, ambasadori i Shteteve të Bashkuara nuk mund të veprojë me kokën e tij si bënte Crocker në Irak. Le të marrim një shembull kyç, nga ndihmat prej 15 miliardë USD dërguar në Afganistan deri tani, vetëm 5 miliardë ose një e treta kanë ardhur nga Shtetet e Bashkuara, ndërsa 90 për qind e ndihmave të huaja dërguar në Irak kishin origjinë amerikane. Për më tepër, nuk ka komandant operacional për të ndihmuar Gjeneralin David McKiernan, i cili komandon të gjitha forcat e huaja në Afganistan. Staf i tij është më i vogël se ai i Petraeusit në Irak (ose më i vogël se ai i Odiernorit tani), ende ai nuk ka ndihmë për të menaxhuar çështjet e përditshme. Më saktë, poshtë McKiernanit janë pesë komanda rajonale të drejtuara nga vende të ndryshme të NATO-s, secila me komanda nënrajonale, të cilat drejtohen nga më shumë shtete për të koordinuar dhe manaxhuar.

Edhe nëse shumica e kundërzbulimit është vendore, ka anë negative për një strukturë të tillë komande ushtarake të copëtuar. Praktikën më të mira janë më të vështira për t'u ndarë ashtu si janë të dhënat e një inteligjence të mirë. Aftësia për të mbledhur shpejt përforcime nga njëri sektor te tjetri sipas nevojës ngadalësohet shpesh, jo vetëm nga "protokollet" kombëtare të vajtueshme në mënyrën se si mund të angazhohen trupat, të cilët mjerisht janë fakte deri në një nivel,

por gjithashtu nga vrapimet e thjeshta me pengesa burokratike dhe zinxhirët të komandës që pasohen nga Europa para se të bashkohen në shtabet e ISAF-it në Kabul.

Aq keq sa janë problemet nga ana ushtarake, ata mund të jenë më keq në frontin ekonomik. Kjo është një fushë vendimtare e përpjekjeve ndërsa ne kërkojmë të ndihmojmë fermerët afganë për të zhvilluar alternativa për opiumin, trajnime për sistemin gjyqësor dhe të pozicionojnë gjyqtarët kompetentë dhe që shkollat e qendrat e shëndetit të arrijnë në gjysmën tjetër të popullsisë që nuk i shërbehet akoma. Me vendin e shkatërruar në një luftë prej tre dekadash, shumica e Ministrive Afgane nuk kanë më shumë se disa profesioniste kompetentë për të bërë punën. Ndërmjet sfidave të tjera, ata duhet të tregtojnë me rreth 40 donatorë, përpjekjet e të cilëve janë të pakoordinuara dhe shpesh bien në një konfuzion përpjekjesh individualisht të vlefshme, por të palidhura. Imagjiloni këtë: nëse secili nga ministrat kompetentë merr thjesht një udhëzim në muaj nga secili donator, dhe të harxhojë kohë duke bluar ato që ka mësuar, ata lehtësisht do të konsumonin gjysmën e kohës së çmuar duke ndjekur prezantime në Powerpoint (dy udhëzime në ditë, çdo ditë plus koha për t'u përgatitur dhe përpunuar).

I detyrohem i miqve tanë afganë më shumë ndihmë. Ne duhet t'i sugjerojmë qeverisë afgane dhe aleatëve të mëdhenj se duhet të krijojnë strukturën e komandës mbikëqyrëse me tre persona për punën e koalicionit në Afganistan. Gjenerali McKiernan mund të mbajë postin e tij, por t'i transferojë disa nga përgjegjësitë e përditshme një komande të re operacionale me tre yje për të koordinuar të gjitha aktivitetet ushtarake të huaja gjatë gjithë vendit. Për më tepër, duhet emëruar një koordinator ndihmash ndërkombëtare, përgjegjës për të gjithë donatorët e mëdhenj dhe duke përfaqësuar një pikë të vetme kontakti madhor për qeverinë afgane, diçka si modeli "Paddy Ashdown" nga Bosnja në vitet 1990. Koordinatori aktual i Shteteve të Bashkuara nuk ka as kontrollin më të vogël mbi fondet për të bërë rolin e tij.

Ka një mënyrë shumë natyrale për të ndarë detyrat dhe përgjegjësitë e kësaj strukture të re komande. Me dy të tretat e

të gjitha forcave të huaja në Afganistan që shumë shpejt do të bëhen amerikane, jo vetëm komandanti i ISAF-it por edhe zëvendësuesi i tij i operacioneve të përditshme duhet të jetë një oficer i Shteteve të Bashkuara. Por me dy të tretat e të gjithë asistencës ekonomike për zhvillim që vijnë nga vende që nuk kanë origjinë të Shteteve të Bashkuara, koordinatori i ndihmave dhe zhvillimit duhet të jetë europian (ose japonez, ose kanadez, duke marrë parasysh vendet që furnizojnë resurset më të mëdha tani). Po ta mendosh mirë, ai koordinator mund të jetë nga një vend me shumicë myslimane (vërtet, një turk mund të konsiderohet urgjentisht si më i miri). Kjo qasje mund të mbajë ndjenjën e partnershipit ndërkombëtar të misionit afgan ndërsa mund të mbajë punën e lidhshimit në duart e atyre që japin kontributet më të mëdha. Kjo do të ishte gjithashtu një mënyrë e mirë për Presidentin Obama që të tregojë se si do të trashëgohet stili i ri amerikan i diplomacisë amerikane duke njohur rolin e aleatëve dhe partnerëve dhe gjithashtu në të njëjtën kohë duke mbajtur një ndjenjë të fortë dhe gjatë të lidhshimit të Shteteve të Bashkuara.

Ditëlindja e 60-të e NATO-s (Geoffrey Van Orden MEP, Anëtar i Konservativ Britanik i Parlamentit Europian dhe Zëdhënës për Mbrojtjen)

Përvjetori i Diamantë i NATO-s ishte më shumë simbolizëm sesa substancë, por edhe simbolizmi ishte mbrapsht. Kur Presidenti Obama u përshëndet nga Presidenti francez në Strasburg, ishte flamuri i BE-së më shumë se ai i NATO-s që valëvitej afër atij amerikan dhe francez. Ndërsa Presidenti Sarkozy priste liderët e NATO-s që shëtisnin poshtë e lartë urës Rhine nga Gjermania, dukej sikur NATO po i kthehej Francës me shumë sesa Franca e penduar ribashkimit të familjes.

Për fat të keq nuk u desh të prisnim shume gjatë hapjes së Samitit për të parë shfaqjen e pozicionit të veçantë të Francës. Ndërkohë që Afganistani sërisht u identifikua si “prioriteti kyç” i Aleancës, refuzimi i Presidentit Sarkozy për të kontribuar më

shumë trupa hodhi një velenxë zhgënjyese mbi takimin. Bashkë me shkurtime e forcave të armatosura franceze të mirë publikuara ajo na thotë se gjithçka duhet të dimë rreth motivit të saj të riintegritimit në strukturën ushtarake të NATO-s, të fitojë miratimin e projektit të ndarë të mbrojtjes së BE-së dhe të ketë mundësinë në reformimin e Aleancës në mënyrë që t'i përshtatet ambicieve franceze. Nëse, si ka gjasa të ndodhë, pjesë e marrëveshjes me Francën është t'i japë asaj një nga dy postet më të larta në Transformimin e Komandës së Aleatëve të NATO-s, atëherë ajo do të ketë rol kyç në planifikimin e konceptit të ri strategjik që u shpall në Samit.

Komunikata e fundit përsërit fjalë për fjalë këmbënguljen e Samitit të mëparshëm të Bukureshtit mbi natyrën “plotësuese” të politikës së mbrojtjes së BE-së. Por kjo është fjala e gabuar, “mbivendosëse” ose “konkurruese” do të ishte më e gjetur. Në fund të fundit, NATO dhe BE ndajnë të njëjtën anëtarësi. 21 nga 27 anëtarë të BE-së janë anëtarë të plotë të NATO-s dhe pesë nga gjashtë që mbeten janë vende neutrale. Me të vërtetë po themi se kostot, duplikimi, ndarja dhe shushatja të trashëguara nga struktura të ndara të BE-së janë të justifikuara nga përfshirja potenciale e forcave ushtarake në Qipro? Nëse, si dihet, sfidat e sigurisë janë të zakonshme, përse ekziston nevoja për struktura të ndara që bëjnë kërkesa konkurruese në të njëjtin grup të kufizuar të resurseve ushtarake? Për shembull, marrim përpjekjet detare antipirate, të cilat tani drejtohen në mënyrë nxitëse nga NATO dhe BE. Komunikata e Samitit do ta transmetonte si “plotësuese”, e vërteta është se të dy organizatat tërhoqën ekzaktësisht të njëjtin numër të fregatave dhe gjuajtësve nga ekzaktësisht të njëjtat vende. Gjithë ajo që sjell përfshirja e BE-së është ndarja e kontributeve kombëtare dhe çoroditja e komandave operacionale.

Një shembull i dytë është trajnimi i policëve afganë. Kjo është një nga detyrat e Misionit Trajnues të NATO-s që u hodh në Samit. Ai do të operojë nën të njëjtën komandë si misioni i Shteteve të Bashkuara që trajnoi me sukses një të tretën e policëve afganë në 2008-n. Por nuk është arritur një marrëveshje e ngjashme me BE-në, e cila formalisht këmbëngul në mbajtjen e një operacioni autonom. Me një

kosto vjetore prej rreth 90 milion USD dhe tani në vitin e dytë të tij, EUROPOL nuk ka trajnuar asnjë polic të thjeshtë afgan. Është një mikrokozmos i duplikimit, ndarjes, çoroditjes dhe mungesës së rezultateve të prekshme që karakterizojnë ESDP-në si një të tërë.

Aleanca deklaron se ajo ka për qëllim të forcojë bashkëpunimin me aktorë të tjerë ndërkombëtarë, duke përfshirë BE-në, për të përcjellë një qasje të kuptueshme duke kombinuar aftësitë civile dhe ushtarake më efektivisht. Nëse kemi këtë rast, BE do të fokusohej në projektet civile të rindërtimit dhe zhvillimit, ku mund të shtonte me të vërtetë disa vlera.

Ne duhet të jemi dyfish syhapur që ambiciet e Francës për BE-në të mos dëmtojnë themelet e arkitekturës të organizatës së re të sigurisë të demokracive. Obamat duket se shpërndajnë pluhur zanash kudo që shkojnë, dhe afekcioni për ta në Europë është i pamohueshëm, por kur ai kthehet në shtëpi, Presidenti i Shteteve të Bashkuara do të kuptojë se ka sjellë me vete pak më shumë se disa suvenire të pavlera nga udhëtimi i tij jashtë shtetit. NATO nuk është rigjeneruar. Demokracitë nuk janë të mirëpërgatitura për t'u përballur me rreziqet e mëdha që u kanosen vetë atyre.

JAN PETERSEN

KONCEPTI I RI STRATEGJIK I NATO-s: NJË VIZION PARLAMENTAR

Mjedisi strategjik, si dhe vetë NATO kanë ndryshuar shumë që nga Koncepti Strategjik aktual, i cili u aprovua 10 vjet më parë. Jan Petersen beson se lidhjet e NATO-s me zhvillimin, elementët e saj jo ushtarakë dhe fushat që mbulon, të gjitha duhen sqaruar. Në 1999, terrorizmi vështirë të shihej si një kërcënim, NATO akoma nuk kishte konceptuar ndonjë mision jashtë kufijve aq ambicioz sa Afganistani, dhe procesi ynë i zgjerimit ishte në fillimet e tij. Por prej 2001, Aleanca i bëri thirrje Nenit 5 për herë të parë, si përgjigje ndaj sulmeve terroriste të 11 Shtatorit. Në 2003, NATO kishte zbarkuar me misionin e saj të jashtë kufijve në Afganistan. NATO ka vazhduar me pranimin e dhjetë anëtarëve të rinj, ka krijuar struktura të reja, bashkëpunime dhe ka marrë iniciativa si Këshilli NATO-Rusi. NATO mban një “derë të hapur” për anëtarë dhe bashkëpunëtorë të rinj dhe marrëdhëniet me komshinjtë dhe organizatat e tjera ndërkombëtare vazhdojnë të evoluojnë.

NATO është një aleancë demokracish dhe parlamentet e vendeve anëtare janë primare në mjetet e komunikimit midis qytetarëve të vendeve anëtare të NATO-s dhe lidhshpimit të saj. Janë parlamentarët ata, të cilët shpesh duhet t’i shpjegojnë zgjedhësve të tyre përse kushtimi i pak burimeve për siguri dhe rrezikimi i jetës së ushtarëve në operacione të largëta është kaq e rëndësishme. Për këto arsye, unë mendoj se Koncepti i ri Strategjik duhet të adresojë disa nga shqetësimet e parlamentarëve të vendeve të NATO-s. Asambleja Parlamentare e NATO-s është duke përgatitur komentarin e saj mbi Konceptin e ri Strategjik dhe unë kam nderin të shërbej si Reporter i Veçantë për këtë projekt. Koncepti i ri Strategjik do

të jetë një dokument themelor, i cili do të drejtojë Aleancën. Në të njëjtën kohë, sidoqoftë, ai duhet të jetë i lexueshëm dhe të shprehë vlerat e Aleancës dhe rreziqet e parashtruara në gjuhë të thjeshtë. Ai gjithashtu duhet të pasqyrojë konceptet, të cilat do ta bëjnë Aleancën një organizatë më të aftë për t'u përballur më sfidat që do të shfaqen. Komentet e mia këtu jo domosdoshmërisht reflektojnë pikëpamjet e të gjithë anëtarëve të Asamblesë, unë mendoj se disa, për të mos thënë shumica, e kolegëve të mi do t'i ndajnë me mua. Ne nuk mund t'i kërkojmë qytetarëve tonë të mbështesin misionet e Aleancës pa qenë më parë të qartë rreth qëllimit të Aleancës. Ne i detyrohemi publikut të gjerë dhe veçanërisht ushtrive kombëtare qartësi rreth sfidave me të cilat do të përballemi dhe si ne planifikojmë të zvogëlojmë rreziqet që ato shfaqin.

Çdo kërkim në literaturën e marrëdhënieve strategjike do të tregojë se ka një grup të madh çështjesh, të cilat hyjnë në rubrikën e sigurisë. Shqetësimet ambientale, terrorizmi, riprodhimi, siguria e informacionit, siguria energjetike dhe të tjera, të gjitha janë të cituara. Koncepti i ri Strategjik duhet të konfirmojë lidhjen e ngushtë midis sigurisë dhe zhvillimit dhe të hartojë pasojat e domosdoshme për planifikimin dhe shpërndarjen e forcave të armatosura të Aleancës. Ekziston dhe një konsensus solid, se sfidat strategjike që ne përballemi nuk hyjnë në zgjidhje të pastra ushtarake. Këtë e shohim në Afganistan, ku pikëpamjet ushtarake janë të domosdoshme, por përbërës të pamjaftueshëm të një zgjidhjeje të plotë.

Koncepti i ri Strategjik duhet të konfirmojë lidhjen e ngushtë midis sigurisë dhe zhvillimit dhe të hartojë pasojat e domosdoshme për planifikimin dhe shpërndarjen e forcave të armatosura të Aleancës. Kjo lidhje thërret për bashkëpunimin më të ngushtë të mundshëm midis autoriteteve politike dhe ushtarake për planifikimin dhe ekzekutimin e misioneve përtej oqeanit. Kjo gjithashtu do të thotë të inkurajohen kontakte më të ngushta dhe përfshirje me organizatat joqeveritare.

Ende, në fund të fundit, NATO është një aleancë politike dhe ushtarake, dhe ne duhet të vlerësojmë me kujdes se cili do të jetë roli i NATO-s në adresimin e sfidave specifike. Terrorizmi ndërkombëtar, për shembull, është një shqetësim

i madh për sigurinë, veçanërisht potenciali i kombinimit të organizatave ekstremiste dhe të armëve të shkatërrimit masiv. Sidoqoftë, nuk është e qartë nëse NATO është organizata e përshtatshme për të adresuar këtë rrezik. Por si një aleancë e përbërë nga demokracitë, ne duhet të jemi të gatshëm të deklarojmë hapur se ne do të mbrojmë qytetarët tanë prej atyre që kundërshtojnë në mënyrë të dhunshme principet dhe vlerat e shoqërive tona. Gjithashtu, ne duhet të përdorim NATO-n si një forum për shkëmbim informacioni dhe koordinim përgjigjesh në rastet e një sulmi.

Është e lehtë të listosh të gjitha sfidat që mund të përplasen në sigurinë tonë të përbashkët. Sidoqoftë, nuk është e lehtë të përcaktohen fushat kyçe ku NATO duhet të luajë një rol domethënës. Por kjo është diçka që duhet ta bëjë Koncepti i ri Strategjik. Nëse ne përcaktojmë çdo gjë si një sfidë të sigurisë, të cilën NATO duhet ta adresojë, ne rrezikojmë të shpërndajmë të gjitha resurset e Aleancës shumë hollësisht përmes një variacioni të gjerë çështjesh. Sfidat e sigurisë potencialisht janë të pafund, kurse resurset janë të përcaktuara.

Një fushë në të cilën nuk duhet të ketë kundërshtime është zhvillimi i aftësive ushtarake për misionet me të cilat përballemi si një aleancë. Të gjithë parlamentarët janë të njohur me limitet e resurseve, kështu që, duke fokusuar NATO-n në atë që di të bëjë më mirë, planifikimin, trajnimin dhe drejtimin e operacioneve ushtarake si dhe zbatimin e misioneve reaguese ndaj emergjencave humanitare dhe civile, do të jetë një detyrë e rëndësishme e Konceptit të ri Strategjik.

Një fushë në të cilën nuk duhet të ketë kundërshtime është zhvillimi i aftësive ushtarake për misionet me të cilat përballemi si një aleancë. Disa analistë e kanë paraqitur këtë si një shkëmbim që ndodh si kompromis midis mbrojtjes territoriale dhe kapaciteteve ekspeditëse. Ende nuk është domosdoshmërisht e vërtetë se të jesh i përgatitur të frenosh forcën ushtarake në Europë dhe të jesh i përgatitur të manaxhosh sfidat e sigurisë në vendndodhje të largët, janë misione drejtpërdrejt konkurruese ndërmjet tyre. Këshilli Atlantikoverior dhe Komiteti Ushtarak janë struktura të ndara, por një shkrirje mund të formojë një trajektore domethënëse në procesin e vendimmarrjes.

Pavarësisht nëse forcat tona pozicionohen 100 ose 5000 kilometra nga baza mëmë, ato përsëri kanë nevojë për mjetet më efikase të komunikimit, mbikëqyrjes dhe pajisje të tjera. Atyre u nevojitet aftësia për të lëvizur shpejt dhe të jenë të mbrojtur nga të shtënat armiqësore. Ndoshta më e rëndësishmja është se ato duhet të marrin trajnimin për t'u përballur me një shumëllojshmëri situatash të mundshme.

Ne gjithashtu duhet të konsiderojmë të bëjmë strukturat vendimmarrëse të NATO-s më fleksibël dhe të përgjegjshme. Këshilli Atlantikoverior dhe Komiteti Ushtarak janë struktura të ndara, por një shkrimje mund të formojë një trajektore domethënëse në procesin e vendimmarrjes. Në të njëjtën kohë, konsensusi është qendror në procesin e vendimmarrjes së Aleancës, dhe ai duhet të mbetet në thelb të mënyrës se si merren vendimet e mëdha. Por a është konsensusi i domosdoshëm në çdo nivel dhe a mund të përfitojmë ne nga një proces alternativ në çështjet më pak domethënëse? Kjo çështje do të bëhet më e dukshme ndërsa Aleanca rritet dhe ndërsa rritet bashkëveprimi me aktorë të tjerë ndërkombëtarë si Bashkimi Europian dhe Kombet e Bashkuara.

Rritja e Aleancës meriton gjithashtu konsideratë. Në të ardhmen e afërt ne do të mirëpresim dy anëtarë të rinj, Shqipërinë dhe Kroacinë. Në Samitin e Bukureshtit ne deklaruar në mënyrë kolektive se Gjeorgjia dhe Ukraina do të bëhen anëtare në një kohë në të ardhmen. Asambleja Parlamentare e NATO-s ofroi mbështetje të fortë për zgjerimin e shpejtë dhe të mëtejshëm të Aleancës.

Sekreti i jetëgjatësisë së NATO-s është saktësisht fakti se ajo ka vërtetuar të jetë një organizatë e adaptueshme, e cila mban lidhjen e saj. Megjithatë, ne shpejt duhet të përballemi me faktin se Aleanca ka limite të bazuara në traktate. Neni 10 qartësisht konstaton se çdo shtet evropian mund të bashkohet me Aleancën, por ka një numër në rritje të shteteve evropiane, të cilat nuk janë pjesë e Aleancës. Një moment, do të duhet të vendosim nëse ky limit gjeografik është i përshtatshëm apo jo, dhe nëse jo, çfarë ndërlikimesh ka kjo për të ardhmen e Aleancës.

Jan Petersen është ish-Ministër i Jashtëm i Norvegjisë dhe aktualisht është Reporter i Veçantë për kontributin e Asamblesë Parlamentare të NATO-s në Konceptin Strategjik.

CHARLES A. KUPCHAN

KOHA E VENDIMIT: ZGJEDHJET E VËSHTIRA TË NATO-s

Charles Kupchan i Këshillit të Marrëdhënieve të Jashtme nënvizon se NATO duhet të ndërmarrë disa vendime të vështira që do të jenë thelbësore për të ardhmen e tij. Samiti vjetor i NATO-s duket sikur është dominuar nga misioni në vazhdim në Afganistan. Dhe me të drejtë! Kapaciteti i NATO-s për të krijuar një strategji koherente, për të ndarë detyrat midis anëtarëve, për të mbajtur mbështetjen vendase për misionin është jetësor për kapacitetin e aleancës për të rritur sigurinë dhe stabilitetin në Afganistan - një qëllim që do të shërbejë si një test indikator i arritjeve të NATO-s.

Por edhe pse aleanca përballet me këtë sfidë të menjëhershme, ajo duhet gjithashtu të hapë një debat hetues për sa i përket tre çështjeve përtej horizontit, të cilat nuk mund t'i lejojë më t'i mbajë larg: marrëdhënia e saj me Rusinë, rregullat vendimmarrëse si dhe qëllimin e ambicies së saj globale. Në të tre çështjet, anëtarët e NATO-s duhet të drejtohen nga realizmi dhe serioziteti. Me Rusinë, NATO duhet të kërkojë të evitojë rivalitetin “zero”, ndërkohë duke aplikuar për një vizion praktik të bashkëpunimit programatik. Në vendimmarrje, NATO duhet të pranojë se rritja e anëtarësisë së saj e bën sigurinë për konsensus akoma më të pabindshme, duke bërë të nevojshme adoptimin e një qasje me fleksibël për qeverisje. Për sa i përket aspiratave globale, NATO duhet t'i thumbojë ato që në djep, duke kuptuar se mundimi për të shndërruar trungun në një aleancë mbarëkombëtare demokracish premtion shpejtësimin e abdikimit të saj, jo rilindjen.

Cilado qofshin meritat e zgjerimit të NATO-s, të cilat janë disa, shtrirja e aleancës ka ardhur në mënyrë të padiskutueshme

në kurriz të marrëdhënies së saj me Rusinë. Për të qenë të sigurt, rusët në vetvete mbajnë përgjegjësinë primare për tërheqjen e fundit nga demokracia po aq sa dhe gara e tyre për tepriçë politikash të jashtme - lufta në Gjeorgji, më e dukshmja ndër të tjera. Por perceptimi i lidërshiptit Rus, i ngjashëm me atë të publikut të tij, se zgjerimi lindor i NATO-s cenon sigurinë dhe prestigjin e vendit të tyre sigurisht që nuk ka ndihmuar. Përshtatshmërisht, NATO duket e përgatitur për të vënë në pritje angazhimet e saj për tani, vendosur në samitin e Bukureshtit të vitit të kaluar, për t'i ofruar anëtarësi Gjeorgjisë dhe Ukrainës. Por shpresa e vakët e anëtarësimit të Gjeorgjisë dhe Ukrainës vazhdon të ndotë dialogun e NATO-s me Rusinë.

Mënyra për të dalë jashtë nga ky zotim është të gjendet një formulë për të inkurajuar Moskën për t'u bërë dividente në rendin e sigurisë së Europës, duke bërë kështu Rusinë një pjesëmarrëse të brendshme sesa një objekt të evolucionit të NATO-s. Lufta e Ftohtë ka mbaruar prej më shumë se dy dekada dhe është koha më e mirë që NATO të bëjë përpjekje serioze për të sjellë Rusinë në marrëveshjen e pasluftës. Moska shumë mirë mund të refuzojë ofertën në favor të ftohjes me Perëndimin. Të paktën NATO do ketë bërë ç' ishte e mundur për të evituar këtë rezultat.

Me Rusinë NATO duhet të këmbëngulë të evitojë vazhdimësinë e konkurrencës zero. Në këtë pikë, qëllimi imediat nuk është të gjejmë një formulë precize për të afruar Moskën, por të fillojmë një bashkëbisedim strategjik që qartëson se anëtarët e NATO-s janë sinqerisht të përkushtuar për të ankoruar Rusinë në komunitetin European. Bashkëbisedimi mund të fillojë duke gjetur mënyra të reja për të aktivizuar më shumë Këshillin NATO-Rusi. Anëtarët e NATO-s duhet t'i përgjigjen thirrjes së Moskës për perceptime të reja rreth një «arkitekture të re sigurie europiane». Ky dialog duhet të mbështetet me bashkëpunim strategjik konkret në çështjet si mbrojtja nga raketat, hyrje në Afganistan dhe diplomaci me Iranin.

Zgjerimi i vazhdueshëm forcon gjithashtu çështjen e nevojës për reformë në vendimmarrjen e një aleance me 26

anëtarë e më shumë. Ndërsa radha shtohet në numër dhe ndryshueshmëri, siguria e vazhdueshme për konsensus shumë mirë mund të bëhet një recetë për paralizë. Përforcimi i nevojës për reformë është peizazhi strategjik i ndryshuar në të cilin operon NATO – kompleksiteti i të cilit ka dobësuar solidaritetin që gëzonte NATO gjatë Luftës së Ftohtë.

Mosmarrëveshjet e forta që janë ngritur rreth Afganistanit, rreth ngutjes për t'i ofruar anëtarësi Gjeorgjisë, rreth relatave midis NATO-s dhe Rusisë nuk po i shpejtojnë diferencat që do të zhduken së shpejti. Ato janë më tepër nënprodukte të pashmangshme të divergjencave të interesave dhe perceptimit të rreziqeve që ka shoqëruar adaptimin e NATO-s në botën e Pasluftës së Ftohtë. Pyetja kyç për aleancën nuk është nëse mund të kalohen diferenca të tilla, por nëse ato mund të tolerohen. Na pëlqen ose jo, NATO është duke u rritur në mënyrë të pabindshme dhe me një konsensus të pakuptueshëm.

Kjo divergjencë e perspektivës midis vendeve anëtare vështirë të tregojë frakturat e NATO-s, por kjo do të thotë se aleanca duhet të përshtatet sipas mënyrës që merren vendimet. Anëtarët vështirë të heqin dorë nga rregulli i konsensusit në çështjet e luftës dhe paqes. Megjithatë, në shumicën e çështjeve të tjera, aleanca duhet të krijojë një qasje më fleksibël në vendimmarrje. NATO duhet gjithashtu të konsiderojë forma të ndryshme refuzimi për t'u siguruar se papajftueshmëria e anëtarëve individualë në çështje specifike nuk do të pengojë aksionin efektiv.

Si përfundim, anëtarët duhet të fillojnë të urtësohen duke transferuar thirrjet, fillimisht të ardhura nga zëra amerikanë, për të shtrirë caqet e NATO-s përtej Europës dhe të transformojnë trungun në një aleancë globale demokracish. Rimodelimi i marrëdhënies së NATO-s me Rusinë dhe reformimi i vendimmarrjes kanë nevojë për shqyrtim të kujdesshëm. Propozimi që NATO të jetë globale nuk e bën këtë dhe duhet të shkarkohet lehtësisht.

Me të vërtetë NATO i ka të dyja duart në Afganistan dhe aftësia e saj për të mbizotëruar mbetet me pikëpyetje. Me burimet dhe kohezionin e NATO-s në misionin në Afganistan,

është e vështirë të imagjinosh se aleanca është gati të ndërmarrë zotime të tjera në terren. NATO duhet të krijojë me çdo kusht bashkëpunime strategjike me vendet dhe grupimet rajonale, të cilët dëshirojnë të kontribuojnë në çështjen e njohur - ndihma nga vendet jo anëtare është më se e mirëpritur. Por bërja e NATO-s si institucioni i zgjedhur për bërje negociatash për konfliktet nëpër botë është një urë shumë e largët.

Përvjetori i gjashtëdhjetë i NATO-s vjen në një kohë sfide dhe sforcimi për Aleancën. Në Ballkan, Kaukaz, Lindjen e Largët të Europës, si dhe në Afganistan, NATO ka shumë punë të papërfunduara. Do të kishte qenë më mirë të ishte fokusuar në përfundimin e këtyre detyrave, sesa të kishte paketuar plaçkat për misione të reja në Kashmir dhe Rripin e Gazës. Për më tepër, shtrirja e anëtarësisë së NATO-s në vende si Japonia, Australia dhe Izraeli jo vetëm që do të tregonin në mënyrë unike kundërshtimin e aleancës, por edhe do t'i mbeteshin në kurriz zotime që mundësisht janë të papërshtatshme. Për të qenë të sigurt, NATO ka një rol të madh për të luajtur përtej Europës, tashmë është duke zhvilluar lidhje në Mesdhe. Por kërkohet urtësi që NATO të fokusohet mbi të gjitha në ndihmën që të tjerët të ndihmojnë veten, duke i dhënë asistencë dhe trajnime, duke shërbyer si një institucion model, në bashkëpunime të rastësishme me shtetet vendore në misione të kufizuara, të gjitha këto në shërbim të ngritjes së organizatave të tjera të sigurisë rreth globit, të cilat mund të jenë po aq të suksesshme në rajonet e tyre sa ç'ka qenë NATO në Europë.

Përvjetori i gjashtëdhjetë i NATO-s vjen në një kohë sfide dhe sforcimi për aleancën. Përkundrajt sfondit të misionit në Afganistan, NATO do të tregohej e zgjuar nëse i konsolidonte arritjet e saj duke iu afruar Ruisë, duke përditësuar vendimmarrjen e saj në mënyrë që të reflektojë anëtarësimin më të gjerë duke njohur kufijtë e suksesit të saj.

Charles A. Kupchan është Profesor i Marrëdhënieve Ndërkombëtare në Universitetin Georgetown dhe Bashkëpunëtor i Vjetër në Këshillin e Marrëdhënieve me Jashtë.

BESNIK BAKA

SHQIPËRIA: KËRCËNIME DHE PERCEPTIME TË SIGURISË

Dokumentet më të rëndësishëm në fushën e sigurisë kombëtare në vendin tonë, në mënyrë të qartë përcaktojnë kërcënimet që i kanosen shtetit shqiptar në fusha dhe perspektiva të ndryshme. Kështu, dy dokumentet bazë mbi politikat e sigurisë kombëtare në vendin tonë Strategjia Kombëtare e Sigurisë¹ dhe Strategjia Kombëtare e Ushtrisë², vendosin piketat mbi kërcënimet që i kanosen Republikës së Shqipërisë dhe qytetarëve të saj. Strategjia Kombëtare e Sigurisë e adoptuar në vitin 2000 dhe e rishikuar në vitin 2005, njeh disa kërcënime potenciale drejtuar Republikës së Shqipërisë në kontekstin kombëtar e ndërkombëtar, duke veçuar elementët më të rëndësishëm të kërcënimeve dhe perceptimeve në fushën e sigurisë.

Megjithatë vlen të theksohet se kërcënimet e identifikuara në dokumente të ndryshëm strategjikë kanë prevalencë të ndryshme në 15 vitet e fundit, në varësi të situatave dhe ngjarjeve në nivel kombëtar, rajonal e ndërkombëtar. Disa prej tyre mund të quhen kërcënime të rastësishme të sigurisë si mund të jenë shkelja e mundshme e integritetit territorial, katastrofa natyrore, sulme terroriste etj. Ndërkohë, të tjera mund të jenë me karakter më jetëgjatë dhe perceptohen si kërcënime konstante në axhendën e sektorit të sigurisë si varfëria, krimi i organizuar, korrupsioni etj. Më poshtë do të preken shkurtimisht disa aspekte të kërcënimeve sipas kategorive përkatëse.

¹ National Security Strategy of Republic of Albania; merln.ndu.edu/whitepapers/Albania_English-2004.pdf.

² The Military Strategy of the Republic of Albania, merln.ndu.edu/whitepapers/Albania_English-2005.pdf.

Kërcënimet e sigurisë së brendshme

Mbi kërcënimet në sigurinë e brendshme të Republikës së Shqipërisë, në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë, krimi i organizuar është përcaktuar si kërcënimi kryesor për sigurinë e brendshme dhe stabilitetin e vendit. Mungesa e aftësisë për të luftuar krimin e organizuar është identifikuar si rreziku kryesor në sfidat aktuale dhe së të ardhmes për Republikën e Shqipërisë. Duke pasur parasysh përhapjen e gjerë të krimit të organizuar në vendin tonë si dhe paaftësinë për të luftuar këtë fenomen në të kaluarën, autoritetet shqiptare në vitin 2005 u fokusuan kryesisht në rreziqet që trafiku ilegal i qenieve njerëzore, por edhe drogës sillnin për stabilitetin e vendit dhe sigurinë kombëtare. Si rezultat Ministria e Rendit Publik ndërmoi masa të ashpra në luftën kundër trafikut ilegal duke luftuar disa nga grupet më të rrezikshme kriminale të trafikimit të drogës, qenieve njerëzore, prostitucionit, e pastrimit të parave.³ Ky plan veprimi u përkufizua qartë në dy dokumente kryesorë: *Strategjia e Luftës Kundër Trafikut të Qenieve Njerëzore*, dhe *Strategjia Kombëtare Kundër Trafikimit të Fëmijëve dhe Mbrojtjes së Fëmijëve të Trafikuar*.

Në kuadër të kërcënimeve në fushën e sigurisë që vijnë nga trafiku ilegal, në vitin 2006 Parlamenti Shqiptar implementoi një moratorium të diskutueshëm mbi ndalimin e të gjithë mjeteve lundruese me motor në ujërat territoriale të Shqipërisë. Ndonëse këto masa patën efekt të menjëhershëm në rënien drastike të trafikut ilegal nga deti, ato sollën një ndikim negativ në ekonomi duke paguar çmimin e këtij “kërcënimi të sigurisë”, në turizëm dhe industrinë e peshkimit si dhe në të njëjtën kohë duke kufizuar të drejtën themelore të qytetarëve për të lëvizur të lirë.

Ndërkohë korrupsioni është një tjetër çështje permanente e sigurisë përgjatë dy dekadave të fundit duke paraqitur një kërcënim serioz për shtetin ligjor dhe institucionet shqiptare.

³ Hroni and Qazimi, István Gyarmati and Darko Stanëix, *Study on the assessment of regional security Threats and challenges in the Western Balkans*. DCAF, 2007.

Duke iu referuar *Transparency International*, Shqipëria vazhdon të mbetet një nga vendet më të korruptuara në Europë për shumë vite me radhë.⁴ Si pasojë korrupsioni dhe mungesa e shtetit ligjor vazhdojnë të jenë sfida të rëndësishme për Shqipërinë, me potencial të lartë rreziku për zhvillimin e vendit.⁵ Elementi i korrupsionit është i lidhur edhe me paqëndrueshmërinë politike që konsiderohet një rrezik serioz për sigurinë e Republikës së Shqipërisë dhe interesave kombëtare. Eksperiencat e deritanishme të Shqipërisë në konsolidimin e demokracisë kanë provuar se paqëndrueshmëria politike ka qenë prezente në zhvillimet më të rëndësishme të shoqërisë duke dëmtuar proceset demokratike, në një kohë që në *Strategjinë Kombëtare të Sigurisë* stabiliteti politik konsiderohet shumë i rëndësishëm për funksionimin e demokracisë dhe stabilitetit në vend.

Të tjera çështje që konsiderohen si rrezik potencial në fushën e sigurisë janë katastrofat natyrore dhe çështjet mjedisore, të cilat mund të kenë ndikim negativ në shëndetin publik dhe zhvillimin ekonomik në raste dhe momente specifike. Kështu Shqipëria është e ekspozuar ndaj përmbytjeve, reshjeve të shumta të dëborës që mund të dëmtojnë prodhimet agro-bujqësore. Rrugët automobilistike dhe hekurudhat shpesh gjatë stinës së dimrit bëhen të pakalueshme, duke shkaktuar probleme në ekonomi dhe sfida për institucionet shtetërore në përballimin e krizave dhe emergjencave. Katastrofat natyrore gjithashtu kanë shkaktuar probleme të shumta në komunikim, shpërndarjen e energjisë elektrike, duke veçuar në këtë kontekst krizën energjetike që karakterizon Shqipërinë që prej viteve '90.⁶

Mund të veçojmë se çështja e katastrofave natyrore u kthye në prioritet në axhendën e sigurisë gjatë shkurtit 2002 kur zona të gjera në jug dhe në veri u izoluan si rrjedhojë e

⁴ Transparency International Corruption Perception.

⁵ "Human Security in Albania", Early Warning Report, UNDP-AIIS, April 2004.

⁶ Hroni and Qazimi, in István Gyarmati and Darko Stanëia, *Study on the assessment of regional security Threats and challenges in the Western Balkans*. DCAF, 2007.

kushteve të këqija të motit. Në këtë rast situata jo vetëm që ishte emergjente, por prezantonte edhe një rrezik për sigurinë kombëtare pasi jeta e shumë njerëzve u vu seriozisht në rrezik në një kohë komunitete të tëra mbetën pa energji elektrike, rezerva ushqimore dhe pa mundësi komunikimi.⁷

Për sa i përket historisë së kërcënimeve të brendshme ushtarake mund të përmendet rreziku i madh që posedimi i armëve të lehta nga popullsia civile ka patur për stabilitetin e vendit pas kolapsit të institucioneve shtetërore në vitin 1997. Anarkia që pasoi, solli në një situatë ku afërsisht 80% e armëve të lehta në vend ranë në duart e civilëve. Këtu përfshihen rreth 800000 armë të lehta, 2500 granata, 800 armë të rënda, dhe mijëra mina antinjeri, të cilat u grabitën nga bazat e shkatërruara ushtarake.⁸ Megjithatë me asistencën e komunitetit ndërkombëtar gjatë viteve të para dhe pas krizës, shumica e armëve të lehta në duart e popullsisë civile arritën të mblidhen, megjithatë argumentohet se destinacioni kryesor i këtyre armëve ishte Kosova dhe Maqedonia duke luajtur një rol të rëndësishëm në konfliktet e armatosura respektivisht në vitin 1999 dhe 2001.⁹

Duke u bazuar në dokumentet strategjike vlen të ndalemi në faktin se mund të identifikojmë disa elementë të paqartë dhe të diskutueshëm në konstatimin e kërcënimeve në sektorin e sigurisë për sa i përket referencës që i bëhet “dezinformimit

⁷ Bogdani, Mirela. “Management Crisis”. in Trapan, Jan and Fluri, Philip. *Defence and security sector governance and reform in South Eastern Europe: Insights and Perspectives*. Volume 1. Centre for Civil and Military Relations, Belgrade 2003. 159-172.

<http://www.dcaf.ch/publications/kms/details.cfm?lng=en&id=19101&nav1=4>, Accessed: November 2008.

⁸ Ferenc Gazdag, László Póti, Judit Takács, and Péter Tólas, Assessment of the Security of the Western Balkans and a Comparative analysis of the threat perception in the countries in the region, in István Gyarmati and Darko Stanëiæ, *Study on the assessment of regional security Threats and challenges in the Western Balkans*. DCAF, 2007.

⁹ Ferenc Gazdag, László Póti, Judit Takács, and Péter Tólas in Gyarmati, Assessment of the Security of the Western Balkans and a Comparative Analysis of the Threat Perception in the Countries of the Region (DCAF).

të opinionit publik”.¹⁰ Artikulli 12 në *Strategjinë Kombëtare të Sigurisë* në mënyrë të qartë thekson nevojën për të ndaluar ose thënë ndryshe censuruar informacionin e klasifikuar “sekret”¹¹ nëse siguria kombëtare mund të preket. Kjo gjë bëhet edhe më shqetësuese kur media shprehimisht konsiderohet si rrezik potencial për stabilitetin e vendit, në të njëjtën kategori me krimin e organizuar, paqëndrueshmërinë politike dhe ekonomike, emigrimin ilegal, dhe lëvizjet e pakontrolluara demografike. Kështu në gjykimin e kornizës së kërcënimeve të brendshme, ekzistenca e një elementi që censuron lirinë e fjalës mund të prishë ekuilibrin që siguron transparencën e sektorit të sigurisë dhe mund të konstitujë një kërcënim për kontrollin demokratik të reformës në sektorin e sigurisë.

Kërcënimet e jashtme

Për momentin situata e kërcënimeve të jashtme për vendin tonë paraqitet si më e qeta duke marrë parasysh zhvillimet e saj në dy dekadat e fundit. Në momente të ndryshme, Shqipëria ka njohur rreziqe të jashtme që i janë kanosur kryesisht nga vendet fqinje. Këtu mund të veçohen disa momente: Gjatë fillimeve të viteve '90 marrëdhëniet me Greqinë disa herë u përkeqësuan duke rrezikuar madje edhe stabilitetin e vendit. Shumica e ngjarjeve kryesore të lidhura me Greqinë ishin pasojë direkte e aktivitetit politik grek dhe influencës së minoritetit grek që jeton në zonat jugore të Shqipërisë. Lëvizjet nacionaliste antishqiptare, të provokuara dhe mbështetur nga disa elita politike greke për vite me radhë janë perceptuar si kërcënim për stabilitetin dhe integritetin e Shqipërisë sidomos gjatë viteve '90. Këtu mund të veçojmë disa momente kyçe si

¹⁰ (Gyarmati, Istan and Stancic Darko, Study on the Assessment of Regional Security Threats and Challenges in the Western Balkans, DCAF, 2007.

¹¹ Në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë dhe dokumentet e tjera ligjore strategjike “sekreti shtetëror” gjen një interpretim të gjerë dhe të papërcaktuar.

pranvera e vitit 1993, kur prifti grek Archimandrite Chrysostomos u përzu nga Shqipëria pasi autoritetet vendase pretendonin se ai ushtronte aktivitet antishqiptar. Zyrtarët shqiptarë e akuzuan atë se po abuzonte në drejtimin e kishës për të predikuar lëvizje separatiste dhe ideologji antishqiptare.¹² Tensionet u rritën edhe më shumë kur në nëntor të vitit 1993 autoritetet greke në shenjë hakmarrjeje reagueshan duke dëbuar me dhunë 2500 emigrantë shqiptarë që jetonin në Greqi, i njohur me operacionin “fshesa”. Në vitet që pasuan marrëdhëniet mes dy shteteve u përkeqësuan ndjeshëm, madje kryeministri i atëhershëm z. Sali Berisha, nuk ngurroi të akuzonte Greqinë se po punonte me Serbinë për të destabilizuar shtetin shqiptar.

Në prill të vitit 1994 një përplasje e armatosur shpërtheu në kufirin shqiptaro-grek, kur një grup militantësh ultranacionalist grekë, i quajtur “Fronti për Çlirimin e Vorio Epirit” (MAVI), sulmoi një postë kufitare pranë Gjirokastrës duke vrarë dy ushtarë shqiptarë. 5 persona që i përkisnin minoritetit grek në Shqipëri dhe ishin anëtarë të organizatës Omonia, e cila mbronte interesat e minoritetit grek në Shqipëri, u arrestuan dhe u gjykuan për këtë sulm. Ndërkohë Greqia, interesat e të cilës ishin prekur, reagoi duke vënë veton dhe mos lejuar lëvrimin e një kredie të rëndësishme të Bashkimit Europian për Shqipërinë.¹³ Por marrëdhëniet nisën të përmirësohen një vit më vonë kur Presidenti Grek Konstandinos Stefanopoulos vizitoi Tiranën në vitin 1996 dhe pas kësaj pavarësisht disa incidenteve të rastësishme marrëdhëniet mes dy vendeve u përmirësuan ndjeshëm. Por ndonëse marrëdhëniet mes dy vendeve janë quajtur si normale, kërcënimi potencial mbetet, sidomos në periudhat e zgjedhjeve lokale dhe parlamentare kur diskursi politik bëhet i ashpër dhe i tensionuar. Këtu mund t’i referohemi zgjedhjeve lokale të diskutueshme të vitit 2000 në qytetin e Himarës kur liderët e minoritetit grek raportuan dhunë dhe vjedhje të votës së

¹² International Crisis Group, Albania: State of Nation 2001, Report N°111 Tirana/Brussels.

¹³ Ibid.

pjesëtarëve të minoritetit grek. Fushata elektorale u karakterizua nga interferenca të shumta të politikanëve dhe zyrtarëve grekë madje disa prej tyre mbajtën edhe fjalime elektorale. Bazuar në Kodin Elektoral të Republikës së Shqipërisë, pjesëmarrja e qytetarëve të huaj në fushatat elektorale ndalohet me ligj. Pjesëmarrja e disa deputetëve grekë në Himarë shkaktoi debat dhe polemika ndërshtetërore.¹⁴ Por me kalimin e viteve influenca e minoritetit grek dhe vetë shtetit grek në sigurinë e brendshme të Shqipërisë nuk konsiderohet më një kërcënim. Greqia nuk perceptohet më si një rrezik për integritetin territorial të Shqipërisë ndërkohë që marrëdhëniet bilaterale mes dy vendeve konsiderohen miqësore.

Të tjera kërcënime të jashtme të sigurisë, Shqipëria i ka përjetuar gjatë konfliktit etnik në Maqedoni dhe Kosovë. Ndonëse Shqipëria refuzoi të bëhej palë në përplasjet e armatosura etnike që përfshinë Ballkanin gjatë viteve '90, nuk kishte si të shmangte ndikimet negative. Konflikti në Kosovë në vitin 1999 rezultoi në një eksod masiv të refugjatëve kosovarë në Shqipëri. Sipas të dhënave, më shumë se gjysmë milionë refugjatë kosovarë gjetën strehë në Shqipëri. Si rrjedhojë e krizës dhe situatës kaotike, Shqipëria u përball me një rritje të korrupsionit, pamundësi për mbledhjen e taksave, deficit buxhetor, uljen e investimeve të huaja dhe u detyrua të heqë dorë nga fondet e investimeve publike që shkuan për përballimin e krizës.¹⁵

Gjatë konfliktit të armatosur në Kosovë dhe fushatës së bombardimeve të NATO-s ndaj Serbisë në vitin 1999, integriteti territorial i Shqipërisë u shkel disa herë nga forcat serbe. Para, gjatë dhe pas konfliktit në Kosovë, Serbia vazhdoi të konsiderohej si një kërcënim për sigurinë e vendit, kjo për shkak të mungesës të ndryshimeve demokratike në Serbi. Megjithatë pas rënies së regjimit të Millosheviçit në vitin 2000, marrëdhëniet me Serbinë nisën të normalizohen dhe shteti

¹⁴ Ibid.

¹⁵ Woehrel. Steven, Islamic Terrorism and the Balkans, Congressional Research Service Report for Congress. July 26, 2005.

serb nuk identifikohet më si një kërcënim për sigurinë e Shqipërisë. Por Strategjia Kombëtare e Sigurisë dhe Strategjia Kombëtare e Ushtrisë vazhdojnë të njohin idenë se rreziqe të jashtme për sigurinë mund të lindin nga konfliktet ndëretnike. Megjithëse këto kërcënime nuk janë më të përcaktuara në dokumentet strategjike, Serbia dhe Greqia ende artikulojnë si kërcënime për interesat kombëtare nga grupe politike në vend.¹⁶

Duke pasur parasysh se situata politike në Kosovë dhe Maqedoni ende mbetet e pastabilizuar, kjo përbën një risk konstant për vendin tonë, duke aluduar se Shqipëria mund të tërhiqet në një konflikt rajonal nëse situata në Maqedoni dhe Kosovë përkeqësohet.¹⁷

Ndërkohë në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë, me kalimin e viteve, evolucioni i perceptimit të kërcënimeve është i dukshëm. Në një analizë të përmbledhur të natyrës së kërcënimeve të sigurisë, mund të kuptojmë se në Strategjinë Kombëtare të rishikuar të vitit 2005 krahasuar me atë të vitit 2000, Serbia nuk identifikohet më si rrezik për sigurinë, ndonëse mundësia e konflikteve ndëretnike ende konsiderohet si rrezik potencial.¹⁸

Aktualisht, duke iu referuar Strategjisë Kombëtare të Sigurisë dhe Strategjisë Kombëtare të Ushtrisë është riafirmuar bindja e liderëve politik se kërcënimet më serioze për sigurinë e Shqipërisë nuk vijnë më nga vendet fqinje, por

¹⁶ Menotti, Roberto, Rotta, Alessandro, Security Threat Perceptions in Southeast Europe, CeSPI and EWI, Gazeta, Artistic & Publishing Company, 2001, <http://www.cespi.it/Rotta/Security-Threat.PDF>.

¹⁷ Donais, Timothy. "Albania: Analysis of the Stability Pact Self-Assessment Studies". in Cole, Eden and Donais Tymotheny and Fluri, Philip. *Defence and Security Sector Governance and Reform in South East Europe Self-Assessment Studies: Regional Perspectives*. 2005. Geneva Centre for the Democratic Control of Armed Forces. <http://www.dcaf.ch/publications/kms/details.cfm?lng=en&id=19101&nav1=4>. Accessed: November 2008.

¹⁸ Totozani, Iglj. "Civilians and Military in Defense Planning: From a National Security Concept to a Force Development Plan". in Trapan, Jan and Fluri, Philip. *Defence and security sector governance and reform in South Eastern Europe: Insights and Perspectives*. Volume 1. Centre for Civil and Military Relations, Belgrade 2003. 67-76.

nga mungesa e stabilitetit politik në vend, zhvillimi i ulët ekonomik që zvarrisin procesin e tranzicionit drejt një demokracie të konsoliduar.¹⁹

Kërcënimet rajonale dhe globale të sigurisë

Shqipëria është një vend laik dhe feja luan një rol jo shumë të rëndësishëm në jetën politike dhe private të popullsisë. Megjithatë, gjatë viteve '90, Shqipëria shërbeu si një strehë për organizatat e huaja ekstremiste fetare kryesisht islamike, të cilat përfituan nga mungesa e shtetit ligjor dhe destabiliteti. Organizata joqeveritare ekstremiste islamike, disa prej të cilave mbështetëse të Al Qaeda-s, lulëzuan në Shqipëri nën vallon e organizatave humanitare gjatë viteve '90. Ekstremistë të huaj islamikë përdorën Shqipërinë si vend të sigurt për veprimtari terroriste madje disa prej tyre fituan edhe nënshtetësinë shqiptare. Si pasojë, kërcënimet terroriste në mes të viteve '90 shkaktuan mbylljen e përkohshme të Ambasadës Amerikane në Shqipëri dhe anulimin e të gjitha vizitave të planifikuara të zyrtarëve të lartë amerikanë në Shqipëri.

Në vitin 1998, autoritetet Shqiptare në bashkëpunim me ato amerikane arritën të ndalonin në kohë një akt terrorist ndaj ambasadës amerikane në Tiranë, duke shkatërruar një rrjet terroristësh të Al Qaeda-s dhe arrestimin e disa figurave kyçe të organizatës terroriste të drejtuar nga Osama Bin Laden.²⁰

Në përgjigje të kërcënimeve terroriste në rritje që u kthyen në një çështje prioritare në fushën e sigurisë jo vetëm në Shqipëri, por në mbarë globin, në vitin 2002 Shqipëria *aprovoi Plan Veprimin Kombëtar Kundër Terrorizmit* dhe një vit më vonë adoptoi legjislacionin e nevojshëm që synonte të luftonte pastrimin e parave dhe financimin nga organizatat e dyshuara

¹⁹ Islami. Kastriot, Strategjia e Sigurisë Kombëtare në kontekstin e rreziqeve e kërcënimeve rajonale, "Mbi zhvillimin e strategjisë së sigurisë kombëtare". IMD, 2007.

²⁰ Woehrel. Steven, Islamic Terrorism and the Balkans, Congressional Research Service Report for Congress. July 26 2005.

si terroriste.²¹ Veprimtaria e strukturave shtetërore për të luftuar terrorizmin rezultoi në masa drastike. Në vitin 2004, qeveria shqiptare vendosi të ngrijë të gjitha asetet financiare me prejardhje të dyshimtë, nisi hetimin e organizatave joqeveritare islamike të dyshuara si terroriste dhe dënoi e dëboi individë që dyshoheshin se kishin lidhje me terrorizmin. Që prej asaj kohe asnjë prezencë e aktiviteteve terroriste nuk është raportuar në vendin tonë.²²

Ndërkohë kërcënime të tjera terroriste, prezente në Shqipëri gjatë 15 viteve të fundit mund të identifikohen të lidhura me grupin politik terrorist “Hakmarrja për Drejtësi”, për të cilën zyrtarët e kohës pretendonin se ishte përgjegjës për disa sulme terroriste në periudha të ndryshme gjatë 1993-2001. Kështu “Hakmarrja për Drejtësi” mund të quhet grupi më me influencë në kërcënimet e shtetit ligjor ku përfshihen akte kriminale si grabitje bankash, pengmarrje, trafik ilegal dhe pastrim parash. Kjo organizatë pretendohet se ka përdorur metoda të sofistikuarra terroriste për vrasjen e zyrtarëve të lartë të asaj kohe si Drejtorin e Përgjithshëm të Burgjeve, Bujar Kaloshi.²³ Kjo organizatë që pretendohet se përbëhet nga elementë të lidhur me grupe politike të trashëguara nga regjimi komunist, u luftua ashpër nga organet shtetërore. Madje duke iu referuar një raport të OSBE-së mbi analizën e drejtësisë në sektorin e krimit në Shqipëri, akuzat dhe hetimet ndaj kësaj organizate janë të mbushura me parregullsi dhe fakte të diskutueshme që vijnë si pasojë e influencave politike dhe paafësisë së gjykatave për të qenë të paanshme.²⁴

²¹ Davis. Philip, Albania, Project on preventing Fail States, National Committee on American Foreign Policy, May 2005.

²² Hroni in István Gyarmati and Darko Stanëia, ed, Study on the Assessment of Regional Security Threats and Challenges in the Western Balkans 2007.

²³ Gjikhuri. Damian, Albania’s Counter Terrorism Policy Options: Finding a Strategy of Common sense, Naval Postgraduate School, Monterey, California, June 2004, <http://www.dtic.mil/cgi-bin/GetTRDoc?AD=ADA434661&Location=U2&doc=GetTRDoc.pdf>

²⁴ Ross Mari-Ann, Analysis of the criminal justice system in Albania, OSCE Presence in Albania, 2006,

http://www.osce.org/documents/pia/2006/11/21952_en.pdf.

Aktualisht, aktivitete të organizatave të tjera terroriste nuk konsiderohen si rrezik për sigurinë e Shqipërisë, ndonëse sulme dhe ngjarje me sfond terrorist kanë ndodhur gjatë viteve të fundit. Duke iu referuar statistikave gjatë viteve 2001-2006, Shqipëria regjistroi 12 incidente të identifikuara si terroriste, me 2 të vdekur në një numër total prej 228 incidentesh që shkaktuan 37 të vdekur.²⁵

Së fundmi, mund t'i gjykojmë si të ekzagjeruara pretendimet mbi aktivitetin e grupeve nacionaliste për një Shqipëri të madhe etnike. Teksa është një fakt i padiskutueshëm se në disa zona specifike në Serbi e Maqedoni, konfliktet etnike mund të perceptohen si kërcënime lokale; për Ballkanin Perëndimor rreziku i një Shqipërie të madhe mund të përshkruhet si irrelevant. Ata që e konsiderojnë këtë fenomen një rrezik rajonal nënvlerësojnë ndryshimet domethënëse të komuniteteve Shqiptare në Ballkanin Perëndimor.²⁶

Megjithatë në kohët e sotme trafiku i qenieve njerëzore, armëve dhe drogës, organizatave kriminale, terrorizmi dhe përhapja e armëve të shkatërrimit në masë nuk shihen me si çështje që kanë të bëjnë ekskluzivisht me sigurinë e brendshme të një shteti, por gjithmonë e më shumë po dalin në pah si fenomene ndërkombëtare, dhe sfida që në një masë të konsiderueshme mund të kenë ndikim për sigurinë, paqen dhe stabilitetin në të gjitha vendet. Si pasojë, veprimtaritë ilegale janë zgjeruar ndjeshëm duke kaluar dimensionin e kufijve kombëtarë.²⁷

²⁵ Ferenc Gazdag, László Póti, Judit Takács, Péter Tálas, Assessment of the Security of the Western Balkans and a Comparative Analysis of the Threat Perception in the Countries of the Region, in István Gyarmati and Darko Stančić, *Study on the Assessment of Regional Security Threats and Challenges in the Western Balkans*, DCAF, 2007.

²⁶ Ibid.

²⁷ National Security Strategy of Albania.

Perceptimi i rrezikut në sektorin e sigurisë

Koncepti i sigurisë për një kohë të gjatë është interpretuar ngushtësisht si: siguria e territorit nga agresionet e jashtme ose si mbrojtje e interesave kombëtare në politikat e jashtme. Por për shumicën e njerëzve një ndjenjë pasigurie më së shumti zhvillohet nga shqetësimet e jetës së përditshme, sesa nga frika e ngjarjeve tragjike nëpër botë.²⁸ Për sa i përket diferencave mes perceptimeve të publikut dhe kërcënimeve të sigurisë të njohura dhe pretenduara nga institucionet shtetërore ka një kontrast që mund të na drejtojë në disa argumente mbi kërcënimet reale dhe artificiale në fushën e sigurisë duke iu referuar perceptimit të publikut. Si rrjedhojë mund të pranojmë idenë e Gyarmatit,²⁹ i cili thotë: "... dokumentet strategjike kombëtare dhe mendimi i njerëzve reflektojnë një prirje artificiale të kërcënimeve të sigurisë. Si rrjedhojë, situata aktuale në Ballkanin Perëndimor mund të karakterizohen si "siguri virtuale" me "kërcënime artificiale"."

Teksa analizojmë strategjitë kombëtare dhe dokumentet e tjera në fushën e sigurisë, kuptojmë se siguria njerëzore është shumë pak e përfshirë dhe aspak e prioritizuar krahasuar me kërcënimet e jashtme dhe rajonale. Kjo krijon një hendek mes njerëzve dhe institucioneve shtetërore duke pasur parasysh se kryesisht perceptimi i kërcënimeve të sigurisë në publikun e gjerë është e lidhur ngushtë me "sigurinë njerëzore" që ka ndikim të drejtpërdrejtë tek ata, ndërkohë që institucionet i japin më shumë rëndësi kërcënimeve të sigurisë shtetërore e territoriale ku interesat kombëtare mund të preken.

Duke iu referuar raportit të UNDP-së të vitit 1994 që solli një perspektivë të re në përcaktimin dhe rëndësinë e sigurisë njerëzore në nivel global, me *siguri njerëzore* kuptojmë: "... së pari siguri ndaj kërcënime kronike si uria, sëmundjet dhe

²⁸ Human Development Report 1994, UNDP 1994, <http://hdr.undp.org/en/reports/global/hdr1994/chapters/>

²⁹ Gyarmati, Istan and Stancic Darko, Study on the Assessment of Regional Security Threats and Challenges in the Western Balkans, DCAF, 2007.

represioni, së dyti kuptojmë mbrojtje nga çrregullime të papritura dhe mizore në modelin e jetës së përditshme në shtëpi, punë apo komunitet”.³⁰ Më së shumti konceptet e sigurisë njerëzore duke u bazuar në studimet e UNDP-së janë ngushtësisht të lidhura me 7 kategori kryesore që përfshijnë: sigurinë ekonomike, sigurinë ushqimore, sigurinë e shëndetit, sigurinë mjedisore, sigurinë personale, sigurinë e komunitetit dhe sigurinë politike. Të gjitha këto kategori të lidhura ngushtë me zhvillimin human përbëjnë sfidat kryesore të sigurisë nëse koncepti i sigurisë transferohet nga prioriteti ekskluziv që i drejtohet sigurisë territoriale drejt një vëmendjeje më të madhe për sigurinë e njerëzve. Si rrjedhojë përgjigja ndaj kërcënimeve të sigurisë duhet të realizohet jo nëpërmjet forcës së armëve, por nëpërmjet zhvillimit të qëndrueshëm human. Mund të jetë e vërtetë se kufijtë e një shteti të jenë të sigurt, por njerëzit jo domosdoshmërisht mund të ndihen të sigurt nga krimi, ushqimi i mjaftueshëm, kujdesi shëndetësor ose respektimi i të drejtave të njeriut e të drejtat politike.

Bazuar në një sondazh të zhvilluar nga Instituti për Demokraci dhe Ndërmjetësim gjatë vitit 2007, mund të zbulohet se të anketuarit perceptojnë faktorët e brendshëm (korrupsionin, ngecjen ekonomike dhe krimin e organizuar) si kërcënimet më të rëndësishme të sigurisë kombëtare, ndërkohë janë shprehur pak të shqetësuar me kërcënimet e jashtme si terrorizmi apo sulmet ushtarake nga vendet fqinje. Për sa i përket Shqipërisë, infrastruktura e dobët, zhvillimi ekonomik i ulët dhe krizat e shpeshta të tranzicionit kanë përkeqësuar në aspekte të ndryshme standardet e sigurisë për njerëzit, sidomos për kategorinë e varfër.³¹

Teksa analizojmë rezultatet e një tjetër studimi të drejtuar nga Instituti Shqiptar i Studimeve Ndërkombëtare, vëmë re se varfëria dhe papunësia janë shqetësimet kryesore për sigurinë njerëzore në Shqipëri ku 58% e të anketuarve

³⁰ Human Development Report 1994, UNDP 1994, <http://hdr.undp.org/en/reports/global/hdr1994/chapters/>

³¹ Meidani. Rexhep, Siguria njerëzore në Shqipëri dhe Ballkanin Perëndimor, Gazeta “Shekulli”, 1 tetor 2007.

theksojnë varfërinë si problemin më imediat. Kjo mund të shpjegohet edhe me faktin se në vitin 2006 niveli i papunësisë ishte 13.8% në shkallë vendi.³² Ndërkohë të dhënat që i referohen standardit të jetesës për shqiptarët tregojnë se 25.4% e popullsisë jetojnë poshtë kufirit të varfërisë dhe 5.4% janë “të varfër në ekstrem”.³³

Një tjetër aspekt interesant që zbulohet në studimin e perceptimit të popullsisë në kërcënimet në fushën e sigurisë është pasiguria që rrjedh nga rritja e korrupsionit dhe klima politike e tensionuar dhe konfliktuale, e cila ka një impakt negativ në ekonomi dhe që reflektohet në standardin e jetës së qytetarëve. Sipas një sondazhi të fundit, 83% e qytetarëve të pyetur identifikojnë politikën si burimi kryesor i konfliktit në vend.³⁴

Ish-Presidenti i Republikës së Shqipërisë, z. Rexhep Meidani, e përshkruan kështu situatën: “... elementët e shqyrtuar në kornizën e sigurisë njerëzore janë prekur rishitas në Strategjinë Kombëtare të Sigurisë, por çështja mbetet cila është pesha e vërtetë e sigurisë njerëzore në perspektivën në tërësi të çështjeve të sigurisë në Shqipëri”.³⁵ Mund të vlerësojmë se procesi i vendosjes në axhendën e sigurisë së çështjeve të ndryshme më së shumti është i lidhur me kërcënime tradicionale të sigurisë dhe më së shumti e orientuar nga shteti sesa nga individ. Si rrjedhojë siguria personale është një çështje, e cila pavarësisht situatës të trazuar në vend, nuk gjen hapësirë në procesin e përpilimit të axhendës së sigurisë nga aktorët e sektorit të sigurisë. Duhet sqaruar se siguria personale përfshin kërcënimet ndaj dhuna, nga vetja (vetëvrasjet, abuzimi me drogën), aksidentet rrugore dhe industriale etj.

Një shembull i mirë për të ilustruar këtë dimension të kërcënimeve në fushën e sigurisë, janë shifrat e aksidenteve

³² Instituti Kombëtar i Statistikës (INSTAT), <http://www.instat.gov.al/>

³³ “Human Security in Albania”, Early Warning Report, UNDP-AIIS, April 2004.

³⁴ “Human Security in Albania”, Early Warning Report, UNDP-AIIS, April 2004.

³⁵ Meidani. Rexhep, Remarks on strategy document revision, Mbi zhvillimin e strategjisë së sigurisë kombëtare. IDM, 2007.

rrugore, të cilat janë ndër më të lartat në Shqipëri gjatë 15 viteve të fundit, por megjithatë asnjëherë siguria rrugore nuk është gjykuar si çështje e jashtëzakonshme në sektorin e sigurisë. Për pasojë asnjë strategji ose masa të jashtëzakonshme janë ndërmarrë për të luftuar këtë të keqe në një plan afatgjatë. Duke iu referuar Institutit Kombëtar të Statistikës nga vitin 1995 deri në vitin 2007 kanë ndodhur 7410 aksidente të rënda automobilistike që kanë lënë pas 10559 viktima, 3785 e të cilëve kanë rezultuar fatale për jetën.³⁶

Duke ndjekur statistikën, vit pas viti kemi një rritje progresive të numrit të aksidenteve në 12 vitet e fundit. Pavarësisht këtyre shifrave dramatike, siguria rrugore nuk është theksuar asnjëherë si një prioritet në axhendën e kërcënimeve në fushën e sigurisë në Shqipëri. E njëjta gjë mund të pretendohet për kriminalitetin dhe krimet kundër personit. Bazuar në statistikën zyrtare të INSTAT-it gjatë periudhës 1993-2001 kanë ndodhur 55855 krime nga të cilët 4085 kanë qenë fatale për jetën në një total prej 10700 krime kundër personit (vrasje e tentativa vrasjeje, plagosje, përdhunime etj). Shifrat mendohet të jenë edhe më të larta meqenëse shumica e krimeve nuk raportohen.

Ndryshe me sigurinë personale i referohemi “lirisë nga frika”.³⁷ Analiza e ndërmarrë na tregon se numri i rasteve të krimeve është rritur në kategori të ndryshme në një kohë që perceptimet e njerëzve demonstrojnë se individët ndihen të pasigurt.³⁸ Në këtë kontekst aspekte të ndryshme të “frikës” mund të konsiderohen si faktorë që kërcënojnë sigurinë individuale. Në radhë të parë siguria personale është çështje e faktorëve kualitativ si p.sh. ndjenja dhe perceptime personale, duke e bërë Shqipërinë një vend me probleme serioze në fushën e sigurisë njerëzore pavarësisht faktit se asnjë vëmendje e veçantë i është kushtuar kësaj të fundit në dokumentet strategjike.

³⁶ INSTAT. Road traffic accidents, www.instat.com.al.

³⁷ United Nations Development Program (UNDP), (1994) *New Dimensions of Human Security* (New York: Oxford University Press).

³⁸ “Human Security in Albania”, Early Warning Report, UNDP-AIIS, April 2004.

Për të përmbledhur sa u tha më sipër, kërcënimet dhe perceptimet në fushën e sigurisë, në vendin tonë janë të karakterizuara kryesisht në dy drejtime: kërcënimet të njohura “zyrtarisht” që i kanosen Republikës së Shqipërisë dhe që i gjejmë në dokumentet zyrtarë strategjike, dhe në anën tjetër perceptime që qytetarët shqiptarë kanë mbi sigurinë personale. Në këtë kontekst mund të vërejmë njëfarë kontradikte mes kërcënimeve që pretendohen nga aktorët në fushën e sigurisë dhe perceptimi i rreziqeve nga publiku i gjerë. Vlen për t’u theksuar se një rol të rëndësishëm këtu luan edhe media, e cila mund të jetë burimi kryesor i informacionit për dhunën që na rrethon. Besohet se raportet e gazetave dhe kronikat televizive janë të mbushura me informacione e lajme mbi dhunën dhe kriminalitetin, duke pasur ndikim të drejtpërdrejtë në perceptimin e njerëzve dhe duke i shkaktuar atyre pasiguri. Por në anën tjetër mund të vëmë re edhe një tendencë pranueshmërie dhe tolerance të institucioneve shtetërore me shifrat alarmante të kriminalitetit dhe dhunës duke e shmangur nga axhenda e kërcënimeve të sigurisë.

Në konkluzion mund të themi se duhet të riparë mundësia e rishikimit dhe rivlerësimit të kërcënimeve në fushën e sigurisë sidomos në dokumentet strategjike, me qëllim reflektimin e perceptimeve të kërcënimeve të sigurisë shoqërore në politikat shtetërore. Si rrjedhojë kjo do të sillte më pranë nevojat e publikut me strategjitë reale për të luftuar kërcënimet potenciale në fushën e sigurisë.

Besnik Baka
është kërkues shkencor në
Institutin për Demokraci dhe Ndërmjetësim

LEDIAN RUSTA

DEKONSTRUKTIMI I TERRORIZMIT SI DEFEKT I SITUATËS KOMUNIKATIVE

Sot gjerësisht flitet për terrorizmin si një fenomen, por shpeshherë ai interpretohet sipas paradigmeve dhe fushave të ndryshme të interesit. Në këtë kontekst, të gjithë pranojmë se fenomeni i terrorizmit është një në kuptimin semiologjik, por i ndryshëm për sa i përket interpretimit. Megjithatë për ta studiuar këtë fenomen shpeshherë mund të shtrohet një pyetje e tipit metodologjik. Cila është fusha që duhet të studiohet, përmes kujt paradigme apo modeli dhe me çfarë qëllim? Mendoj se të tre këto pyetje perspektivë janë themelore për të kuptuar se si interpretohet ky fenomen, cili është interesi i atij që e interpreton dhe cilat grupe interesi fshihen pas këtij interpretimi. Megjithatë në këtë vazhdë mendoj se interpretimi thjesht sipas një fokusi apo sipas një modeli të vetëm shpeshherë tkurret në një dogmatizëm metodologjik që nuk përmban një dozë të moderuar kritike duke na e shfaqur këtë fenomen tepër të thjeshtëzuar. Kështu, nisur nga ky aspekt, hamendësoj se fenomeni i terrorizmit për ta depolitizuar pak kuadrin politik të çështjes në fjalë mund të interpretohet si një krizë nisur nga një situatë logjike dhe komunikative. Pra, shkak i lindjes dhe i studimit të këtij fenomeni mund të bëhet edhe sipas këtyre dy perspektivave të fundit.

Nisur nga një situatë komunikative shihet qartë që lindja apo prosperimi i këtij fenomeni shihet si një defekt i vetë strukturës komunikative mes aktorëve të ndryshëm. Në këtë tezë, mbështetja e këtij interpretimi shprehet hapur te Habermas-i. Si pasojë nisur nga një defekt në komunikim, mundet që terrorizmin ta paraqesim thjesht si luftë, por në të vërtetë është një disproporcion forcash që nuk përfaqësohet

nga një shtet, por fshihet pas identitetit të tyre duke marrë ndonjëherë më tepër dritëhijet e një përplasje kulturoro-sociale sesa politike. Kështu, në këtë kuadër, koncepti i terrorizmit si një fenomen i pakrijuar dhe i palegjitimuar nga një shtet na bën të kuptojmë se ky fenomen dhe vetë islami radikal është i çterritorizuar dhe konceptet e vjetra “*të terrorizimit, traditës dhe fesë*” duken pa shumë konotacion aktual. Përgjithësisht Perëndimi beson në fakt se terrorizmi është vetëm shprehja e dëshpëruar e fesë, duke përdorur të njëjtën paradigme si shumë kohë më parë në kohën e kryqëzatave dhe duke bërë kështu që fenomeni të thjeshtëzohet tepër. Në të njëjtën kohë, në këtë drejtim, kostelacioni arab mbetet pak a shumë i panjohur në thellësi brenda një tipologjie politike të ngushtuar që shkonte, pak a shumë, nga Khomeini tek Arafat. Megjithatë problemi në fakt qëndron edhe te bota e serviturur përmes mediave që përmes politikave të tyre të ngushta politiko-ekonomike projektojnë ndonjëherë një vizion jo real të jetës dhe mjerimit në vendet ku krijohet ky terrorizëm islamik. Kjo pasi në erën e projektimit mediatik në festimin ritual të themeleve të reja metafizike të polisit, nuk ka vend për dëshpërimin e bijve të Abrahamit.

Duket se në procedimin e pushtetit ekziston një lloj logjike “*perverse*” hegeliane, një mekanizëm shuarje që aktivizohet kur opinioni publik vihet në lëvizje. Kështu ndodhi me Shkollën e Frankfurtit ku në momentin që logjika kapitaliste shpaloste sukseset e saj të para, mendimi i Adornos dhe Marcuse-s zhvendosej thjesht në mënyrë automatike në sferën e akademizimit olimpike. Në këtë kuptim, edhe mundësia për ta parë më gjerë fenomenin e terrorizmit duket tepër e errëzuar pasi ky fenomen ka pësuar një legjitim që vjen nga një polarizim dihotomik. E shprehur me një gjuhë filozofike, mund të themi se ky polarizim është lufta për krijuar qëndrueshmërinë e rendit politiko-social të perëndimit. Pra, duket se imazhi qendror shfaqet si në rastin e rënies e dy kullave binjake.³⁹ Vini re se si pamja e sakrificës (rënia e dy kullave) ka një forcë

³⁹ Paradoksalisht një simbol laik i prosperitetit materialist kapitalist bëhet një simbol përfaqësues apo një alibi për një luftë antifetare në Lindje.

dramatike dhe universale të padëgjuar më parë saqë nuk lejon analiza kritike, nuk lejon interpretime alternative. Le të kujtojmë p.sh. se Muri i Berlinit pavarësisht nga domethënia e tij historiko-politike kishte bërë të mundur thërrmimin e një kurioziteti imagjinar alternativ e madje të dëshirës e në fund të viteve nuk ndante, por lejonte mundësinë e depërtimit mes dy sistemeve. Mirëpo sot kjo nuk është e mundur aq sa çdo kritik radikal shihet si një “*Sad*” potencial që duhet të mbyllet në Bastijë. Nuk ka rëndësi nëse edhe ai si të tjerët bërtet, “*qytetarë, këtu vriten të burgosurit!*” pasi blasfemia deskenarizohet në mënyrë që të ofrojë më tepër pamjes sesa zë, më tepër ndëshkim sesa garanci. Nisur nga kjo panoramë, që të bëjmë të mundur edhe një kuptim të terrorizimit, nevojitet që ai të dallohet nga fenomeni i kriminalitetit për hir të aspektit dhe përmbajtjes.

Kështu nëse kuptojmë këtë arsye, kuptojmë edhe faktin e tërthortë se terrorizmi kërcënon legjitimitetin e një shteti demokratik që përkundrejt këtij fenomeni kërkon të krijojë një fenomen hiperkundërshtues ndaj tij duke e luftuar edhe me mjete antidemokratike. Pikërisht ky fakt i fundit duke se vihet edhe në jetë për shkak se fundamentalizmi fetar dhe ai i terrorist nuk shuhet si gjëra relativisht të ndara, por si domosdoshmërisht të lidhura. Megjithatë nga një këndvështrim shkakësor, sipas Habermas-it të dy janë shprehje të një krize komunikative mes përplasjes së kulturave tradicionale dhe modernizimit. Për këtë arsye, Habermas mendon se kërcënimi i terrorizmit global ka përshpejtuar nevojën e kalimit në shkallën botërore nga e drejta ndërkombëtare klasike në një rend të ri kozmopolit.

Lindja e këtij fenomeni dëshmon në thelb një deformim në komunikim apo një patologji komunikative. Si rrjedhim nëse në këtë fenomen që mpleks në vetvete shumë fenomene të tjera e shfaq çështjen fetare si një qëndrim dogmatik besimi, ky besim ka nevojë të përliqet përmes dhe në një autoritet. E nëse nisemi nga vizioni i modernitetit shohim se ai e kufizon fenomenin fetar apo fenë në brendësi të dimensionit spiritual të jetës duke e larguar nga kontrolli politik i sferës publike e duke e quajtur këtë si një nga mundësitë e shumta në jetës

publike. Por megjithatë paradigma fetare nuk mund të merret si një vektor i vetëm për të interpretuar fenomenin e terrorizmit islamik. Kështu paradigma fetare në botën perëndimore ndryshe nga ajo lindore është e ndryshme në botëkuptim. Në përvojën fetare perëndimore, perëndimorët gjejnë dy elemente si janë shenjtëria dhe detyrimi. P.sh. kristianizmi me reformimin e tij përgjatë kohës u fokusua më tepër në dimensionin e detyrimit duke u bërë më tepër abramik. Pra, hapja ndaj tjetrit lidhet drejtpërdrejt më faljen e pakushtëzuar ndaj tij. Në këtë aspekt, toleranca ekziston si kusht i universalizmit të pretenduar nga shoqëritë moderne pluraliste.⁴⁰ Jo më kot për Habermas terrorizmi duket si një përgjigje kundër mosdëshirës për realizimin e projektit modern dhe fundamentalizmi bëhet terrorizëm në përgjigjen e dhunshme përkundrejt procesit të të përshpejtuar të “modernizimit”. Kjo shpjegon edhe faktin e situatës kulturore tradicionale dhe represive përkundrejt vlerave materialiste dhe teknologjike të Perëndimit.

Terrorizmi i tipi “*Al Qaeda*” lind nga konteksti i dinamikës mes përfituesve, fituesve dhe humbësve të procesit të globalizmit ku Perëndimi në sytë e tyre shihet si një forcë e boshatisur nga vlerat shpirtërore dhe e zhytur në konsumizëm ekonomik dhe kulturor. Megjithatë në të vërtetë spiralla e dhunës komunikative ekziston edhe në shoqëritë perëndimore, por hapësira e debatit përmes demokracisë pjesëmarrëse e ndërpret ciklin që shndërron çrregullime komunikative në humbjen e besimit reciprok e që më pas mund të sjellë ndërprerjen e komunikimit. Në rrafshin politik, në skenarin e globalizuar duket se e drejta ndërkombëtare nuk zotëron mjaftueshëm legjitimitet që të përthith krizën komunikative.⁴¹ Shpeshherë kjo paraqet një kornizë institucionale për takime formale si të G8-ës që shpeshherë nuk pasojnë, por përforcojnë status quo-n. Si pasojë, nëse e gjykojmë nga ky këndvështrim atëherë ngjarjet terroriste si ato të 11 shtatorit mund të interpretohen si një “*major event*”

⁴⁰ Si dihet çdo fe ka një bërthamë dogmatike, por krijohet një fundamentalizëm kur autoriteti i lidhur me këtë fe nuk njeh pluralizmin si nga ana epistemike ashtu edhe politike. Kështu fundamentalizmi është një fenomen që qëndron në atribuimin e një karakteri universalist të fesë.

⁴¹ Vlen të përmendet ndërhyrja në Irak e USA-s pa miratimin e OKB-së.

ose ndryshe nëse ndryshojmë këndvështrimin. Nëse fenomenin e terrorizmit e shohim të interpretueshëm jo si një kundërvënje ndaj një projekti global, por kundrejt një projekti lokal atëherë ngjarjet e ndryshme të lidhura me këtë fenomen si rasti i 11 shtatorit mund të simbolizojë një përshtypje. Ai mund të shfaqet si sinonim i një krize autoimunitare që sistemi duhet ta parashikonte dhe parandalonte.

Nisur nga kjo perspektivë, në njëfarë aspekti, duket se bota Perëndimore shpesh ka dhënë tërthorazi “*ndihmesën e saj*” në këtë formë të terrorizmit pasi ka ndihmuar në formimin dhe pajisjen me teknika dhe njohuri praktike individët që marrin pjesë në këto ngjarje. Lidhur me këtë fakt empirik, Derrida mendon se terrorizmi është shprehje e një sindrome autoimunitare që zhvillohet në tre momente: së pari një krizë autoimuniteti pasi vetë Perëndimi i instruktoi tërthorazi personazhet e terrorizmit. Së dyti, fenomeni i terrorizmit është dhe mbështet më tepër tek e ardhmja sesa tek e tashmja apo e kaluara pasi terrorizmi përbën një përpunim kolektiv të traumës, jo veçanërisht moderne, që pritet të vijë. Është një traumë e ndërtuar simbolikisht në hapësirën publike që sipas Derridas duhet montuar dhe studiuar. Së treti, lufta ndaj terrorizmit stabilizon dhe legjitimon efektin terrorizues të vetë terrorizmit.

Këtë të fundit përdor politika si alibi për ta kundërshtuar dhe luftuar këtë fenomen me çfarëdo lloj mjeti, qoftë edhe antidemokratik parimisht dhe moralisht. Si pasojë, jo rastësisht, në trajtën e sotme të terrorizmit ne shohim përdorimin e një lloj teologjie politike. Në të vërtetë kjo e fundit është tepër e rëndësishme në të ashtuquajturin islam virtual apo fundamentalist pasi ka një rol katalitik ndërkohë që në perëndim fjala “*laik*” nënkupton përpjekjen për të cmitizuar rendin, shtetin, teknikën, racionalitetin etj. Si pasojë duket që polariteti respektiv mes terrorizmit islamik⁴² dhe Perëndimit na shfaqet i përmbysur. Në fakt paraqitja polare është një logjikë dihotomike që përjashton të vërteta dhe mundësi të tjera

⁴² Në të vërtetë në termin “*terrorizmi islamik*”, fjalë e dytë është tepër e rëndësishme jo sepse e evidenton islamizmin si terrorist, por përkundrazi bën të ditur se terrorizmi nuk është i lidhur domosdoshmërisht me islamin duke bërë që të ekzistojnë lloje të ndryshme terrorizmash.

alternative ndërkohë që vetë fenomeni i terrorizmit ka çmontuar tërthorazi të tërë kategoritë dhe dallimet klasike të filozofisë politike. Dallimi mes fushës kombëtare dhe ndërkombëtare, mes ushtrisë dhe policisë, objektivit ushtarak dhe atij civil, terrorizmit shtetëror dhe atij jo shtetëror, luftës civile dhe asaj ndërshtetërore, luftës dhe terrorizmit.

Kështu për Derridan vetë fenomeni i terrorizmi ka prodhuar dhe po prodhon një paqëndrueshmëri kuptimore të barrierave mes koncepteve që minon vetë konceptin e barrierës (territoriale) dhe kufirit (konceptual). Kështu për të, thelbi i terrorizmit që mbetet si një kërcënim joshtetëror dhe anonim është i të përmbysurit të raportit mes “*terrenit*” dhe “*territorit*”. Përmes teknologjisë globale terrori i rrezatuar nga mundësia konstante e terrorizmit e përmbys edhe vetë modelin e vjetër klasik të shtet-kombit. Nisur nga ngjarjet e ndryshme që fillojnë që nga 11 shtatori shohin se terrorizmi solli jo thjesht shpërbërjen e rendit politik tradicional të bazuar mbi marrëdhëniet ndërshtetërore, por ishte një nga shenjat patologjike më evidente të tyre pasi u bazua në një dhunë fizike. Kjo sepse vetë koncepti i sovranitetit të një vlere apo i një grupi vlerash nuk mund të identifikohet si një shenjë me imazhin e saj korrespondues pasi ato nuk karakterizohen më nga territore të përcaktuara dhe të përshkrueshme prerë.

Kështu hapësira globale bashkëkohore përmbys panoramën gjeopolitike tradicionale. E si logjikë përvijuese e saj, nëse në fillim terrorizmi shihej nga Derrida si një fenomen i krijuar nga brenda vetë shtetit të prekur më pas ai ka të bëjë me faktin e përvijimi dhe fizionomisë së ndryshuar të vetë këtij fenomeni i krijuar në fillësë që në Luftën e Ftohtë. Mirëpo megjithatë problemi tashmë ndërlikohet disi pasi me fitoren e polit amerikan u shkaktua dhe humbja e ekuilibrit të terrorit duke krijuar një kërcënim jo kombëtar, jopolitik dhe si rrjedhojë të paparashikueshëm gjeostrategjikisht. Për këtë rrjedhojë, kufiri mes luftës dhe terrorizmit nuk është kurrë aq i prerë pasi nuk duket të jetë një koncept, sesa një fushë e prekshme nga oportunizma të interesave të ndryshëm të grupeve të ndryshme të interesit. Për këtë arsye shpeshherë lufta kundër terrorizmit merr nuanca të përplasjes së qytetërimeve, kulturës dhe vlerave

respektive e si pasojë na nevojitet të kuptojmë krizën e legjitimit të këtij fenomeni në mënyrë që të krijojmë një arsenal teorik e moral për ta luftuar më drejt këtë fenomen duke zgjidhur si pasojë edhe krizën komunikative që e krijon këtë fenomen e që krijon ky fenomen.

LEDIAN RUSTA

*Pedagog pranë Departamentit të Filozofisë,
Universiteti i Tiranës*

ARIAN DYRMISHI

INTERCEPTIMI I KOMUNIKIMEVE NË SHQIPËRI: Kontrolli dhe Mbikëqyrja

SHKURTIME

SIS	Shërbimet informative dhe të sigurisë
IZL	Institucionet e zbatimit të ligjit
KEDNJ	Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut
LPD	Ligji për përgjimin e telekomunikimeve
SHISH	Shërbimi Informativ Shtetëror
GJEDNJ	Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut

I. Hyrje

Në shumë vende të zhvilluara interceptimi i telekomunikimeve është një mjet i rëndësishëm për grumbullimin e informacionit, nga shërbimet informative dhe të sigurisë (SIS) dhe institucionet e zbatimit të ligjit (IZL), në punën kundër krimit të organizuar, terrorizmit dhe mbrojtjen e sigurisë kombëtare. Por nga ana tjetër, krahas nevojës për interceptime, ekziston rreziku i përdorimit jo proporcional dhe të pakontrolluar, i cili mund të ketë pasoja për liritë e individit.

Gjetja e baraspeshës midis të drejtave të njeriut dhe sigurisë së procedurave dhe operacioneve është një sipërmarrje e vështirë për t'u arritur, sidomos në fushën e interceptimeve. Por për një vend demokratik, që aspron të ndërtojë një shoqëri të sigurt, të drejtë dhe tolerante, kjo përbën dhe një gur prove për nivelin e angazhimit drejt realizimit të këtyre aspiratave.

Ky *Backgrounder* analizon legjislacionin që rregullon interceptimin e telekomunikimeve duke u fokusuar në:

Kontrolli dhe mbikëqyrja janë termat që përdoren për shqyrtimin dhe vlerësimin e aktivitetit të shërbimeve informative dhe sigurisë. Ato kryhen në disa nivele:

o **Mbikëqyrja parlamentare** – përfshirja e parlamentit në këtë proces mundëson legjimitetin dhe përgjegjshmërinë demokratike. Kontributi i parlamentit bën të mundur që shërbimet informative dhe të sigurisë t'i shërbejnë interesave të shtetit dhe mbrojtjes së kushtetutës dhe jo interesave të ngushta sektoriale dhe politike.

o **Kontrolli i brendshëm** – kompetencat dhe detyrimet përkatëse të zyrtarëve drejtues për veprimet e vartësve të tyre (përfshirë dhe mekanizmat për disiplinimin dhe mbrojtjen e të drejtave të punonjësve brenda këtyre institucioneve).

o **Kontrolli i ekzekutivit** – kompetencat dhe detyrimet e zyrtarëve të lartë të ekzekutivit ku përfshihen dhe ministrat që kanë përgjegjësi mbi shërbime informative.

o **Mbikëqyrja nga gjyqësori** – ku përfshihet roli i gjyqësorit në miratimin e aktiviteteve të caktuara informative dhe në gjykimin e shkeljeve të mundshme të ligjit.

o **Mbikëqyrja nga media dhe shoqëria civile** – që shprehet në rolin e tyre për të nxitur diskutimin mbi aktivitetin e shërbimeve informative dhe përgjegjshmërinë e zyrtarëve të tyre.

- instrumentet ligjore që garantojnë që interceptimet të kryhen vetëm atëherë kur ato janë të justifikuara dhe autorizuara sipas kriterëve strikte, bazuar në ligj;

- instrumentet ligjore që sigurojnë mbikëqyrjen e procesit të interceptimeve nga ekzekutivi, parlamenti dhe gjyqësori.

Backgrounder-i mbështetet në kuadrin ligjor që rregullon interceptimin e telekomunikimeve në Shqipëri, në legjislacionin e disa vendeve me demokraci të zhvilluar si dhe në literaturë që trajton çështje të kontrollit dhe mbikëqyrjes demokratike të shërbimeve informative dhe institucioneve të sigurisë dhe zbatimit të ligjit.

II. Nevoja për interceptime dhe përfitimet

Të dhëna statistikore të luftës kundër krimit (2005-2008)

- o Heroinë e sekuestruar: 362622 kg.
- o Të proceduar penalisht: 685 persona

- o Kokainë e sekuestruar: 24966 kg.
- o Të proceduar penalisht: 88 persona

- o Heroinë e sekuestruar: 362622 kg.
- o Të proceduar penalisht: 685 persona

- o Hashash-Marijuanë e sekuestruar: 24128 ton
- o Trafik armësh i zbuluar: 25 raste

- o Persona në kërkim të arrestuar: 389

- o Grupe kriminale të goditura: 237
- o Autorë krimesh pjesëtarë të grupeve kriminale të goditura: 1006

- o Operacione të realizuara në bashkëpunim ndërkombëtar: 61
- o Autorë krimesh të arrestuar: 155

Burimi: Policia e Shtetit, Raporti “Qëndrueshmëria dhe Masat për të Ardhmen për të Përballuar me Sukses Luftën Kundër Drogës dhe Trafiqeve të Tjera”, Tiranë, 28.04.2009

Interceptimi i ligjshëm i telekomunikimeve është procesi i lejuar me ligj sipas të cilit një operator i një rrjeti komunikimesh ose një ofrues shërbimesh të tilla i lejon IZL dhe SIS aksesin ndaj komunikimeve (telefonata, mesazhe, e-maile etj.) private të individëve ose organizatave, me qëllim kuptimin e përmbajtjes së tyre. Në ditët e sotme interceptimet e kryera nga IZL dhe SIS janë të domosdoshme për marrjen e informacionit dhe hetimin kryesisht mbi aktivitetet kriminale dhe terroriste. Këto organizata nuk mund të realizojnë aktivitetin e tyre, që gjithnjë e më tepër është bërë i natyrës

transnacionale, pa komunikuar. Kjo përbën një nga pikat më të dobëta të tyre dhe i jep IZL dhe SIS mundësinë e shfrytëzimit të kësaj dobësie për të mbledhur informacion gjatë kohës së planifikimit të aktiviteteve kriminale.

Informacioni i saktë krijon mundësinë që operacionet të jenë më mirë të planifikuara, duke rritur kështu mundësitë e suksesit të tyre. Në Shqipëri interceptimi i komunikimeve ka qenë një praktikë e përdorur edhe më parë nga IZL dhe SIS, por me miratimin e ligjit për përgjimin e telekomunikimeve në vitin 2003⁴³, kjo praktikë u vendos për herë të parë mbi baza ligjore. Krijimi i një kuadri të tillë ligjor lidhet si me nevojën për përmirësimin e kapaciteteve interceptuese, që erdhi kryesisht si pasojë e revolucionit në fushën e teknologjive të komunikimit, ashtu edhe me rritjen e ndjeshmërisë ndaj respektimit të lirive dhe të drejtave themelore të njeriut. Interceptimi i telekomunikimeve ka dhënë një kontribut të rëndësishëm në rritjen e efektshmërisë së punës së SIS dhe IZL. Rezultatet e arritura vitet e fundit në fushën e zbulimit dhe parandalimit të kriminalitetit janë tregues për të vlerësuar rolin e interceptimit të telekomunikimeve.

III. Interceptimi dhe të drejtat e njeriut

Interceptimi i telekomunikimeve nga vetë natyra është një veprimtari tepër ndërhyrëse, çka ngre edhe shtetësime që lidhen me respektimin e të drejtave themelore të njeriut.

E drejta ligjore për respektin ndaj jetës private dhe familjare është sanksionuar në Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut⁴⁴ (KEDNJ), ratifikuar nga Republika e Shqipërisë në vitin 1996, të cilës i referohet dhe Kushtetuta e vendit. Respektimit të të drejtave themelore të njeriut gjatë procesit

⁴³ Ligji nr. 9157, datë 4.12.2003, "Për Përgjimin e Telekomunikimeve".

⁴⁴ "Konventa Europiane të të Drejtave të Njeriut". Fletorja Zyrtare e Republikës së Shqipërisë, numër extra 29, datë 7 maj 2008.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut

Neni 8

E drejta për respektimin e jetës private dhe familjare

1. Çdokush ka të drejtën e respektimit të jetës së tij private dhe familjare, banesës dhe korrespondencës së tij.
2. Autoriteti publik nuk mund të ndërhyjë në ushtrimin e kësaj të drejte, përveçse në shkallën e parashikuar nga ligji dhe kur është e nevojshme në një shoqëri demokratike, në interes të sigurisë publike, për mbrojtjen e rendit publik, shëndetit ose moralit, ose për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të të tjerëve.

Kushtetuta e Shqipërisë

Neni 15

1. Të drejtat dhe liritë themelore të njeriut janë të pandashme, të patjetërsueshme e të padhunueshme dhe qëndrojnë në themel të të gjithë rendit juridik.
2. Organet e pushtetit publik, në përmbushje të detyrave të tyre, duhet të respektojnë të drejtat dhe liritë themelore të njeriut, si dhe të kontribuojnë në realizimin e tyre.

Neni 17

1. Kufizime të të drejtave dhe lirive të parashikuara në këtë Kushtetutë mund të vendosen vetëm me ligj për një interes publik ose për mbrojtjen e të drejtave të të tjerëve. Kufizimi duhet të jetë në përpjesëtim me gjendjen që e ka diktuar atë.
2. Këto kufizime nuk mund të cenojnë thelbin e lirive dhe të të drejtave dhe në asnjë rast nuk mund të tejkalojnë kufizimet e parashikuara në Konventën Europiane për të Drejtat e Njeriut.

të interceptimit të telekomunikimeve i mëshohet gjithashtu edhe në rezoluta dhe direktiva të Bashkimit European⁴⁵.

Vetë miratimi i një ligji për përgjimin e telekomunikimeve buron nga kërkesat e parashtruara nga neni tetë i KEDNJ dhe neni shtatëmbëdhjetë i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, të cilët përcaktojnë se cenimi i të drejtave

⁴⁵ Rezoluta e Këshillit të BE-së për interceptimin e telekomunikimeve e datës 17 janar 1995; Rezoluta e Këshillit të BE-së për nevojat operacionale të zbatimit të ligjit në lidhje me rrjetet e telekomunikimeve dhe shërbimeve e datës 4 nëntor 1996; Direktiva 97/66/EC; Direktiva 2002/58/EC; Direktiva 95/46/EC.

themelore mund të lejohet vetëm kur kjo përcaktohet me ligj. Kërkesa të këtyre dokumenteve themelore janë reflektuar në nenin katër të ligjit për përgjimin e telekomunikimeve, i cili përcakton si parime themelore respektimin e lirive dhe të drejtave themelore të njeriut, nevojshmërinë, proporcionalitetin, sekretin dhe objektivitetin.

Por a është kjo bazë ligjore e mjaftueshme për të lejuar krijimin e masave mbrojtëse të fuqishme dhe efikase, të cilat duhet të garantojnë si rritjen e efektivitetin të punës së IZL dhe SIS ashtu edhe mbrojtjen e plotë të të drejtave të njeriut? A ekzistojnë dhe në ç'masë funksionojnë mekanizmat e kontrollit të brendshëm dhe ekzekutivit, mbikëqyrja nga parlamenti dhe gjyqësori i procesit të përgjimeve?

IV. Ligji për përgjimin e telekomunikimeve

Ligji për përgjimin e telekomunikimeve (LPT) përmban pesë pjesë. Pjesa e parë, dispozitat e përgjithshme, përcaktojnë objektin, qëllimin, përkufizime të termave të përdorur në ligj, parimet nga të cilat duhet të udhëhiqet kryerja e procesit të përgjimeve dhe përdorshmëria e rezultateve të përgjimit.

Pjesa e dytë, procedurat për kryerjen e përgjimit, specifikon institucionet që kanë të drejtë të kërkojnë për të kryer përgjime; kërkesat që duhet të plotësojë aplikimi për përgjim; autoritetin që merr vendimin për kryerjen e përgjimit, ku përcaktohet edhe afati i përgjimit; kërkesat dhe mënyrën për zgjatjen e afatit të përgjimit, për ndryshimin e pajisjeve nën përgjim dhe për revokimin e vendimit për përgjim; përgjimet për situata emergjente; njohjen me rezultatet e përgjimit; kufizimet në përgjim, të cilat kryesisht lidhen me ruajtjen e sekretit; përcaktohet sektori i përgjimeve në SHISH si institucioni, i cili kryen përgjimin.

Pjesa e tretë specifikon kërkesa të veçanta që lidhen me përgjimin si: kryerja e përgjimeve me kërkesë të shërbimeve të huaja; dhe kërkesat për ruajtjen, kopjimin dhe asgjësimin e materialeve të përgjimit.

Pjesa e katërt përcakton detyrimet e operatorëve të telekomunikimeve për të krijuar kapacitetet dhe lehtësitë për

Praktikat më të mira në autorizimin e kompetencave të veçanta për shërbimet informative dhe të sigurisë

✓ Çdo kompetencë e veçantë e shërbimeve informative dhe të sigurisë duhet të bazohet në ligj.

✓ Ligji duhet të jetë i qartë, specifik dhe i plotë në mënyrë që të mos ketë asnjë shtysë që agjencia t'u drejtohet mënyrave më pak të rregulluara.

✓ Parimi i proporcionalitetit duhet të fiksohet në legjislacionin që rregullon përdorimin dhe mbikëqyrjen e kompetencave të veçanta.

✓ Duhet të ketë kontrole kundër keqpërdorimit të kompetencave të veçanta nga persona jashtë shërbimeve, si përpara ashtu edhe pas përdorimit të këtyre kompetencave.

✓ Të gjitha veprimet e ndërmarra nga shërbimet informative dhe të sigurisë për të luftuar terrorizmin duhet të respektojnë të drejtat themelore të njeriut dhe parimin e sundimit të ligjit, si garantohet nga KEDNJ dhe Konventa Ndërkombëtare për të drejtat civile dhe politike.

✓ Me qëllim mbrojtjen nga përdorimi arbitrar i kompetencave të veçanta dhe shkeljet e të drejtave të njeriut, veprimet e shërbimeve informative dhe sigurisë duhet t'i nënshtrohen mbikëqyrjes dhe kontrollit të duhur.

Burimi: H. Born & I. Leigh, Making Intelligence Accountable: Legal Standarts and Best Practices for Oversight of Intelligence Agencies. (f. 42)

të mundësuar përgjimin edhe në rrethana kur përgjimi nuk mund të realizohet nëpërmjet sistemit të përgjimit.

Pjesa e pestë specifikon mënyrën e kryerjes së përgjimeve me vendim gjyqate, në bazë të Kodit të Procedurës Penale; ngarkon Prokurorin e Përgjithshëm, Drejtorin e SHISH dhe, me ndryshimet e ligjit, edhe ministrin e Brendshëm me nxjerrjen e akteve nënligjore për mënyrën e detajuar të

realizimit të proceseve të përgjimit, rregullat për ruajtjen e sekretit, ruajtjen e materialeve të përgjimit dhe asgjësimit të tyre.

V. Autoriteti miratues i vendimeve të përgjimit

Çështje të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut për privatësinë

Në një sërë çështjesh të shqyrtuara sipas nenit 8 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, Gjykata Europiane e të Drejtave të Njeriut ka shprehur nevojën për bazë ligjore të qartë për dhënien e kompetencave të veçanta si: përgjimi i telefonave, i komunikimeve dhe vendosja e përgjuesve. Për më tepër, për dhënien e këtyre kompetencave Gjykata ka përdorur Testin e “Cilësisë së Ligjit”, i cili i mëshon qartësisë, parashikueshmërisë dhe aksesit ndaj legjislacionit. Një kuadër ligjor për përgjimet konsiderohet se nuk e kaluar këtë test kur nuk tregojn me qartësi të arsyeshme masën e lirisë së veprimit që u akordohet autoriteteve, veçanërisht në lidhje me atë se telefoni i kujt mund të përgjohet, për cilat kundravajtje ligjore dhe për sa kohë dhe që nuk kanë trajtuar asgjësimin e transkripteve dhe regjistrimeve. Po kështu komunikimet e privileguara midis avokatëve dhe klientëve të tyre kërkojnë mbrojtje më të mirë ndaj përgjimit sesa delegimi i një kompetence të tillë një zyrtari të ulët.

Çështjet: Khan kundër Mbretërisë së Bashkuar, 12 maj 2000, GJEDNJ (2000); JH kundër Mbretërisë së Bashkuar, GJEDNJ, 25 shtator 2001, Leander kundër Suedisë (1987) 9 GJEDNJ. 433.

Burimi: H. Born & I. Leigh, Making Intelligence Accountable: Legal Standards and Best Practices for Oversight of Intelligence Agencies. (f. 41)

Vendimet për përgjim janë dy llojesh: (1) vendime që miratohen nga Prokurori i Përgjithshëm për të mbështetur veprimtarinë informativo-gjurmuese të IZL dhe SIS: (2)

vendime që miratohen nga gjykata për të kryer përgjime në përputhje me nenet 221 deri 226 të Kodit të Procedurës Penale. Ligji përcakton Prokurorin e Përgjithshëm ose një prokuror të autorizuar prej tij për të marrë vendimin për përgjim.

Kërkesa për përgjim

Të drejtën e kërkesës për përgjim e kanë Shërbimi Informativ Shtetëror, shërbimet informative/police të Ministrisë së Brendshme dhe të Ministrisë së Mbrojtjes, si dhe çdo shërbim tjetër informativ / policor i krijuar me ligj.

Kërkesa duhet të përmbajë arsyet e kërkesës, të cilat duhet të justifikojnë se përgjimi është i “nevojshëm” për zbulimin e një veprimtarie antikushtetuese, kriminale ose keqbërëse. Kërkesa duhet të përmbajë gjithashtu dhe arsyet përse informacioni, i cili synohet të merret nëpërmjet përgjimit, nuk mund të sigurohet me mjete të tjera.

Kohëzgjatja, zgjatja dhe ndërprerja e vendimeve për përgjim

Kohëzgjatja e një vendimi fillestar për përgjim të miratuar nga Prokurori i Përgjithshëm nuk mund të jetë më e madhe se tre muaj. Këto vendime mund të zgjaten nëse përsëritet kërkesa dhe miratohet, por përsëri periudha nuk mund të jetë më e gjatë se tre muaj. Vendimet e miratuara nga gjykatat kanë një afat fillestar prej 15 ditësh dhe mund të zgjaten pas këtij afati për një periudhë 20-ditore të përsëritshme. Për krimet e rënda ky afat është 40 ditë. Në të dy rastet vendimi mund të ndërpritet nëse nuk konsiderohet më i nevojshëm.

Realizimi i përgjimit

Ligji përcakton krijimin e një sektori të përgjimeve në SHISH si institucioni, i cili kryen përgjimin.

Me ndryshimet e bëra nga parlamenti në ligjin për përgjimet, në mars të vitit 2008⁴⁶, e drejta e përgjimit nëpërmjet seksionit të tyre të përgjimeve, të atashuar në sektorin e përgjimeve në SHISH i jepet dhe Policisë së Shtetit dhe të Shërbimit të

⁴⁶ Ligji nr. 9885, datë 3.3.2008, “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr.9157, datë 4.12.2003 “Për Përgjimin e Telekomunikimeve”.

Testi i “Cilësisë së ligjit”

Konventa Europiane të të Drejtave të Njeriut përcakton se në një shoqëri demokratike e drejta e privatësisë, liria e mendimit dhe besimit si dhe liria e shprehjes dhe e mbledhjes dhe organizimit mund të kufizohen për interesa të sigurisë kombëtare dhe rendit publik. Megjithatë Konventa parashtron se këto kufizime duhet të kryhen “konform ligjit”. Precedentët gjyqësorë të Gjykatës Europiane të të Drejtave të Njeriut të kthyer në ligj parashtrajnë midis të tjerave se shërbimet informative dhe të sigurisë mund të ushtrojnë kompetencat e veçanta vetëm në qoftë se ato rregullohen me ligj. Në këtë kuadër, sipas Gjykatës:

- o Që të cilësohet si ligj, një normë duhet të jetë e arritshme dhe e formuluar me saktësinë e nevojshme për të mundësuar që qytetarët të rregullojnë sjelljen e tyre (Sunday Times kundër Mbretërisë së Bashkuar, 26 prill 1979, 2 GJEDNJ 245, paragrafi 47)

- o Një ligj, i cili “lejon ushtrimin e gjykimit të pakufizuar në raste konkrete nuk do të ketë cilësitë themelore të parashikueshmërisë dhe si i tillë nuk do të jetë një ligj i vlefshëm për këtë qëllim” (Silver dhe Others kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 mars 1983, 5 GJEDNJ 245, paragrafi 85)

- o Duhet të krijohen kontrolle dhe garanci të tjera për të parandaluar keqpërdorimin e pushtetit nga shërbimet informative nëse kërkohet të ketë përputhje me të drejtat themelore të njeriut. Masat mbrojtëse duhet të ekzistojnë kundër abuzimit me ligjin. (Silver dhe Others kundër Mbretërisë së Bashkuar, 25 mars 1983, 5 GJEDNJ 245, paragrafi 88-89)

- o Për aq kohë sa që këto masa mbrojtëse nuk janë të shkruara në vetë ligjin, ligji duhet të krijojë kushtet dhe procedurat për ndërhyrje në të. (Klass kundër Republikës Federale Gjermane, No. 5029/71, Raport i 9 marsit 1977, paragrafi 63. Kruslin kundër Francës, 24 prill 1990. A/176-A, paragrafi 35, Huving kundër Francës, 24 prill 1990, A/176-B paragrafi 34)

Burimi: H. Born & I. Leigh, Making Intelligence Accountable: Legal Standarts and Best Practices for Oversight of Intelligence Agencies. (f. 21)

Kontrollit të Brendshëm në Ministrinë e Brendshme. Gjithashtu ndryshimet ligjore lejojnë Prokurorinë e Përgjithshme që të ndërtojë kapacitete teknike përgjimi në mjediset e veta për realizimin e përgjimeve për nevoja të hetimeve paraprake, sipas procedurave të përcaktuara në Kodin e Procedurës Penale.

Masat e mbrojtëse ndaj abuzimeve dhe kontrolli i ekzekutivit

Ligji parashikon masa kufizuese për sa i përket; përgjimit pa autorizim ose jashtë procedurave; ndalimit të përdorimit si provë për të ngritura akuza; aksesit ndaj materialeve të përgjuara; përhapjes dhe përdorimit të dhënave grumbulluara nga përgjimi.

Ligji nuk përmban ndonjë klauzolë për mënyrën se si këto masa kontrollohen nga ekzekutivi.

Monitorimi nga legjislativi

Ligji nuk përmban ndonjë klauzolë që rregullon kontrollin e procesit të përgjimeve nga legjislativi.

Monitorimi nga gjyqësori

Ligji nuk përmban ndonjë klauzolë që rregullon kontrollin e procesit të përgjimeve nga gjyqësori.

V. Konkluzion

Legjislacioni dhe procedurat që rregullojnë aktivitetin e përgjimit të telekomunikimeve duhet të ndërtohen në mënyrë të tillë që jo vetëm të rrisin efektivitetin e punës së institucioneve shtetërore informative, por të ndërtojnë edhe mekanizmat e përgjegjësisë dhe llogaridhënies. Parimisht, në një demokraci liberale këto institucione duhet të jenë të përgjegjshme ndaj Ekzekutivit, Legjislativit dhe Gjyqësorit. Legjislacioni duhet të kujdeset që të ndërtojë një sistem, i cili garanton mbikëqyrjen nga organizmat përkatës, të cilët duhet të jenë në gjendje të përcaktojnë nëse institucionet e ngarkuara me përgjimin e telekomunikimeve përmbushin misionin e tyre apo abuzojnë me të.

IVANA TOMOVSKA

REFORMA E SEKTORIT TË SIGURISË NË MAQEDONI: NJË PËRQASJE (JO) HOLISTIKE?

1. Hyrje

Koncepti i Reformës në Sektorin e Sigurisë (RSS) bazohet në idenë se siguria dhe zhvillimi i një vendi janë të ndërthurura. RSS po ndryshon axhendat e aktorëve shtetërorë dhe jo shtetërorë pasi po krijon një lidhje midis sigurisë dhe qëndrueshmërisë. Koncepti i sigurisë është zgjeruar për t'iu përgjigjur sfidave të reja të krijuara nga globalizimi dhe ndryshimet në sistemet politike dhe në kulturën politike të disa vendeve. Ambienti i pas Luftës së Ftohtë, mund të konsiderohet si një rilindje e studimeve të sigurisë duke marrë një përjasje më humaniste. Në këtë kuadër, reforma në sektorin e sigurisë merr një përjasje gjithëpërfshirëse ose holistike duke përfshirë aktorë të ndryshëm dhe nevojat e tyre për të qenë të suksesshëm dhe jetëgjatë.⁴⁷ RSS përfaqëson edhe bazat për çështje të tjera shtetërore, si për shembull: reduktimi i varfërisë, zhvillimi ekonomik i qëndrueshëm si dhe zhvillimi social dhe politik i një vendi.

⁴⁷ Law, David (2006) "Post Conflict Security Sector Geneva Center for Democratic Control of Armed Forces (DCAF), Policy Paper No. 14. "Njëri ka të bëjë me përjasjen gjithëpërfshirëse të sektorit të sigurisë, duke marrë në konsideratë aktorët kryesorë të sektorit të sigurisë dhe funksionet e tyre: përkatësisht, të gjitha institucionet, që mund të përdorin forcën, statute ose jo, autoritetet e përfshira në menaxhimin e tyre, parlamenti dhe autoritetet gjyqësore që i kontrollojnë dhe organizatat e shoqërisë civile që monitorojnë, bëjnë kërkime, publicitet dhe shpërndajnë idetë rreth sektorit të sigurisë."

Çështja kryesore që ky artikull do të analizojë është: A mundet që reforma në sektorin e sigurisë në Maqedoni të jetë e qëndrueshme pa një përjasje gjithëpërfshirëse? Metafora udhëheqëse e titullit “Përjasje (Jo)holistike” vë në dukje faktin se edhe pse debati në Maqedoni propagandon një përjasje holistike në RSS, praktikisht shumë elementë themelorë neglizhohen ose lihen pas dore në reformat e tyre. Për të analizuar këtë çështje pesë elementë kryesorë do merren në konsideratë: reforma e kapaciteteve ushtarake dhe të forcave policore, aspektet e sigurisë njerëzore, kontrolli demokratik, stabiliteti rajonal dhe perceptimi i opinionit publik.

Artikulli fillon me një historik të shkurtër mbi kuptimin e sigurisë në ish-Jugosllavi dhe në periudhën pas pavarësisë së Maqedonisë. Pjesa e parë do të paraqesë gjithashtu influencën e aktorëve të komunitetit ndërkombëtar në formësimin e sektorit të sigurisë në Maqedoni, veçanërisht gjatë dy momenteve shumë të rëndësishme: kriza e Kosovës në 1999 dhe konflikti i armatosur në 2001. Kuadri teorik i përdorur në këtë analizë do të jetë konstruktivizmi social; kjo përjasje teorike është e përshtatshme sepse shpjegon krijimin e normave në kuadrin e proceseve sociale. Në këtë analizë është e rëndësishme për t’u parë krijimi i normave gjatë reformave në sektorin e sigurisë në Maqedoni në periudhën e mbas konfliktit.

Pjesa e fundit e këtij artikulli hedh një vështrim të përgjithshëm mbi perceptimin e publikut mbi sektorin e sigurisë në Maqedoni; RSS te publiku i gjerë shihet në lidhje me integrimin në NATO dhe në njëfarë pike me transformimin e ushtrisë dhe policisë. Prandaj, kjo pjesë analizon mbështetjen e publikut për NATO-n gjatë dhjetë viteve të fundit. Konkluzioni vë në dukje nivelin në të cilin komponentë të ndryshëm të RSS-së janë zhvilluar në Maqedoni dhe konfirmon hipotezën se nëse nuk preken të gjithë elementët nuk do të ketë baza për një zhvillim të qëndrueshëm në vend.

2. Të kuptojmë sigurinë në ish-Jugosllavi dhe periudhën pas pavarësisë

2.1 Historik

Republika e Maqedonisë filloi të themelojë sistemin e saj të sigurisë në shtator 1991 me daljen nga Federata Socialiste e Republikave të Jugosllavisë. Procesi i krijimit të sektorit të sigurisë (SS) nuk ishte një detyrë e lehtë dhe Maqedonia po përballlej me probleme të SS-së në një shtet të ri të shkatërruar nga konflikti.⁴⁸ Veç kësaj, Maqedonia trashëgoi institucionet e SS-së nga ish-Jugosllavia komuniste dhe konceptin e sigurisë të kultivuar në këto institucione. Kushtetuta e nëntorit të 1991-shit hodhi bazat e një shteti sovran, demokratik dhe përfaqësoi bazat për të ndërtuar SS-në. Një nga ligjet e para të adoptuara nga Asambleja e re ishte Ligji për Mbrojtjen i vitit 1992.⁴⁹ Në mars 1992 Presidenti i parë i Maqedonisë, z. Kiro Gligorov, nënshkroi një marrëveshje me Ushtrinë Kombëtare Jugosllave (UKJ) për tërheqjen e forcave të UKJ-së nga territori i Republikës së Maqedonisë (RM). Ushtri i fundit i UKJ-së u largua nga Maqedonia në mars 1992, dhe në prill filloi formimi i Forcave të Armatosura Maqedonase.

Rrethanat në të cilat Maqedonia shpalli pavarësinë ndryshon në krahasim me ish-Republikat e tjera Jugosllave: u shmangën luftërat dhe gjakderdhja, megjithatë dalja nga federata dhe socializmi la një boshllëk dhe aparat shtetëror të paqartë. Në këto kushte, një vendim u mor për të përdorur ligjet ekzistuese, rregullat dhe aktet (p.sh. Rregullat nga Republika Socialiste e Maqedonisë) derisa të adoptoheshin ligjet dhe rregullat e reja.

⁴⁸ Në realitet, edhe pse Maqedonia nuk mori pjesë në luftërat e ish-Jugosllavisë, mund të thuhet se ambienti i përgjithshëm në momentin e shpërbërjes së Jugosllavisë e la Maqedoninë pa një SS eficient. Gjithashtu, dhjetë vjet më vonë, në 2001, SS i Maqedonisë u trondit sërisht seriozisht nga sfidat e turbullirave politike dhe krizës së armatosur.

⁴⁹ Ligji mbi Mbrojtjen. Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë, shkurt 1992.

Shteti i ri i brishtë me një aparat shtetëror jo efektiv, nën kushtet e ndikimeve të shumta të jashtme, një ambient të pafavorshëm sigurie në terma socialë, ekonomikë dhe zhvillime ndëretnike nuk gjeti rrugën e tij për përpilimin e dokumenteve themelore të SS-së. Nëse shihet kuadri ligjor i sigurisë kombëtare, ekziston vetëm një dokument mbi të cilin vendimet strategjike mund të përpilohen, Strategjia Kombëtare e Republikës së Maqedonisë. Strategjia e Mbrojtjes nuk i parapriu konflikteve të armatosura të brendshme dhe marrëdhënieve ndëretnike si një kërcënim i mundshëm i stabilitetit të përgjithshëm të SS-së.

Në dekadën e parë të pavarësisë ka pasur dy ngjarje të rëndësishme që influencuan formimin e SS-së: kriza e Kosovës në 1999 dhe konflikti i armatosur i vitit 2001. Një çerek milioni refugjatësh nga Kosova vajtën në Maqedoni, duke e rënduar ekonominë e brishtë të vendit dhe duke krijuar një disbalancë në sektorin e sigurisë. Kriza dhe ngjarjet e vitit 2001 përfaqësuan një kërcënim të prekshëm për ushtrinë, si dhe për sektorin politik dhe shoqëror të sektorit të sigurisë. Mund të argumentohet që një vend nuk mund të fillojë reformat në sektorin e sigurisë në një ambient të rrezikshëm ose në mes të një krize kombëtare duke u përballur me kërcënime të prekshme mbi sigurinë në sektorë të shumtë. Nga ana tjetër, kush është momenti më i mirë për Maqedoninë të fillojë RSS? Stimuli për të filluar këtë proces u dha nga komuniteti ndërkombëtar dhe strukturat Euro-Atlantike.

2.1.1 Impakti i komunitetit ndërkombëtar në formimin e sektorit të sigurisë

Qëllimi i vendit për t'u anëtarësuar në NATO dhe BE u theksuan që në fillimet e pavarësisë së tij. Proceset integruese influencuan fuqishëm sektorin e sigurisë dhe u zhvilluan në përputhje me prirjen e strukturave Euro-Atlantike. Brenda kuadrit ligjor, pjesa më e madhe e dokumenteve të fushës së sigurisë u përcaktua dhe krijua mbi vlerat demokratike në përputhje me NATO-n dhe proceset integruese të BE-së.

Është interesante të vihet në dukje fakti që vendi, i cili përjetoi një krizë serioze më 2001, po zhvillohej me një ritëm shumë të shpejtë, përkatësisht në prill 2001 Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit u nënshkrua dhe në dhjetor 2005 Maqedonia mori statusin e vendit kandidat. Nxitja ndërkombëtare pa dyshim duke përfshirë dhe fuqinë soft dhe hard për të bërë marrëveshje patën një impakt shumë të madh në zhvillimin e Maqedonisë.

Gjithashtu, mund të argumentohet se Maqedonia u mundua të përdori përfshirjen e NATO-s në rajon për të reformuar SS-në dhe për të përmirësuar operacionalitetin e Ushtrisë për nevojat e përfshirjes së mëtejshme në operacione paqeruajtëse. Anëtarët e ushtrisë po merrnin pjesë aktivisht në të gjitha aktivitetet koordinuese të NATO-s duke kontribuar në misionet të huaja dhe duke përfutur një përvijë të vyer. Misionet më të rëndësishme ndërkombëtare në Maqedoni të lidhura me RSS ishin Allied Harmony, Concordia dhe misioni policor i BE-së PROXIMA. Këto misione kishin për detyrë të lehtësonin reformën e forcave ushtarake nën kuadrin e kushteve të integritetit Euro-Atlantik të përcaktuar nga MSA-ja. Me përfundimin e Allied Harmony, roli i NATO-s në Maqedoni u bë këshillues. Maqedonia dha prova që ishte një nxënës i mirë kur bëhej fjalë për integrimin në NATO, megjithatë rezultati negativ i Samitit të Bukureshtit në prill 2008 i bëri përpjekjet për RSS të padobishme dhe të paplotësuar.⁵⁰

3. RSS në Maqedoni – Elemente dhe Konsiderata

3.1 Konstruktivizmi social dhe Normat e Tranzicionit

Zgjerimi i konceptit të sigurisë ka ecur paralel me procesin e ndryshimit të normave gjatë tranzicionit, si dhe është ndikuar nga pasojat imponuese të axhendës së sigurisë të aktorëve të rëndësishëm ndërkombëtarë. Teoria e sigurisë është një teori për kërkimin e një objekti referues, “*Siguria në këtë mënyrë*

⁵⁰ Maqedonia nuk mori ftesën e shumëpritur për t’iu bashkuar NATO-s në Samitin e Bukureshtit së bashku me Shqipërinë dhe Kroacinë.

mund të shihet si një version më ekstrem i politizimit".⁵¹ Përveç "sigurisë së kujt" (ose objektit të referimit), siguria ka të bëjë edhe me dy pyetje të tjera "siguria e çfarë" (cilat janë vlerat e rrezikuara) dhe "siguria nga kush dhe çfarë" (cilat janë burimet e kërcënimeve).⁵² Duke e parë nga prizmi i Konstruktivizmit social, sektori i sigurisë dhe reforma e tij do të influencohet së tepërmi nga ambienti përreth tij si dhe nga faktorët socio-ekonomik. Përfaqja konstruktiviste vë theksin te roli dhe funksioni i faktorëve social dhe influencën e praktikave sociale për të kuptuar politikën botërore.⁵³ Gjithashtu, kjo përfaqje vë theksin te krijimi i normave në kuadrin e proceseve sociale, nga kjo pikëpamje mund të analizohet konflikti midis normave të ndryshme të formuara në nivel kombëtar si dhe të llojit të normës – "rezonancën e normave të brendshme".⁵⁴ Siguria personale dhe publike përbën problemin e përbërësve objektivë dhe subjektivë mbi sigurinë në nivel social dhe individual, si dhe ndërveprimin reciprok të tyre. Ndjenja individuale e sigurisë është një reflektim i perceptimeve individuale. Duhet analizuar karakteri i dyfishtë i sigurisë, dmth shteti si një objekt referues (siguria kombëtare) dhe qytetarët si përdorues të sigurisë. Një nga pyetjet më komplekse ndërkohë që krijohet një "axhendë e përbashkët" është për të përcaktuar prioritetet e objektit referues (shteti ose individi ose e anasjellta).⁵⁵

⁵¹ Buzan, Barry et al. (1998) Siguria: Një kuadër i ri për t'u analizuar, Lynne Rienner, London, fq. 23.

⁵² Møller, Bjorn, (2000) Siguria kombëtare, shoqërore dhe njerëzore: Diskutim i përgjithshëm me një rast studimor nga Ballkani, në: UNESCO (eds.), Çfarë axhende për sigurinë njerëzore në shekullin e njëzetënjët?, Proceed-ings of the First International Meeting of Directors of Peace Research and Training Institutions, 27-28 November, Paris, pp. 41-62.


⁵³ Georgieva, Lidija (2006) "Siguria dhe rreziqet për Reformat në Maqedoni dhe procesi i integritet të sigurisë" në Bakreski, Oliver et al. (eds) Perspektivat e Republikës së Maqedonisë në rrugën e NATO-s dhe BE-së. Ministria e Mbrojtjes e RM, Ohrid: Kosta Abrash. fq. 141-149.

⁵⁴ Winer, A. Constructivism: Limitet për të përmbushur boshllëqet, Revista e Marrëdhënieve Ndërkombëtare & Zhvillimit (shtator 2003, fq. 252). Siguria - mungesë kërcënimesh për të ngritur vlera thelbësore (fq. 145).

⁵⁵ Georgieva, Lidija (2006) "Siguria dhe rreziqet për RM dhe procesi i integritet të sigurisë", fq. 149.

Në lidhje me “rezonancën e normës së brendshme”, RSS si kudo ashtu dhe në Maqedoni, priret të drejtohet nga aktorët e jashtëm.⁵⁶ Nëse analizohen kush janë faktorët më prezent në Maqedoni, do të kuptohet se çfarë normash të tranzicionit kanë ndodhur në RSS në vend. Duke patur parasysh që NATO, OSBE dhe BE kanë qenë aktorët më prezentë, mund të shihet se RSS në vend është fokusuar në “Ngritje kapacitetesh dhe asistencë teknike”.⁵⁷ Në mënyrë që të bëhet një vlerësim i plotë i progresit të RSS-së duhen marrë në konsideratë pesë elementë: reforma e kapaciteteve ushtarake dhe forcave policore, aspektet e sigurisë njerëzore, kontrolli demokratik, stabiliteti rajonal, dhe perceptimi i opinionit publik. Për të pasur një RSS të suksesshme dhe të qëndrueshme kërkesat e të pesë sektorëve duhen përmbushur. Figura 1 përshkruan elementët sektorit të sigurisë që do të merren parasysh.⁵⁸

Fig. 1 Elementë të Reformës së Sektorit të Sigurisë



⁵⁶ Law, David (2006) “Përfaqset ndërqeveritare ndaj Reformës në Sektorin e Sigurisë (SSR)”, Geneva Center for Democratic Control of Armed Forces (DCAF), www.dcaf.org.

⁵⁷ Ibid. fq. 5.

⁵⁸ Shih: “Përse një sektor sigurie funksional është shumë i rëndësishëm”, David Law – Prezantim në Shkollën verore për Sigurinë në Durrës, Shqipëri, shtator 2008. Pesë elementet në Figurën 1 përputhen me pesë elementet që analizohen në këtë artikull.

3.2 Kapacitetet Ushtarake dhe Forcat Policore – Roli i Ministrisë së Brendshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes

Procesi i ristrukturimit dhe harmonizimit të Forcave të Armatosura Maqedonase (FAM) filloi jo shumë kohë para fillimit të krizës së vitit 2001. Ligji mbi Mbrojtjen⁵⁹ dhe Ligji mbi Shërbimin në Forcat e Armatosura⁶⁰ ishin në proces formimi. Në atë kohë nuk kishte ndonjë koordinim të plotë midis elementëve “të vjetër” (socialist-federativ) dhe “të rinj” dhe funksionimit të tyre. Mungesat më të dukshme gjatë krizës ishin mungesa e pajisjeve të FAM me teknologji moderne ushtarake. Një pjesë e teknologjisë ishte blerë në mes të krizës dhe pati një impakt të konsiderueshëm në buxhetin e shtetit në atë kohë. Një faktor tjetër që ndikoi në ristrukturimin e ushtrisë Maqedonase ishte prezenca e Burimeve Profesionale Ushtarake INC, një shoqëri private ushtarake Amerikane. Më pas, në 2002/2003 një tjetër firmë konsulence amerikane “Booz Allen Hamilton” mori rolin e konsulentit në fusha specifike në mënyrë që Ministria e Mbrojtjes dhe FAM të përmbushnin kërkesat për t’u integruar në NATO. Disa nga këto fusha përfshinin trajnimin e personelit, logjistikë, planifikim, programim dhe buxhetim.⁶¹

Rezultatet pozitive dhe eksperiencat e këtyre trajnimeve dhe ristrukturimi ishte fakti se aspektet e burimeve njerëzore të Ministrisë së Mbrojtjes dhe FAM u përmirësuan së tepërmi. Pjesa e ushtrisë profesionale e përfshirë në misione të huaja⁶² tregoi kapacitete të plota dhe nivel profesional. Në lidhje me forcat aktive të forcave të armatosura në 2004-2005 Ushtria

⁵⁹ Gazeta Zyrtare mbi Ligjet dhe Mbrojtjen në Republikën e Maqedonisë, no. 08/1992, no. 42/2001.

⁶⁰ Ligji te Gazeta Zyrtare mbi Shërbimin në Forcat e Armatosura në Republikën e Maqedonisë no. 62/2002.

⁶¹ Stephans, Fred (2003) “Booz Allen Hamilton” në Maqedoni në NATO, Grujovski, Marjan et al (eds.) Ministry of Defense of RM, Forumprint: Kumanovo, pp. 153-157.

⁶² Ushtarët maqedonas prezentë në Afganistan dhe Irak.

arriti 0,4 për qind të popullsisë në forcat e armatosura, e cila ka pjesën më të gjerë të vendeve anëtare të NATO-s.⁶³ Për sa i përket përgjegjësi që rrjedhin nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, në lidhje me sektorin e drejtësisë dhe punët e brendshme (që prej prillit 2001) reforma të gjera po zhvillohen në sektorin e policisë. Komisioni European duke punuar së bashku me një grup nga Ministria e Punëve të Brendshme në shtator 2002 krijoi një draft strategji për reformën në sektorin e policisë në Maqedoni.⁶⁴ Strategjia për Reformën në Polici u adoptua nga qeveria në shtator 2003, dhe identifikoi disa objektiva strategjike:

- Eficencë në punën e policisë
- Luftë kundër krimit të organizuar
- Planifikim, zhvillim dhe edukim i vazhdueshëm i personelit
 - Përfaqësim i duhur dhe i barabartë i pjesëtarëve të komuniteteve të ndryshme në Maqedoni
 - Mjete tekniko-teknologjike
 - Funkionim i policisë si shërbim publik⁶⁵

Reformat policore vazhduan nëpërmjet programeve të dyfishta me anëtarë të BE-së (Gjermania) të financuar nga programi CARDS me kohëzgjatje 2 vjet, ndërkohë që Misioni i OSBE-së ka një vokacion të veçantë mbi edukimin e forcave policore.⁶⁶

⁶³ Daskalovski, Sinisha (2006) "Proeckii na Vooruzenite Sili na Repulika Makedonija vo Soglasnost so Nato Standardite" *SovremenaMakedonska Odbrana* (Projeksione në Forcat e Armatosura në RM në përputhje me NATO) *Mbrojtja Maqedonase Bashkëkohore*. Year V, No. 13. December 2006. Ministry of Defense of RM, Ohrid: Kosta Abrash. Pp.119-133.(The International Institute for Strategic Studies, London, UK) *The Military Balance* (<http://www.iiss.org/publications/the-military-balance/>).

⁶⁴ Draft Strategy, shtator 2002 MoI > [ww.moi.gov.mk](http://www.moi.gov.mk)<

⁶⁵ Murgoski, Boris (2006) "Nekoi Aspekti na Reformite vo Policiskiot I vo Edukativniot Sistem na Policijata" *Sovremena Makedonska Odbrana* (Disa aspekte të reformës së policisë dhe Sistemi i Edukimit për Policinë) *Mbrojtja Maqedonase Bashkëkohore*. Viti V, No. 13, dhjetor 2006. Ministria e Mbrojtjes e RM, Ohrid: Kosta Abrash. fq.153-169.

⁶⁶ Ibid.

3.3 Aspekte të Sigurisë Njerëzore

Siguria njerëzore mund të shpjegohet si “Në lidhje me mbijetesën e individëve, ku vdekja mund të vijë në mënyrë të barabartë si nga uria, AIDS, trafiku njerëzor etj., ashtu si mund të vijë nga arma e një ushtari. Për sa i përket zhvillimit njerëzor, cilësia e ulët njerëzore, varfëria ekstreme dhe fatkeqësitë njerëzore janë më keq sesa burgosja e një individi”.⁶⁷ Çështjet e sigurisë njerëzore dhe institucionet e dobëta kanë shumë gjasa të jenë prezentë në vendet e pazhvilluara ekonomikisht. Veç kësaj, siguria njerëzore/pasiguria është një çështje shumë më e rëndësishme në shoqëritë e pasluftës dhe post-konfliktuale. Çështjet e sigurisë njerëzore kanë shumë gjasa të jenë prezentë në vendet e pazhvilluara ekonomikisht si dhe institucione të dobëta.

Gjendja e përgjithshme e sigurisë në Maqedoni duke filluar nga viti 1991 po përballej me një sërë çështjes të lidhura me sigurinë njerëzore, të cilave nuk iu dha rëndësia e nevojshme nga qeveritë e ndryshme në pushtet dhe as nuk u adresuan nga komuniteti ndërkombëtar. Mund të identifikohen tri çështje të sigurisë njerëzore, të cilat çuan në gjendjen e vitit 2001 dhe këto janë: varfëria dhe papunësia, dobësitë e institucioneve, dhe korrupsioni dhe krimi i organizuar.

3.3.1 Varfëria dhe papunësia

Edhe para konfliktit kishte më shumë se 300000 persona të papunë (në një vend prej 2 milion banorësh) dhe gjysma e të punësuarve nuk po merrnin pagat prej disa muajsh. Rritja ekonomike u ul me 10%.⁶⁸ Sipas Raportit të Hershëm Paralajmërues të PNUD, mbasi u pyetën për shqetësimet e

⁶⁷ Tomovska, Ivana (2008) “Maqedonia 2001: Luftëe re apo e vjetër? Ndikimi i organizatave tranznacionale kriminale dhe terroriste mbi Shtetin dhe në shoqërinë Maqedonase” HUMSEC Journal, Issue 2, fq. 91.

⁶⁸ Vankovska, B. (2003) “Tendencat aktuale të gjendjes në Maqedoni. Përpyetje për paqe, demokratizim dhe siguri” Open Society Institute: Shkup p. 19.

tyre qytetarët e Maqedonisë, të të dyja etnive Maqedonase dhe Shqiptare, i radhitën si më poshtë: papunësia (78,8%), varfëria korrupsioni, krimi, problemet etnike (29,5%).⁶⁹ Vetëm një vit pas konfliktit të armatosur, i cili u quajt nga komuniteti ndërkombëtar si politiko-etnik, tre shqetësimet më të mëdha të qytetarëve të Maqedonisë kishin natyrë sociale me shqetësimin etniko-politik në vend të pestë.

3.3.2 Dobësitë e Institucioneve

Sipas një sondazhi të opinionit publik, të cilin e udhëhoqi në korrik 2001 Instituti për Studime Social-Politike dhe Juridike në Shkup, në mes të krizës, faktori kryesor për shfaqjen e konfliktit në Maqedoni ishte paaftësia dhe korrupsioni i qeverisë dhe Parlamentit me 76% e të intervistuarve duke vënë gishtin mbi këto Institucione.⁷⁰ Akoma më i rëndësishëm është fakti se 55% e të intervistuarve besojnë se “politikanët nuk kanë asnjë koncept si të drejtojnë shtetin”.⁷¹ Të gjitha këto rrethana të sipërpërmendura pengojnë procesin e demokratizimit dhe reformën në sektorin e sigurisë. Mungesa e besimit dhe besnikërisë ndaj institucioneve të shtetit dhe administratës publike është një rezultat i drejtpërdrejtë i politizimit të administratës shtetërore. Frckovski argumenton: “Në një shtet multikultural grupet kanë retorika të ndryshme, një administratë neutrale dhe efikase është gjithçka që është e përbashkët”.⁷² Për të dëshmuar dhe fituar besnikërinë, shteti

⁶⁹ Kostovicova, Denisa (2006) “Pasiguria e re dhe e vjetër në Ballkan. Mësime nga përfshirja e BE në Maqedoni“ (pp. 43-70) in Marlies Glasius and Mary Kaldor (eds) Një doktrinë për sigurinë njerëzore në Europë: projekte, principe, praktikalitete Abingdon: Routledge.

⁷⁰ Dauti, Daut and Borjan Jovanovski, Sfidat e Maqedonisë, Për një fillim të ri, në: Brown, Keith S. et al (eds.), Ohri dhe më pas: Një investigim ndëretnik për Krizën Maqedonase, Institute for War & Peace Reporting, London, 2002, pp. 9-18, at p. 11.

⁷¹ Dauti, Daut and Borjan Jovanovski, Sfidat e Maqedonisë, Për një fillim të ri, at p. 11.

⁷² Intervistë me Ljubomir Frckovski, ish-ministër i Punëve të Brendshme, 11 April 2007, Skopje.

duhet të sigurojë këtë administratë neutrale dhe efikase. Në ditët e sotshme, Maqedonia është një shtet me “pasiguri elementare” si argumenton dhe Frckovski – mungesa e shtetit ligjor, mungesa e rregullave elementare, ekonomia etj.⁷³

3.3.3 Korrupsioni dhe krimi i organizuar

Në periudhën e fundit të tranzicionit, korrupsioni është rritur në mënyrë dramatike në Maqedoni dhe në të gjithë rajonin. Vankovska i ndan sferat e influencës të mafies në dy sfera influence: grupet e krimit të organizuar kontrollojnë veriperëndimin dhe perëndimin e vendit, ndërsa grupe të tjera përdorin/shpërdorjnë aparatit shtetëror.⁷⁴ Sipas Transparencës Ndërkombëtare/Transparency International, Maqedonia në 2006 kishte një index korrupsioni 2.7 (në një shkallë 0-10, ku 0 është më e larta).⁷⁵ Vetëm midis 1997 dhe 2000 ka pasur 134 raste korrupsioni kundër punonjësve të qeverisë dhe 567 raste “abuzimi me autoritetin zyrtar”.⁷⁶ Përveç rasteve të abuzimit me pushtetin ka edhe raste ryshfeti, të cilat janë më të shpeshtat në shërbimin shëndetësor dhe në zyrat e administratës vendore, arsimin, dhe doganat.⁷⁷ Gjithashtu, një pyetje që duhet analizuar është nëse futja në axhendën e sigurisë (securitization) të dukurive kriminale ka ndodhur në Maqedoni, me mbështetjen e një analize se kush përfiton nga “securitization” dhe kush përfiton nga gjendja aktuale/ status quo. Në lidhje me pyetjen kush përfiton prej këtij procesi, përgjigjja më e sigurtë ka të bëjë me viktimat potenciale,

⁷³ Intervistë me Ljubomir Frckovski.

⁷⁴ Vankovska, Biljana, Tendencat aktuale të rrethanave në Maqedoni, fq. 16

⁷⁵ Transparency International, Koalicioni global kundër korrupsionit, Indeksi i perceptimit të korrupsionit, 2006. Gjetet online tek: http://www.transparency.org/policy_research/surveys_indices/cpi/2006

⁷⁶ Hislope, Robert, Krimi i organizuar në një shtet të çorganizuar: Si kontribuo korrupsioni në miniluftën Maqedonase, në: Probleme të Postkomunizmit (Volume 49, Number 3), 2002, pp. 33-41, at p. 35.

⁷⁷ Caceva, Violeta, Aktivitetet kriminale gjatë periudhës së tranzicionit në Maqedoni, fq. 34.

qytetarët e thjeshtë dhe ata që përfitojnë nga përfundimi i aktiviteteve kriminale. Reforma në sektorin e sigurisë nuk mund të përfundohet nëse nuk u jepet përgjegje këtyre çështjeve themelore të sigurisë njerëzore. Zhvillimi i përgjithshëm i vendit nuk do të jetë i mundur nëse nuk i jepet një zgjidhje varfërisë, dobësisë së institucioneve, korrupsionit dhe krimit të organizuar.

3.4 Kontrolli demokratik dhe debati publik

Ministria e Mbrojtjes dhe ajo e Brendshme funksionon nën kontrollin e rreptë të civilëve, që është thelbësor për balancën në vendimmarrje dhe menaxhimin e resurseve në saje të transparencës. Fatkeqësisht, mund të argumentohet që nuk ka kulturë të një transparence reale në Sektorin e Sigurisë në Maqedoni dhe një përfshirje aktive e OJQ-ve, akademisë dhe sektorit të biznesit. Si vë në dukje dhe Ivanovski: “Roli i civilëve në strukturat e sigurisë kombëtare është i dyfishtë: në fushën e përcaktimit të politikave (përgjegjësi e pastër e civilëve) dhe implementimin e politikave (punë e përbashkët me profesionistë për të ofruar një ekspertizë optimale dhe të garantojë efikasitetin dhe transparencën).⁷⁸ Një sfidë serioze e rolit të civilëve në SS është procesi i alternimit demokratik të partive politike në pushtet dhe opozitës (ose themelimin e sistemit të kontrollit dhe balancimit). Gjithashtu, problemi i bashkëpunimit midis ushtarakëve dhe civilëve është komplekse dhe delikate sepse ndonjëherë i është atribuar një rol sekondar dhe është parë si më pak i rëndësishëm se disa çështje të tjera.⁷⁹

⁷⁸ Ivanovski, Zoran (2003) “Drejt Integritimit Euro-Atlantik: RSS në RM”, Maqedonia në NATO, Grujovski, Marjan et al (eds.) Ministria e Mbrojtjes së RM, Forumprint: Kumanovo, pp. 87-94.

⁷⁹ Veiselli, Urim (2006) “Vlijanieto na Civilno-Voenata Sorabotka “CIMIC“ vrz Voenite Misii“ Sovremena Makedonska Odbrana (influenca e bashkëpunimit civil dhe ushtarak mbi misionet ushtarake) *Mbrojtja Bashkëkohore Maqedonase*. Viti V, No. 13. December 2006. Ministry of Defense of RM, Ohrid: Kosta Abrash. Pp. 85-101.

Shoqëria civile shpesh thirret për debate mbi diskutimet e kontrollit demokratik të SS-së. Shoqëria civile shihet si një mekanizëm i rëndësishëm (edhe pse në mënyrë jo formale) për kontrollin publik dhe përgjegjshmërinë e institucioneve të SS-së. Lidhja midis shoqërisë civile dhe SS-së në praktikë është zhvilluar në mënyrë të pamjaftueshme si në nivel konceptimi dhe në atë empirik, “Ekzistenca e përgjegjësive të mëdha civile në formimin opinionit publik, ekspertë civilë të sigurisë (si pjesë e komunitetit akademik) dhe ekzistenca e OJQ-ve aktive në fushën e politikave të sigurisë përfaqëson një parakusht themelor për një model standard Perëndimor të marrëdhënieve Ushtarako-civile si dhe parakushte themelore për një kontroll efektiv dhe kontroll të SS-së”.⁸⁰ Roli i medias si pjesë shoqërisë civile është thelbësore për të transferuar/komunikuar interesat dhe kërkesat e qytetarëve në politikën e brendshme dhe ndërkombëtare. Gjendja aktuale në Maqedoni, në lidhje me rolin dhe cilësinë e medias është si më poshtë: “Përfaqësja e pjesshme, e orientuar drejt problematikave dhe sipërfaqësore e gazetarëve përkundrejt SS-së krijon një atmosferë negative në të cilën secili mund të jetë një ekspert në SS dhe mund të shkruajë rreth sfidave të SS-së”.⁸¹ Edhe pse i zymtë, ky observim i Mr. Bakrevski është pak a shumë i saktë kur bëhet fjalë për rolin e mediave që mbulojnë fushën e sektorit të sigurisë në Maqedoni.

3.5 Stabiliteti rajonal

Stabiliteti rajonal në Ballkan ishte dhe akoma është një kusht paraprak për të filluar Reformën në Sektorin e Sigurisë dhe për ta përmbytur në mënyrë të suksesshme. Në një ambient sigurie të pafavorshëm dhe të paqëndrueshëm ka qenë

⁸⁰ Bakreski, Oliver (2006) “Ulogata na Civilnoto Opshtestvo vo Bezbednosniot Sektor“ *Sovremena Makedonska Odbrana* (Roli i Shoqërisë Civile në Sektorin e Sigurisë) *Mbrojtja Maqedonase Bashkëkohore*. Viti V, No. 13. December 2006. Ministry of Defense of RM, Ohrid: Kosta Abrash. fq. 27-39.

⁸¹ Bakreski, Oliver (2006) “Ulogata na Civilnoto Opshtestvo vo Bezbednosniot Sektor”, p. 34.

